

LIGJ
Nr.7703, datë 11.5.1993

PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995; nr.8286, datë 16.2.1998; nr.8392, datë 2.9.1998; nr.8575, datë 3.2.2000; nr.8776, datë 26.4.2001; nr.8852, datë 27.12.2001; nr.8889, datë 25.4.2002; nr.9058, datë 20.3.2003; nr.9114, datë 24.7.2003; nr.9377, datë 21.4.2005; nr.9498, datë 3.4.2006; nr.9600, datë 27.7.2006; nr.9708, datë 5.4.2007; nr.9768, datë 9.7.2007; nr.10 070, datë 5.2.2009)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

SISTEMI I PËRGJITHSHËM I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Ligji për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore. Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga: sigurimi i detyrueshëm, vullnetar, suplementar dhe nga pensionet shtetërore të posaçme.

Neni 2

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

*(Shtuar fjala në titull me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 1;
shtuar fjala në paragrafin e parë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 1;
shtuar fjalina në fund të paragrafit të dytë me ligjin nr.9708, datë 5.4.2007, neni 1)*

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura:

a) Personat e punësuar në lidhje me:

- paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes;
- barrë lindjen;
- pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;
- aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;
- papunësinë;

b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit) në lidhje me:

- barrë lindjen;
- pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

Me kontributet e derdhura garantohet pagesa në para për të kompensuar pakësimin e të ardhurave në një shumë që mbulon të paktën një standard minimal jetese, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Kur shihet e përshtatshme, mund të jepen përfitime në natyrë, në vend ose si shtesë e të ardhurave, në përputhje me rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni bazë, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë një shtesë të ardhurash në formë kompensimi.

Neni 3

Sigurimi shoqëror vullnetar

Personi i siguruar në mënyrë të detyrueshme, kur për një kohë dhe shkaqe të arsyeshme nuk mund të sigurohet detyrimisht, ka të drejtën e vazhdimit të sigurimit sipas sistemit vullnetar.

Sigurimi vullnetar është i mundur edhe për periudhën e studimeve universitare, me kusht që personi i siguruar të paguajë kontribut për këtë periudhë përpara datës së fillimit të së drejtës për të ardhura.

Sigurimi vullnetar mund të shtrihet edhe te personat që nuk përcaktohen në nenin 2.

Sigurimi vullnetar që parashikohet nga kjo dispozitë, bëhet në kushtet e përcaktuara nga rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 4

Sigurimi shoqëror suplementar

*(Shtuar fjala në paragrafin e tretë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 2;
shtuar fjalia në paragrafin e tretë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 2;
ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 1)*

Sigurimi shoqëror suplementar për personat që ushtrojnë funksione ose detyra të veçanta kushtetuese, për punonjësit e shtetit, për ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe ata të Shërbimit Informativ të Shtetit bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me ligje të veçanta.

Organi i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave ka të drejtë të autorizojë çdo person juridik për të dhënë pension suplementar në kushtet e përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 5

Pensionet shtetërore të posaçme

(Shtuar shprehja në pikën "a" me ligjin nr.8286, datë 16.2.1998, neni 1)

Kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:

a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;

b) kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;

c) kanë vuajtur nga persekutimi politik në rregjimin komunist.

Personat e përmendur në shkronjat a,b,c të këtij neni përfitojnë:

a) pension të posaçëm shtetëror, në rast se nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore, ose

b) shtesë pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që u takon nga sigurimet shoqërore.

Kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë që administrimi i pensioneve të posaçme shtetërore të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe shpenzimet të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

PJESA E II
PERSONAT QË PËRFITOJNË NGA SIGURIMET SHOQËRORE

Neni 6
Mbrojtja e detyrueshme

Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrëlindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes.

Sigurimet shoqërore, gjithashtu, i japin mbrojtje të detyrueshme gjithë personave të punësuar në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia. Këshilli i Ministrave mund të vendosë për fusha të tjera mbrojtjeje, si dhe për përjashtime për:

- a) Punëtorët sezonalë dhe të përkohshëm;
- b) të vetëpunësuarit në bujqësi;
- c) punëtorët e papaguar të familjes së personave të vetëpunësuar;
- ç) kursantët dhe studentët për kohën e praktikës mësimorë, të cilët sigurohen vetëm për aksidentin në punë nga punëdhënësit.

Neni 7
Mbrojtja për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit dhe shtetasit e huaj
(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 2)

Sigurimet shoqërore u japin mbrojtje edhe:

- a) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- b) shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri.

Neni 8
Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore

Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore nis ditën kur personi e ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari. Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore vullnetare nis nga data e përcaktuar në kontratën e sigurimit dhe mbaron ditën e skadimit të kësaj kontrate.

Periudha e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore vullnetare nis nga data e përcaktuar në kontratën e sigurimit dhe mbaron ditën e skadimit të kësaj kontrate.

Periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrëlindjeje, aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale dhe për papunësinë. Kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse.

Detajet përcaktohen nga rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

PJESA E III
KONTRIBUTET

Neni 9

Llojet e kontributeve për t'u paguar

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 3)

Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrëindje dhe pensione në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto). Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore.

Punëdhënësit detyrohen të paguajnë kontribut për aksident në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësinë.

Personat ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrëindje dhe për pensione në masën e nivelit bazë.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrëindje dhe për pensione. Masat dhe kriteret caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike të zhvilluar më parë për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me ligje dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Masa e kontributeve

(Ndryshuar shifra në paragrafin e dytë me ligjin nr.8852, datë 27.12.2001, neni 1;

ndryshuar shifra në shkronjën a dhe b me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 1;

ndryshuar shifra në shkronjën "a" të paragrafit të parë me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 1;

ndryshuar shifra në paragrafin e parë të shkronjës "a" me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 1)

Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrëindje dhe pensione do të jetë:

a) për punëdhënësit 13,8 për qind e shumës bruto të listëpagesave;

b) për personin e punësuar 9,5 për qind e pagesës së tij totale (bruto);

Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë, kurse kontributi maksimal është sa 5 herë kontributi minimal. Masa konkrete e kontributit minimal caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë në nivelin bazë të kontributit që paguajnë të vetëpunësuarit në jo më pak se dy data në vit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Kontributi vullnetar

Kontributi vullnetar paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Kontributi vullnetar ka të njëjtin rregull më kontributin e detyrueshëm.

Neni 12

(Zëvendësuar shprehja në shkronjën "b" me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 1;

shtuar paragraf me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 1;

shtuar fjali në paragrafin e tretë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 4)

Personat e vetëpunësuar dhe të punësuarit kanë të drejtë në kushtet e caktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të përfundojnë një kontratë të sigurimit shoqëror vullnetar për të përfituar:

- a) një shumë më të madhe të ardhurash;
- b) të ardhura, të cilat nuk u jepen atyre nga sigurimi i detyrueshëm.

Punëdhënësit privatë mund të sigurohen vullnetarisht duke paguar kontribute deri në nivelin maksimal, për të përfituar deri në dyfishin e pensionit minimal të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe atij familjar.

MBLEDHJA E KONTRIBUTEVE

Neni 13

Detyrimi për të paguar kontributet

*(Shtuar paragraf në pikën 3 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 2;
zëvendësuar fjala në pikën 4 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 5;
shtuar fjalët në pikën 3 me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 1/1;
ndryshuar fjalët në pikën 4 me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 1/2)*

1. Kontributet do të paguhën nga personat e siguruar.
2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi.
3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas fazave, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë në ndërmarrje, firma, institucione e subjekte të tjera ekonomike masat e kontributeve të derdhura, fondin e pagave dhe listëpagesat.
4. Çdo diferencë në shumën e kontributeve do të kthehen gjatë 5 vjetëve të pagesës së bashku me kamatëvonesën.

Neni 14

Shpërndarja e kontributeve

*(Ndryshuar shifrat në shkronjat a,b dhe c të pikës 1 me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 2 ;
ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2 me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 22;
ndryshuar shifra në shkronjën "c" të pikës 1 me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 2/1;
ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2 me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 2/2;
ndryshuar shifra në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 2/a/i;
ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 1 me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 2/a/ii;
ndryshuar shifra në shkronjën "c" të pikës 1 me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 2/a/iii;
ndryshuar shifra në shkronjën "a" të pikës 2 me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 2/b/i;
ndryshuar shifra në shkronjën "b" të pikës 2 me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 2/b/ii)*

1. Kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen në tri degë që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore:
 - a) dega e sigurimit të sëmundjeve 0,3 për qind e shumës së listëpagesave;
 - b) dega e sigurimit të barrë lindjes 1,4 për qind e shumës së listëpagesave;
 - c) dega e sigurimit të pensioneve 21,6 për qind të shumës së listëpagesave;
2. Punëdhënësi, përveç kësaj paguan:
 - a) te dega e sigurimit të aksidenteve dhe e sëmundjeve profesionale 0,3 për qind të shumës së listëpagesave;
 - b) te dega e sigurimit të papunësisë 0,9 për qind të shumës së listëpagesave.
3. Institutit i Sigurimeve Shoqërore do të diferencojë pagesën e kontributit për aksidente lidhur me rrezikshmërinë e jetës që paraqet puna në degët e ekonomisë.

Neni 15

Pagesa e kontributeve

*(Shtuar paragraf me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 3;
shtuar paragraf me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 2;
zëvendësuar fjalët në fjalinë e dytë të paragrafit të parë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 6;
shtuar paragrafë pas paragrafit të dytë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 6;
shtuar fjalia në paragrafin e fundit me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 6;
ndryshuar neni me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 3)*

Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, i paguajnë kontributet në fondin e sigurimeve shoqërore, sipas afatit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet gjatë vitit kalendarik, një herë në tre muaj. Afati i fundit i pagesës së tyre është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe procedurat e derdhjes së kontributeve.

Akti, që përmban detyrimin për pagesën e kontributeve, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

Neni 16

Sanksionet

*(Shtuar fjalët në pikën 1 dhe 2, rreshti i parë me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 4/1;
ndryshuar pika 3 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 4/2;
shtuar pika 4 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 4/3;
zëvendësuar fjalët në pikën 3 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 3;
ndryshuar neni me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 7;
ndryshuar neni me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 2;
ndryshuar neni me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 4)*

Ndaj punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, që nuk zbatojnë afatet dhe procedurat e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëse personat e vetëpunësuar në bujqësi nuk i paguajnë kontributet në afatet e përcaktuara në këtë ligj, ata detyrohen të paguajnë kamatëvonesa, të cilat llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara, nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën kryhet pagesa.

Kamatëvonesa për kontributet e paguara jashtë afateve është 2 për qind për muajin e parë ose pjesë të tij dhe 1 për qind për çdo muaj që vijon. Kamatëvonesa zbatohet e plotë, si në rastin kur vonesa është për 1 muaj të plotë, ashtu edhe kur periudha e vonesës është më e vogël se një muaj.

Kamatëvonesat llogariten nga inspektorët e agjencive të sigurimeve shoqërore.

Neni 17

Apelimet

(Shtuar fjalët me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 8)

Personi ka të drejtën e apelit në gjyq kundër vendimeve të gjobave, të inspektorëve të agjencive të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 18

Përparësia e kontributeve

*(Shtuar paragraf me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 4)
zëvendësuar fjalët në fjalinë e parë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 9;
shtuar fjalia në fund të paragrafit të dytë me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 9)*

Pagesat e kontributeve gëzojnë përparësi në raport me detyrimet fiskale dhe borxhet.

Për kontributet e paderdhura, nga subjektet brenda afatit, organet e sigurimeve shoqërore kanë të drejtën të nxjerrin akt-detyrimi, i cili është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

PJESA IV

Neni 19

Të ardhurat në para

Të ardhurat në para u paguhen personave përfitues nga:

- a) dega e sigurimit të sëmundjes;
- b) dega e sigurimit të barrëlindjes;
- c) dega e sigurimeve të pensioneve;
- ç) dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale;
- d) dega e sigurimit të papunësisë.

KREU I

E ARDHURA PËR SËMUNDJE

Neni 20

Në degën e sigurimit të sëmundjeve paguhen:

- a) të ardhurat për sëmundje;
- b) të ardhurat për kompensim për sëmundje, kur ndryshon vendi i punës.

Neni 21

Kushtet e përfitimit

1. Personi i siguruar përfiton të ardhurat për sëmundje, kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i paaftë për të punuar dhe kjo paaftësi nuk është pasojë e një aksidenti në punë ose e një sëmundjeje profesionale.

2. Personi i siguruar ka të drejtën e përfitimit të të ardhurave për sëmundje edhe brenda 30 ditëve kalendarike pas mbarimit të sigurimit të tij të detyrueshëm. Kjo nuk do të zbatohet nëse i punësuar është pushuar nga puna për akt kriminal, sipas vendimit të gjykatës.

Neni 22

Shuma e të ardhurave

1. Të ardhurat për sëmundje janë 70 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim, dhe 80 për qind kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim.

2. Për periudhën që përfituesi është shtruar në spital, kur nuk ka njeri në ngarkim, të ardhurat për sëmundje janë 50 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik.

Neni 23

Periudha e përfitimit

1. Periudha e përfitimit për paaftësi të përkohshme fillon në ditën e 15 të raportit mjekësor dhe do të zgjatë jo më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të pagesës.

2. Periudha e përfitimit mund të zgjatet përjashtimisht deri në 3 muaj të tjerë, në rast se komisioni i mjekëve ekspertë (KMCAP) provon që personi i siguruar do të shërohet në këtë periudhë dhe nuk do të deklarohet invalid.

3. Periudha e përfitimit të paaftësisë së përkohshme nga sëmundja, për ata që marrin pension invaliditeti të pjesshëm, është deri në 3 muaj nga data e fillimit të pagesës.

4. Periudha e përfitimit për punonjësit sezonalë dhe të përkohshëm, të cilët kanë qenë të punësuar të paktën 3 muaj në 12 muaj e fundit, është deri në 75 ditë.

Neni 24

Të ardhurat për kompensim sëmundjeje, kur ndryshon vendi i punës ose redukton orarin e punës

1. Personi i siguruar që për arsye shëndetësore, me vendim të komisionit mjekësor kompetent, ndryshon vendin e punës, ka të drejtë të përfitojë nga sigurimet shoqërore kompensimin e të ardhurave.

2. Shuma e të ardhurës që do të përfitohet për kompensim, është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik.

3. Periudha e përfitimit nuk duhet të kalojë 3 muaj gjatë një viti nga dita e fillimit të sëmundjes, për të cilën është ndryshuar vendi i punës.

Neni 25

Detyrimi i punëdhënësit

Të ardhurat në rastin e sëmundjes për periudhën deri në 14 ditët e para ose të kujdesjes së fëmijës në ngarkim paguhen nga punëdhënësi, sipas përcaktimit në Kodin e Punës dhe në kontratën e punësimit ose sipas marrëveshjes që do të ketë me përfaqësuesit e punëtorëve, por jo më pak se pagesat e përcaktuara në këtë ligj.

KREU II

TË ARDHURAT PËR BARRËLINDJE

Neni 26

Në degën e sigurimit për barrëlindje paguhen:

- a) të ardhurat për barrëlindje;
- b) të ardhurat për kompensimin për barrëlindje, kur ndryshohet vendi i punës;
- c) shpërblimi për lindje fëmije.

Neni 27

E ardhura për barrëlindje

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 3)

1. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur gjatë periudhës së përfitimit të barrëlindjes gruaja ka kushte për një përfitim të ri barrëlindjeje.

2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 42 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 42 ditë pas lindjes së fëmijëve.

3. E ardhura për barrëlindje për gruan e siguruar është:

- 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes;

- 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik për periudhën tjetër në vazhdim.

4. E ardhura për barrëlindje për gratë ekonomikisht aktive është e barabartë me nivelin bazë të pensionit të pleqërisë.

5. Nëna që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se mbas ditës se 42 të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë.

6. Kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, nëna që ka lindur, do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 42 ditë pas lindjes.

Neni 28

E ardhura për kompensimin për shtatzënësi

1. Gruaja e siguruar, që me vendim të komisionit mjekësor kompetent ndryshon vendin e punës për arsye shtatzënësie, ka të drejtë të përfitojë kompensim të ardhurash për pakësimin që pëson nga ndryshimi i vendit të punës. Ky kompensim jepet në rast se është derdhur kontribut për një kohë jo më pak se 12 muaj.

2. Shuma e të ardhurave që do të përfitohet për kompensim është e barabartë me diferencën ndërmjet pagesës së vendit të punës të mëparshëm dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik.

Neni 29

Shpërblim për lindje fëmije

(Zëvendësuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 5)

1. Shpërblim për lindje fëmije i paguhet një personi të siguruar, i cili është nëna ose babai i një fëmije që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribut për një vit para lindjes së fëmijës. Shpërblimi do të bëhet i pagueshëm vetëm një herë dhe nëna do të ketë përparësi në përfitimin e pagesës, në rast se ajo është e siguruar.

2. Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50 për qind të pagës minimale mujore.

KREU III PENSIONET

Neni 30

(Shtuar shkronja "b/1" me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 3)

Në degën e sigurimit të pensioneve paguhet:

- a) pension pleqërie;
- b) pension pleqërie i pjesshëm;
- b/1) pension pleqërie i reduktuar;
- c) pension invaliditeti;

- ç) pension invaliditeti i pjesshëm;
- d) të ardhura shtesë për kujdesje;
- dh) të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim;
- e) pensione familjare;
- ë) pagesë për vdekje.

PENSIONET E PLEQËRISË

Neni 31

Pension pleqërie i plotë

*(Hequr fjala në pikën 1 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 10;
ndryshuar shprehja në paragrafin e parë të pikës 1 me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 4)
ndryshuar titulli me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 4/a;
ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 4/b)*

1. Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të plotë në moshën 65 vjeç burrat dhe 60 vjeç gratë, pasi të kenë plotësuar 35 vjet sigurim. Për periudhën e tranzicionit bëhet përjashtim nga ky rregull dhe zbatohet neni 92 i dispozitave tranzitore të këtij ligji.

2. Nënata që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 50 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.

Neni 31/1

Pension pleqërie i reduktuar

*(Shtuar neni me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 5;
ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9058, datë 20.3.2003, neni 1;
shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9058, datë 20.3.2003, neni 1)*

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar kur:

- a) kanë plotësuar jo më pak se 35 vjet sigurim;
- b) kanë mbushur moshën 62 vjeç për burrat e 57 vjeç për gratë, kur mosha e daljes në pension të plotë pleqërie sipas nenit 92 është më e madhe se këto mosha;
- c) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë të del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, është 0.6 për qind në muaj.

Neni 32

Masa e pensionit

(Shtuar paragraf në fund të pikës 4 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 5)

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë e pensionit që u jepet gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë të paktën një standard jetese minimal, i indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
3. Shtesa që u jepet personave të punësuar, do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve. Këshilli i Ministrave të indeksojë çdo vit bazën e vlerësimit individual në lidhje me zhvillimin e kontributeve mesatare të paguara në këtë vit.
4. Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 për qind e pagës neto mesatare të 3 vjetëve rresht të 10 vjetëve të fundit të punës të personit të siguruar, cila të jetë më e vogël.

Paga neto mesatare e 3 viteve të njëpasnjëshme të 10 viteve të fundit të punës së personit të siguruar indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.

Neni 33

*(Ndryshuar titulli dhe neni me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 11;
ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 6)*

I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie të plotë, sipas neneve 31 e 92 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,34 për qind të pensionit të plotë, për çdo muaj që vazhdon të punojë dhe që paguan kontribute.

Përfituesi i pensionit të plotë të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,34 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.

Neni 34

Pensioni i pjesshëm i pleqërisë

*(Zëvendësuar shprehja me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 6;
zëvendësuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 7)*

1. Personi i siguruar për një kohë më pak se 35 vjet dhe më shumë se 15 vjet sigurimi, ka të drejtë të përfitojë pension të pjesshëm, kur të arrijë burri moshën 65 vjeç dhe gruaja moshën 60 vjeç.

2. Pensioni i pjesshëm caktohet si pjesë e pensionit të plotë. Ky pension llogaritet duke shumëzuar pensionin e plotë me vitet e sigurimit dhe duke bërë pjesëtimin me 35.

PENSIONET E INVALIDITETIT

Neni 35

Kushtet e përfitimit

*(Shtuar 3 paragrafë në fund të pikës 1 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 5;
hequr fjalët në paragrafin e parë të pikës 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 8/a;
ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 8/b)*

1. Personi që bëhet i paaftë, merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:

a) për çdo veprimtari ekonomike;

b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.

Kundër vendimit të KMCAP-it të rrethit personi mund të ankohet në KMCAP-in epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prerë.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit

2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç.

Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

3. Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.

Neni 36

Shuma e pensionit

(Shtuar paragraf në fund të pikës 4 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 9)

1. Shuma e plotë e pensionit të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë.

2. Pensioni bazë siguron të paktën një standard minimal jetese dhe indeksohet në lidhje me zhvillimin e indeksit të çmimeve së bashku me indeksimin e pensioneve të pleqërisë.

3. Shtesa që i paguhet personit të punësuar, është 1 për qind për vit sigurimi herë mesataren e bazës së vlerësuar që personi i siguruar ka arritur nëpërmjet kontributeve. Me propozimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave mund të indeksojë çdo vit bazën e vlerësuar individuale, në lidhje me zhvillimin e mesatares së kontributeve të paguara në këtë vit.

4. Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më e madhe sesa dy herë pensioni bazë ose 80 për qind e pagës mesatare neto të vitit të fundit, cila të jetë më e vogël.

Paga mesatare neto e vitit të fundit indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.

Neni 37

Pensioni i invaliditetit të pjesshëm

1. I siguruari merr pension për invaliditet të pjesshëm, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit sipas nenit 35 dhe kur për çdo arsye, përveç aksidentit në punë dhe sëmundjes profesionale, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në kushte të veçanta pune. Shkalla e invaliditetit dhe puna që do të kryejë i siguruari, përcaktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

2. Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit. Ai llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

Neni 37/1

Pension invaliditeti i reduktuar

(Shtuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 10)

Masa e pensionit të invaliditetit të reduktuar llogaritet duke shumëzuar masën e llogaritur të invaliditetit të plotë me koeficientin që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

Neni 38

E ardhura shtesë për kujdesje

Kur përfituesi i një pensioni invaliditeti bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe ka nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësueshme. Nevoja për kujdesje të vazhdueshme e një personi tjetër përcaktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Neni 39

E ardhura shtesë për fëmijë në ngarkim

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 11)

Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti sipas nenit 35 dhe që ka në ngarkim fëmijët deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në 25

vjeç, merr një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 për qind.

PENSIONET FAMILJARE

Neni 40

Kushtet e përfitimit

*(Shtuar shprehja në pikën 1 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 6/1;
ndryshuar shkronja "ç" e pikës 2 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 6/2;
ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 12)*

1. Personat, që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin pension familjar.

2. Pension familjar përfitojnë:

a) E veja, kur provohet se ajo është:

- mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç;
- e paaftë për punë ose
- ka mbushur moshën 50 vjeç.

b) Burri i ve, kur provohet se ai është:

- mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në 8 vjeç;
- i paaftë për punë ose
- ka mbushur moshën 60 vjeç.

c) Jetimi, kur provohet që ai ishte në ngarkim të atij që vdiq dhe ka një moshë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studion ose është i paaftë për punë, para së të arrijë moshat e mësipërme.

ç) Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë; prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë.

d) Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të. Në një rast të tillë ata trajtohen si jetimë.

3. E veja dhe personi i ve humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen.

Neni 41

Shuma e pensionit

(Shtuar paragraf pas paragrafit të parë të shkronjës "b" të pikës 1 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 7)

*reformuluar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 12;
reformuluar paragrafi i dytë i pikës 1 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 12;
reformuluar fjalia e dytë e pikës 2 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 12)*

1. Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit, dhe jepet në masën:

a) 50 për qind për personin e ve dhe

b) 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë.

Kur nuk merret pensioni i parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtarë në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 për qind.

Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.

2. Jetimi ka të drejtën e një pensioni familjar edhe në qoftë se prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 për qind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 për qind e tij.

3. Jetimi që humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

PAGESAT PËR VDEKJE

Neni 42

1. Pagesa për vdekje i jepet:
 - a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtari të familjes që ai e ka në ngarkim;
 - b) personi që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit.
2. Pagesa për vdekje është e barabartë me një muaj pension bazë pleqërie.

KREU IV

PAGESAT PËR SIGURIMIN NGA AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 43

1. Personat e siguruar që vuajnë nga aksidenti në punë sëmundje profesionale, përfitojnë të drejtën e së ardhurës, pavarësisht nga vjetërsia në punë:
 - a) për kujdes mjekësor shtesë dhe riaftësimi;
 - b) në rast paaftësie;
 - c) kompensim për dëme të arsyeshme;
 - ç) në rast vdekjeje.

Neni 44

Aksidenti në punë dhe sëmundjet profesionale

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 13)

Aksidenti në punë ose për shkak të punës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Sëmundjet profesionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 45

Kujdesi mjekësor shtesë dhe riaftësimi

Një person i siguruar që vuan nga një aksident në punë ose sëmundje profesionale, do të marrë kompensim shtesë ose ndonjë kualifikim - rikualifikim të nevojshëm për të rikthyer aftësinë e humbur, siç përcaktohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 46

Të ardhurat në rast paaftësie

I siguruari që për shkak të aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale humbet aftësinë për punë, do të përfitojë:

- a) të ardhura për paaftësi të përkohshme;
- b) të ardhura për invaliditet të përhershëm;
- c) të ardhura për invaliditet të pjësshëm të përhershëm dhe
- ç) të ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël.

Neni 47

E ardhura për paaftësi të përkohshme

E ardhura për paaftësi të përkohshme, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë (KML) do të jetë e barabartë me 100 për qind të pagës mesatare ditore të 3 vjetëve të fundit, paguar për një periudhë përfitimi deri në 12 muaj.

Neni 48

E ardhura për invaliditet të përhershëm

(Shtuar paragraf me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 14)

E ardhura për invaliditet të përhershëm në punë që ka shkaktuar të paktën humbjen e 67 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga një komision mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP), është e barabartë me 80 për qind të pagës mesatare të 3 vjetëve të fundit të punës, por jo më pak se niveli minimal i standardit të jetesës që do të vendoset nga Këshilli i Ministrave.

Personi që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe:

- ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësueshme;

- ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, përfitojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 për qind.

Neni 49

E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm

E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm në punë që ka shkaktuar të paktën humbjen e 33 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAP, është e barabartë me një pjesë të 80 për qindshit të pagës mesatare të 3 vjetëve të fundit në varësi nga shkalla e humbjes së aftësisë për punë, por jo më pak se 50 për qind dhe që përcaktohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 50

E ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël

E ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël e në më pak se 33 për qind, por më shumë se 10 për qind, e vërtetuar nga një KMCAP, është një shumë të hollash që jepet menjëherë dhe caktohet në përputhje me rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 51

Kompensimet për dëmtimet e arsyshme

Dëmtimi material që i ndodh personit të siguruar në lidhje me aksidentin në punë e sëmundjeje profesionale, do të kompensohet deri në fund sipas rregullores së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 52

Të ardhurat në rast vdekjeje dhe pensioni familjar

*(Shtuar paragraf në pikën 4 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 6;
ndryshuar pika 4 dhe hequr pika 5 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 13)*

1. Personi që paguan shpenzimet e vdekjes të një personi të siguruar, që vdes si rezultat i një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, do të ripaguhet plotësisht në nivelet që do të përcaktohen nga rregullorja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Kur një person i siguruar vdes, personat në ngarkim të tij dhe që kanë lidhje në një familje me të, kanë të drejtë për pension familjar me një shumë që varet nga numri i tyre.

3. Personat që kanë të drejtë për pension familjar, janë ata që përcaktohen në nenin 39 të këtij ligji.

4. Në rastet kur personi i siguruar vdes nga një aksident në punë ose sëmundje profesionale, masa e pensionit familjar për personat pasjetues, do të jetë ajo e përcaktuar në nenin 41 të këtij ligji.

KREU V TË ARDHURAT E PAPUNËSISË

Neni 53

Kushtet e përfitimit

*(Shtuar fjalët në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 15/a;
ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 15/b)*

1) Personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se:

a) Kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi dhe

b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës se:

- janë punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen, kur u ofrohet një punë e paguar, e përshtatshme;

- pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen.

c) nuk marrin përfitime të tjera nga ky ligj, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

2) Sigurimi i papunësisë mund të paguhet edhe në rastet e pjesëmarrjes në programet speciale publike shtetërore e lokale, më kusht që ai të mos marrë më shumë se paga minimale mujore.

Neni 54

Shuma e të ardhurës

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 16)

1. E ardhura nga papunësia do të jetë një shumë bazë që siguron të paktën një nivel jetese minimale, çdo vit e indeksuar me vendim të Këshillit të Ministrave, lidhur me llogaritjen e indeksit të çmimeve të mallrave të zgjedhura.

2. Niveli bazë do të vendoset nga Këshilli i Ministrave.

3. Përfituesit që kanë në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë ose janë të paafte për punë deri në 25 vjeç, përfitojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave nga papunësia, por jo më shumë se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind.

Neni 55

Periudha e përfitimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 17)

1. E ardhura e papunësisë paguhet deri në 12 muaj, sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave.

2. Për personat që punësohen me ndërprerje gjatë periudhës 1 vjeçare të përfitimit të papunësisë, afati i saj mund të shtyhet deri në 2 vjet, por me kusht që gjithsej të mos përfitojnë më shumë se 365 ditë kalendarike.

3. Personat që ndjekin kurset e kualifikimit dhe të rikualifikimit, përfitojnë pagesën e papunësisë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kurseve në rast se nuk paguhet për këtë periudhë, por

jo më shumë se 6 muaj tej afatit 1 vjeçar të përfitimit të papunësisë. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe të siguruarit gjatë kohës së përfitimit të barrë lindjes dhe të pensionit të plotë të invaliditetit.

KREU VI
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA
TË ARDHURAT

Neni 56

KUSHTET E PËRFITIMIT TË TË ARDHURAVE

1. Personi i siguar që e ka plotësuar periudhën e kërkuar të sigurimit, si dhe gjithë personat në ngarkim të atij që vdes, të cilët nuk kanë plotësuar moshën ose nuk plotësojnë kushtet e tjera për pension, kanë të drejtë të marrin pension kur të plotësojnë moshën ose kushte të tjera.

2. Personat që i kanë përmbushur të gjitha kushtet, por jo atë të paaftësisë, marrin pension, pasi të provohet se janë të paaftë për punë.

3. Bashkëshorti pasjetues që bëhet i paaftë për punë pas 10 vjetëve nga vdekja e bashkëshortit, nuk ka të drejtë për pension familjar.

Neni 57

Tërheqja e kësteve të përfitimit

1. Përfitimet duhet të zëvendësojnë pakësimin e të ardhurave nga punësimi ose nga një veprimtari tjetër ekonomike.

2. Përfituesi nuk ka të drejtë për këste përfitimi për çfarëdo periudhe kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar.

3. Pagesat e të ardhurave ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë ekonomikisht aktiv.

4. Pagesa nuk ndalohet vetëm kur ligji parashikon qartë punësim dhe veprimtari ekonomike (p.sh. pension invaliditeti të pjesshëm).

Neni 58

Periudha e sigurimit

(Shtuar fjalët në fund të shkronjës "b" me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 7)

1. Periudhat e sigurimit përfshijnë të gjitha periudhat:

a) për të cilat janë paguar kontributet;

b) gjatë të cilave është bërë pagesa nga sigurimet shoqërore përfshirë edhe periudhën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

2. Këshilli i Ministrave mund të deklarojë edhe periudha të tjera si periudha të sigurimit, duke u derdhur kontributi në fondin e sigurimit shoqëror nga Buxheti i Shtetit.

Neni 59

Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve

(Ndryshuar titulli i nenit me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 18/a;

riformuluar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 18/b;

riformuluar pika 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 18/c;

riformuluar pika 5 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 18/ç)

1. Baza e vlerësueshme për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të të dyja periudhave.

2. Baza e vlerësuar vjetore për kalkulimin e pagesave për sëmundje e barrëindje dhe për të ardhura të tjera afatshkurtër do të jetë totali i pagës vjetore, në bazë të të cilave janë paguar kontribucionet.

3. Çdo vit, duke filluar nga data 1 janar, baza e vlerësuar vjetore individuale indeksohet me koeficientin, që llogaritet si raport i kontributit mesatar për çdo person të siguruar, të mbledhur në vitin e fundit kalendarik, kundrejt të njëjtit tregues të vitit pararendës. Ky koeficient caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të tregojë rregullisht nivelin minimal të pensionit dhe pensionin bazë, në bazë të nivelit minimal të jetesës dhe do të propozojë shtimin e pensionit bazë për vitin e ardhshëm financiar dhe indeksimin e pensioneve minimale të paguara.

5. Pensionet e invaliditetit nuk do të llogariten me një bazë të vlerësuar më të ulët se ajo e paguar më parë. Sapo të jetë përfituar një pension invaliditeti, shuma e pensionit do të merret si kufi minimal, kur llogaritet çdo pension tjetër sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Neni 60

(Shtuar fjalët me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 19)

Për personat që nuk kanë pagë ose që nuk kanë dokumentin, i cili vërteton pagën, përfitimet llogariten mbi pagën minimale.

Neni 61

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 20)

Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit.

Neni 62

E drejta për përfitim

(Ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 8;

ndryshuar titulli me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 14;

shtuar fjalë në fund të pikës 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 21/a;

shtuar fjalët në paragrafin e tretë të pikës 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 21/b/i;

shtuar fjalët në paragrafin e katërt të pikës 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 21/b/ii;

ndryshuar paragrafi i katërt i pikës 3 me ligjin nr.9768, datë 9.7.2007, neni 1)

1. Personat që kanë të drejtë për më shumë se 1 lloj pensioni, mund të zgjedhin vetëm një prej tyre. Kjo e drejtë mund të ushtrohet jo më shumë se tri herë.

2. E drejta e pensionit nuk parashkruhet.

Personit, i cili kërkon pensionin jo më vonë se 1 vit nga data që i lind kjo e drejtë, ky pension i paguhet që nga kjo ditë. Në raste të tjera pensioni do të paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për pension.

E drejta për të ardhurat e tjera parashkruhet me kalimin e një viti nga data e fillimit të së drejtës për përfitimin e tyre.

3. Pensionet e njohura, por të patërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e këstit mujor të pensionit.

Personi, që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e këstit mujor të përfitimit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

4. Pensioni i invaliditetit do të ndërpritet për periudhat që pensionisti refuzon të vizitohet të komisioni i mjekëve ekspertë kompetentë. Gjithashtu, pensioni i invaliditetit ndërpritet edhe për periudhat kur ai refuzon të marrë pjesë në kurset e kualifikimit e të rikualifikimit, në ripërtëritjen mjekësore dhe në trajtimin kundër alkoolit e drogës, që synojnë të reduktojnë paaftësinë e tij për punë.

Neni 62/1

E drejta për informim

(Shtuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 22)

Personi i siguruar ka të drejtë të informohet për kontributet dhe/ose përfitimet nga sigurimet shoqërore. Procedura dhe periudhat për informim caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA V

FONDI I SIGURIMIT SHOQËROR

Neni 63

Përfitimet nga ky ligj nuk taksohen.

Neni 64

Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, tek i cili do të kontribuojnë rregullisht punëdhënësit, të punësuarit dhe personat e tjerë vullnetarisht të siguruar.

Kontributet e personave të punësuar do të ndahen me punëdhënësit e tyre.

Neni 65

1. Fondi i sigurimeve shoqërore është i ndarë nga buxheti i shtetit. Ai administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me statusin e tij të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Një pjesë e fondit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të jetë në valutë, e cila të përdoret për obligimet ndërkombëtare.

Neni 66

Të ardhurat

Të ardhurat e fondit të sigurimeve shoqërore përbëhen nga:

a) kontributet e personave të siguruar dhe e punëdhënësve të tyre;

b) kontributet nga Buxheti i Shtetit për personat që nuk mund të paguajnë kontribucione, veçanërisht për:

- shtetasit që shërbejnë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak;

- punonjësit që marrin një pagesë nga siguri i papunësisë;

- shtetasit që mbulohen nga skema e përfitimit me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) subvencione të Buxhetit të Shtetit për të mbështetur shpenzimet shtesë, si pasojë e:
 - Indeksimit që bëhet sipas këtij ligji, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe që përcakton ky ligj dhe
 - mbulimit të shpenzimeve kur të ardhurat nuk mjaftojnë;
- ç) pagesa për veprimtari shtesë, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;
- d) subvencione të Buxhetit të Shtetit të miratuara nga Kuvendi Popullor;
- dh) të ardhurat nga investimet e fondit të sigurimeve shoqërore;
- ë) të ardhura të tjera, duke përfshirë gjobat, të ardhurat nga veprimtaritë administrative të sigurimit shoqëror, dhurata, trashëgimi etj.

Neni 67

Shpenzimet

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 23)

1. Shpenzimet e fondit të sigurimeve shoqërore përfshijnë:
 - a) pagesat në para e në natyrë të përfitimeve për sigurinë, ndihma dhe pensione;
 - b) shpenzime administrative.
2. Kur shpenzimet për sigurimet shoqërore nuk mbulohen me të ardhurat e parashikuara në nenin 66, diferenca mbulohet nga Buxheti i Shtetit.
3. Për shpenzime administrative në buxhetin e sigurimeve shoqërore planifikohet një shumë deri në 5 për qind të shpenzimeve totale.

Neni 68

Përdorimi i fondeve për sigurimet shoqërore

(Shtuar fjalët në fund të paragrafit të parë të pikës 2 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 9; shtuar pika 4 me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 3; ndryshuar paragrafi i dytë i pikës 2 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 24)

1. Kontributet administrohen në mënyrë të ndarë në 5 degët e sigurimit shoqëror;
 - a) dega e sigurimit të sëmundjes;
 - b) dega e sigurimit të barrëlindjes;
 - c) dega e sigurimit të pensionit;
 - ç) dega e sigurimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
 - d) dega e sigurimit të papunësisë.
2. Transferimi i fondeve midis degëve të sigurimit shoqëror nuk është i lejueshëm, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë miratohet në buxhetin vjetor të sigurimeve shoqërore. Transferimi dhe përdorimi i fondeve bëhen vetëm sipas këtij ligji dhe rregullave të caktuara në Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
3. Të ardhurat dhe shpenzimet e sigurimeve shoqërore pasqyrohen rregullisht dhe do të revizionohen çdo vit nga komisioni i revizionit, i ngritur në përputhje me statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
4. Të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja financiare e fondit të sigurimeve shoqërore auditohen një herë në pesë vjet nga subjekte të specializuara në këtë fushë. Zgjedhja e subjekteve bëhet në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik"

Neni 69

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 25)

Shteti garanton fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme në rast falimentimi. Këshilli i Ministrave ka të drejtën e mbikëqyrjes së financimit për sigurimet shoqërore, të revizionimit të llogarive vjetore dhe të miratimit të buxhetit.

Neni 70
Fondi rezervë

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën 3 muaj shpenzimet për pensione.

2. Rezerva do të krijohet gjatë 5 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në çdo rast kur fondi rezervë është nën nivelin përcaktues, merren masat e nevojshme nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për ta vendosur në kuotën e caktuar.

3. Fondet e krijuara mbi nivelin përcaktues rezervë janë pjesë e kapitalit rezervë, i cili do të përdoret në përputhje me rregullat e përgjithshme financiare të përcaktuara në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me një rrezik minimal, që mund të pësohet.

PJESA VI
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 71
(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 26)

1. Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë do të drejtohen e administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohen me këtë ligj.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është person juridik shqiptar me qendër në Tiranë. Ai mund të koeprojë dhe të përfundojë marrëveshje e të marrë kontakte me organizata joqeveritare ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të drejtohet nga:

- a) këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe
- b) drejtori i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 72
Përbërja dhe emërimi i Këshillit Administrativ
(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 27)

1. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët:

- a) 6 anëtarë të ndarë si më poshtë:
 - i) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
 - ii) një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;
 - iii) një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale;
 - iv) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
 - v) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - vi) një përfaqësues nga Instituti i Statistikave.

Funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) 3 anëtarë caktohen nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve, të cilat përzgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) 3 anëtarë caktohen nga sindikatat më të përfaqësuara, të cilat përzgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Emërimi i anëtarëve të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Shkarkimi i anëtarëve mund të bëhet në çdo çast nga autoriteti që i cakton.

Neni 73

Kryesia e këshillit administrativ

Këshilli administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe dy zëvendëskryetarët e tij. Kryetari zgjidhet nga 6 anëtarë që janë përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe zëvendëskryetarët zgjidhen: njëri nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe tjetri nga përfaqësuesit e punëtorëve.

Neni 74

Kompetencat e këshillit administrativ

*(Shtuar shkronja "ë" me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 15;
shtuar shkronja "b/1" me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 28/a;
ndryshuar shkronja "e" me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 28/b;
ndryshuar shkronja "ç" e pikës 1 me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 1)*

1. Këshilli administrativ ka këto kompetenca:

- a) Zgjedh drejtorin e përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- b) Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore.
b/1) përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- c) Vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me investimet e fondeve.
- ç) Propozon te Ministri i Financave ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin e sigurimeve shoqërore.
- d) Vendos për lidhjen e marrëveshjeve dhe të kontratave të rëndësishme.
- dh) Miraton komisionin e kontrollit për veprimtarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- e) miraton rregulloret e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përgjegjësive që përcaktohen nga ligji e statuti dhe që kanë të bëjnë me çështje financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- ë) Me kërkesë të punëdhënësve vendos për ngritjen e kamatëvonesave për një periudhë të caktuar kohe dhe për pagimin e tyre në një periudhë të mëvonshme, por jo më shumë se një vit financiar pa të drejtë përsëritjeje, në ato raste kur pagesa e menjëhershme e kamatëvonesave do të bënte të pamundur vazhdimin e veprimtarisë ekonomike që ndodhet në vështirësi financiare.

Neni 75

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 29)

Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së ka këto detyra e përgjegjësi:

- a) përfaqëson Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe drejton veprimtarinë e tij;
- b) miraton rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, sipas ligjit;
- c) mbledh bordin e drejtuesve, si një organ këshillues pranë tij, ku bëjnë pjesë zëvendësdrejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive rajonale;
- ç) përcakton rregullat e brendshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- d) emëron punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, drejtorët e drejtorive rajonale, si dhe përcakton rregullat e rekrutimit të personelit për këto drejtori;
- dh) vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda kufijve të planit financiar dhe dispozitave ligjore në fuqi;
- e) përgjigjet për të gjitha çështjet e administrimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe raporton para Këshillit Administrativ;

ë) propozon në Këshillin Administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar, paraqet raportin vjetor, parashikimin financiar 3-vjeçar, si dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për kontributet dhe problemet financiare.

Neni 76

(Shfuqizuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 30)

Neni 77

Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Financave

*(Shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 31/a;
shtuar pikat 3 e 4 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 31/b;
ndryshuar titulli i neni me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 2/a;
zëvendësuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 2/b;
zëvendësuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 2/c;
zëvendësuar emërtimi në pikën 3 me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 2/ç;
zëvendësuar emërtimi në pikën 4 me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 2/d)*

Raportimi:

1. Këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore do t'i paraqesë çdo vit nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe të Përndjekurve Politikë Këshillit të Ministrave:

- a) raportin vjetor dhe bilancin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- b) buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe planin financiar;
- c) zhvillimin financiar 3 vjeçar dhe perspektivën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore një herë në 5 vjet do t'i paraqesë Ministrit të Financave, Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe nëpërmjet tij, Këshillit të Ministrave perspektivën për 5 vjet.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore raporton te Ministri i Financave për realizimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për realizimin e programit vjetor të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore, si dhe për probleme të tjera të ngarkuara nga Ministri.

4. Ministria e Financave mbikëqyr zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore.

Neni 78

Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 32;
zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9498, datë 3.4.2006, neni 3)*

Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe marrëdhëniet ndërmjet Ministrisë së Financave, Këshillit Administrativ dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

PJESA VII PROCEDURAT

Neni 79

Detyrimet e punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 16;
shtuar paragraf në fund të pikës 1 me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 4;
ndryshuar neni me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 3)*

Punëdhënësi dhe i vetëpunësuarit janë të detyruar:

- a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit;
- b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me ligj;
- c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuarit fillon punë;
- ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me ligj.

Rregullat e lëvizjes së informacionit dhe të dokumentacionit ndërmjet punëdhënësit, strukturave tatimore dhe strukturave të sigurimeve shoqërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 80

Punëdhënësi përgjigjet për punësimin dhe riaftësimin profesional të invalidëve, që janë të aftë për punë në kushte të veçanta, sipas rekomandimit të organit kompetent (KMCAP), dhe që caktohen nga zyrat e punës. Rregullat përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 81

Regjistrimi

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 17;
shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 5;
ndryshuar neni me ligjin nr.9600, datë 27.7.2006, neni 5;
ndryshuar neni me ligjin nr.10 070, datë 5.2.2009, neni 4)*

Personat juridikë, publikë, privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, janë të detyruar të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në strukturat tatimore, sipas rregullave të përcaktuara me ligj. Regjistrimi i subjekteve, në bazë të të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe mbyllja e veprimtarisë bëhen sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Regjistrimi është akt administrativ, që nuk tregon detyrim për mbulimin me sigurime shoqërore.

Neni 82

Procedura për derdhjen e kontributeve

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9114, datë 24.7.2003, neni 6)

1. Të gjitha të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga kamatëvonesat e tyre, të mbledhura nga organet tatimore, transferohen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të organeve në varësi të tij. Procedurat e transferimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore i shpërndan kontributet e mbledhura në të 5 degët e sigurimit shoqëror dhe i përdor veçmas.

Neni 83

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 33)

Personeli mjekësor dhe anëtarët e komisionit mjekësor ose të KMCAP-it, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre veprojnë në kundërshtim me normat e caktuara dhe cenojnë fondet e sigurimeve shoqërore, dënohen me gjobë në masën nga 3 deri në 5-fishin e pagës minimale, në shkallë vendi. Gjoha vendoset nga personeli i ISSH-së, përgjegjës për paaftësinë e përkohshme, barrë lindjen dhe ekspertizën mjekësore.

Kundër vendimit të gjobës bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, te Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, i cili vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose ndryshimin e masës së gjobës.

Neni 84

Kërkesa

1. Personi i siguruar ka të drejtë të kërkojë përfitime sa herë që mendon se i plotëson kushtet për përfitimin e tyre.

2. Kërkesat bëhen në agjencitë lokale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ku ndodhet:

a) vendi i punës për personat e punësuar;

b) vendi i banimit për gjithë personat e tjerë;

3. Kërkesat për përfitimin e papunësisë bëhen në zyrat e punës me procedurë, sipas qendrës së punës ose vendbanimit.

Neni 85

Përlllogaritjet

(Zëvendësuar fjala në pikën 3 me ligjin nr.8776, datë 26.4.2001, neni 18;

shtuar fjalët në fund të pikës 3 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 34)

1. Përfitimet afatshkurtëra për degët e sëmundjes, barrë lindjes dhe aksidenteve në punë për personat e punësuar, do të llogariten nga qendrat e punës, kurse për personat e tjerë ekonomikisht aktivë, nga zyrat lokale të sigurimeve shoqërore.

2. Përfitimet afatshkurtra për papunësinë caktohen nga zyrat e punësimit që janë në vartësi të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë. Kjo e fundit nxjerr aktet nënligjore për plotësimin e dokumentacionit.

3. Pensionet do të caktohen nga zyrat rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimit të kërkesës dhe të dokumenteve të plota e të sakta për pension.

Neni 86

Ankimimi

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 35)

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në komisionin e ankimit pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.

2. Ankimi kundër vendimeve të komisionit të ankimit pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore bëhet në komisionin e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë, vendimi i së cilës është përfundimtar.

4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të komisionit të ankimit pranë drejtorive rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 87

Pagesat

Pagesa e përfitimeve nga sigurimet shoqërore i ngarkohet një institucioni financiar profesional, që do të caktohet nga këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pagesa për përfitimin e papunësisë mund të bëhet, gjithashtu, nga zyrat e punës. rregullat caktohen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të përndjekurve Politike dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

PJESA VIII

DISPOZITA PËR PERIUdhËN TRANZITORE

Neni 88

Të drejtat e përfituara

*(Shtuar shprehja në pikën 7 me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 8;
ndryshuar fjalia e fundit e pikës 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 36/a;
ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 36/b;
shfuqizuar pika 5 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 36/c;
shtuar fjalët në pikën 7 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 36/ç;
shtuar fjalët në fund të fjalisë së parë të pikave 1 e 2 me ligjin nr.9708, datë 5.4.2007, neni 2)*

1. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr.4171, datë 13.4.1966 "Për sigurimet shoqërore të RPSH", të quhen të mirëqena dhe nuk do të jenë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksit dhe kompensimit, sipas paragrafit të dytë të nenit 2. Këshilli i Ministrave bën indeksimin e pensioneve në atë masë dhe sa herë indeksohen pensionet e caktuara në bazë të ligjit.

2. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore të RPSH", me gjithë ndryshimet e tij të mëvonshme, quhen të mirëqena dhe nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas paragrafit të dytë të nenit 2. Këshilli i Ministrave bën indeksimin e pensioneve në atë masë dhe sa herë indeksohen pensionet e caktuara në bazë të ligjit.

3. Personat që marrin sigurime afatshkurtër si për paaftësi, barrë lindje, sigurim papunësie etj., para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t'i përfitojnë në masën që u kanë qenë caktuar më parë.

4. Personat, të cilët më parë se ky ligj të hynte në fuqi, merrnin pension pleqërie, pension të parakohshëm, pension familjar, pension për vjetërsi shërbimi, pension për vjetërsi shërbimi në raste të veçanta, do të vazhdojnë të tërheqin pensionin e tyre. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për shtesat e dhëna për pjesëmarrjen në luftën kundër pushtuesve nazifashiste.

5. Shfuqizuar

6. Personat që sipas ligjit të mëparshëm gëzojnë pension invaliditeti, do të vazhdojnë ta marrin atë. Me rastin e rivlerësimit të gjendjes shëndetësore, personi që merr pension invaliditeti, ka të drejtë të zgjedhë legjislacionin më të favorshëm.

7. Personat që marrin pension të parakohshëm pension për vjetërsi shërbimi kur plotësojnë moshën për pension pleqërie sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në RPSH", e marrin pensionin në masën 70 për qind të pagës që i është llogaritur pensioni, por jo më shumë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë të caktuar në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar me rritjet përkatëse).

Neni 89

Zbatimi i dispozitave të reja

1. Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm në rastet kur e drejta lind mbas datës së hyrjes në fuqi të tij.

Neni 90

Pagesat e kontributeve

(Ndryshuar paragrafi i fundit i pikës 1 me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 7)

1. Kontributet prej 10 për qind që i takon të derdhen të punësuarit sipas nenit 10 të këtij ligji, do të derdhen në këtë mënyrë:

- Për vitin 1993, të punësuarit nuk do të derdhen, kurse Buxheti i Shtetit do të derdhë 10 për qind.

- Për vitin 1994, të punësuarit 3 për qind, kurse Buxheti i Shtetit 7 për qind.

- Për vitin 1995, të punësuarit 6 për qind, kurse Buxheti i Shtetit 4 për qind.

- Nga 1.1.1996 deri më 1.7.2002 të punësuarit 10 % në vazhdim 9,5 %.

2. Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi do të zbatohet gradualisht në masën e vendosur nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë, gjithashtu, të paguajë nga Buxheti i Shtetit kontributin që u takon grupeve të popullsisë ekonomikisht aktivë me të ardhura të pakta.

Neni 91

Periudhat e quajtura si periudha sigurimi

(Shtuar fjalët në pikën 4 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 11;

shtuar paragraf në fund të pikës 4 me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 11)

ndryshuar pika 4 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 37)

1. Të gjitha periudhat e punësimit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njohura si vjetërsi pune, të vlefshme për sistemin e sigurimit shoqëror të kaluar, do të quhen si periudha sigurimi edhe për këtë ligj.

2. Periudhat, në të cilat nuk është punuar, por të njohura si vjetërsi pune për sigurimet shoqërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të njihen si periudha të sigurimit edhe për këtë ligj.

3. Koha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji njihet si periudhë e sigurimit shoqëror vetëm kur është derdhur kontribut sipas këtij ligji.

4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 1 shtator 2000 e në vazhdim, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj.

Në këtë rast kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.

Neni 92

Zgjatja graduale e moshës dhe periudhës së sigurimit për pension

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 8)

Mosha dhe periudha e sigurimit për pension të plotë pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohen në pikën 1 të nenit 31 të ligjit, rriten sipas tabelave që vijojnë:

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË
VITE PËR SECILËN KATEGORI
BURRI

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35		
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35		
01.07.2014 - 30.06.2015	60v 6m	35				
01.07.2015 - 30.06.2016	61v	35				
01.07.2016 - 30.06.2017	61v 6m	35				
01.07.2017 - 30.06.2018	62v	35				
01.07.2018 - 30.06.2019	62v 6m	35				
01.07.2019 - 30.06.2020	63v	35				
01.07.2020 - 30.06.2021	63v 6m	35				
01.07.2021 - 30.06.2022	64v	35				
01.07.2022 - 30.06.2023	64v 6m	35				
2023 e në vazhdim	65v	35				

**MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË
VITE PËR SECILËN KATEGORI
GRUAJA**

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35		
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35		
01.07.2014 - 30.06.2015	55v 6m	35				
01.07.2015 - 30.06.2016	56v	35				
01.07.2016 - 30.06.2017	56v 6m	35				
01.07.2017 - 30.06.2018	57v	35				
01.07.2018 - 30.06.2019	57v 6m	35				
01.07.2019 - 30.06.2020	58v	35				
01.07.2020 - 30.06.2021	58v 6m	35				
01.07.2021 - 30.06.2022	59v	35				
01.07.2022 - 30.06.2023	59v 6m	35				
2023 e në vazhdim	60v	35				

I siguruari ka të drejtë të marrë pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë ose asaj të dytë pasi të ketë plotësuar në këtë kategori jo më pak se 3/4 e viteve të sigurimit. I siguruari që ka plotësuar vitet e sigurimit sipas tabelës së mësipërme, nga të cilat jo më pak se 1/2 e ka punë në nëntokë, ka të drejtë të marrë pension në kushtet e kategorisë së parë.”

Neni 93

Për nënat me shumë fëmijë

Nënat që kanë lindur 6 ose më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, marrin pensionin e pleqërisë kur kanë plotësuar moshën 50 vjeç dhe kanë vjetërsi në punë si vijon:

Vitet	Vitet e sigurimit
1993	15
1994	16
1995	17
1996	18
1997	19
1998	20
1999	21
2000	22
2001	24
2002	26
2003	28
2004	30

Në rastet kur si vjetërsi punë sipas kësaj tablele kërkohet të njihet edhe ajo që ka kryer si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, pensioni caktohet në bazë të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", me gjithë ndryshimet e mëvonshme të tij.

Neni 94
Për kategoritë e punës

Dalja më parë në pension nga koha e caktuar në këtë ligj për grupe të veçanta punonjësish (si minatorë etj.) mund të kontraktohet nëpërmjet sigurimit suplementar të pensioneve, sipas një skeme të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 95
Pensioni i pjesshëm

*(Shtuar një paragraf pas paragrafit të dytë me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 9;
ndryshuar neni me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 9;
ndryshuar tabela me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 38)*

Mosha dhe periudha e sigurimit për pension të pjesshëm pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohen në nenin 34 të ligjit, rriten sipas tabelës që vijon:

**MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN
NË VITE PËR PËRFITIMIN E PENSIONIT TË PJESSHËM TË PLEQËRISË**

Vitet	Mosha për burrat	Vitet e sigurimit për burrat	Mosha për gratë	Vitet e sigurimit për gratë
1993	60	12v 6m	55	10v
1994	60	12v 6m	55	10v 6m
1995	60	13v	55	11v
1996	60	13v 6m	55	11v 6m
1997	60	14v	55	12v
1998	60	14v 6m	55	12v 6m
1999	60	15v	55	14v
2000	60	15v 6m	55	15v

2001	60	16v	55	16v
01.07.2002 - 30.06.2003	60v 6m	17v	55v 6m	17v
01.07.2003 - 30.06.2004	61v	18v 6m	56v	18v 6m
01.07.2004 - 30.06.2005	61v 6m	15 v	56v 6m	15 v
01.07.2005 - 30.06.2006	62v	15 v	57v	15 v
01.07.2006 - 30.06.2007	62v 6m	15 v	57v 6m	15 v
01.07.2007 - 30.06.2008	63v	15 v	58v	15 v
01.07.2008 - 30.06.2009	63v 6m	15 v	58v 6m	15 v
01.07.2009 - 30.06.2010	64v	15 v	59v	15 v
01.07.2010 - 30.06.2011	64v 6m	15 v	59v 6m	15 v
2011 e në vazhdim	65v	15 v	60v	15 v

Pensioni i pjesshëm jepet në raport me vjetërsinë në punë që kërkohet në vitin përkatës.

Neni 96

(Hequr dhe zëvendësuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 10/1; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 10/2; ndryshuar neni me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998, neni 12; zëvendësuar fjalia në paragrafin 3 me ligjin nr.8575, datë 3.2.2000, neni 1; ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 39)

Personat, që krahas periudhës së sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, kanë dhe jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit, që kërkohet në vitin përkatës, sipas nenit 92 të këtij ligji, në marrëdhënie pune me shtetin, përfitojnë pension pleqërie sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa pension invaliditeti e pension familjar përfitojnë kur kanë jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit që parashikojnë, respektivisht, nenet 35 e 40 të këtij ligji.

Në rastet e tjera, pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa shtesa, që u jepet këtyre personave, do të jetë 1 për qind për çdo vit sigurimi, duke filluar nga data 1.10.1993 e në vazhdim, shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar, që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve.

Të vetëpunësuarëve në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t'u njihen periudhat e së kaluarës si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve për vitet përkatëse, në atë masë që është caktuar nga Këshilli i Ministrave, por jo për periudhat para datës 1.10.1993.

Kushtet për pension janë ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Periudha e sigurimit, për të cilën është derdhur kontribut pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihet vjetërsi pune në marrëdhënie me shtetin, për efekt të zbatimit të këtij neni.

Neni 97

(Shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 11; shtuar fjalët në paragrafin e tretë me ligjin nr.8889, datë 25.4.2002, neni 10)

Gratë që deri më 31 dhjetor 1994 kanë punuar në punët e katëgorisë së parë dhe të dytë dhe që kanë plotësuar jo më pak se 23 vjet në këto profesione, me kërkesën e tyre marrin pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve rresht brenda 10 vjetëve të fundit të punës.

Punonjësit e nëntokës që janë në marrëdhënie pune në nëntokë më 1.1.1995 dhe kanë plotësuar periudhën e sigurimit sipas nenit 92 të këtij ligji, pavarësisht nga mosha, me kërkesë të tyre marrin pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve rresht brenda 10 vjetëve të fundit të

punës. Afati i paraqitjes së kërkesës për këtë pension është deri në datën 31.12.1995. Pensioni nuk mund të jetë më i lartë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë.

Me arritjen e moshës së pensionit sipas nenit 92 marrin pensionin e plotë.

Pensionin e parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se pensioni maksimal i pleqërisë.

Neni 98

(Shtuar paragraf me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, neni 12)

Këshilli i Ministrave mund të ulë deri në 6 muaj kufirin e moshës për periudhën e sigurimit për të dalë në pension gjatë tranzicionit.

Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë dhe të derdhin kontribut për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike.

PJESA IX DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 99

Ligjet, dekretet, vendimet, udhëzimet dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 100

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 1993.

Në ato nene të ligjit:

- ku është përdorur termi “të ardhura” për të shprehur fjalën përfitime ose pensione, ky term zëvendësohet me termin “përfitime”;

- ku është përdorur termi “kontribucione” zëvendësohet me termin “kontribute”;

- ku është përdorur termi “Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të të Përndjekurve Politikë” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale”.

Shpallur më dekretin nr.542, datë 3.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 12.6.1993.

Ligji nr.7932, datë 17.5.1995 shpallur me dekretin nr.1109, datë 30.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 16.6.1995.

Ligji nr.8286, datë 16.2.1998 shpallur me dekretin nr.2000, datë 20.2.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, datë 9.3.1998.

Ligji nr.8392, datë 2.9.1998 shpallur me dekretin nr.2211, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 5.10.1998.

Ligji nr.8575, datë 3.2.2000 shpallur me dekretin nr.2548, datë 10.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.4, datë 16.3.2000.

Ligji nr.8776, datë 26.4.2001 shpallur me dekretin nr.3004, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 20.5.2001.

Ligji nr.8852, datë 27.12.2001 shpallur me dekretin nr.3212, datë 31.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 31.12.2001.

Ligji nr.8889, datë 25.4.2002 shpallur me dekretin nr.3323, datë 14.5.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 17.5.2002.

Ligji nr.9058, datë 20.3.2003 shpallur me dekretin nr.3814, datë 8.5.2003 të Presidentit të

Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 27.5.2003.
Ligji nr.9114, datë 24.7.2003 shpallur me dekret nr.3940, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.78, datë 22.9.2003.
Ligji nr.9377, datë 21.4.2005 shpallur me dekretin nr.4567, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, datë 30.5.2005.
Ligji nr.9498, datë 3.4.2006 shpallur me dekretin nr.4832, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, datë 2.5.2006
Ligji nr.9600, datë 27.7.2006 shpallur me dekretin nr.5020, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, datë 9.8.2006.
Ligji nr.9708, datë 5.4.2007 shpallur me dekretin nr.5268, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.48, datë 24.4.2007.
Ligji nr.9768, datë 9.7.2007 shpallur me dekretin nr.5397, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.90, datë 21.7.2007.
Ligji nr.10 070, datë 5.2.2009 shpallur me dekretin nr.6069, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 27.2.2009.

LIGJ
Nr.9136, datë 11.9.2003

PËR Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë

(Ndryshuar me ligjet nr.9329, datë 6.12.2004; nr.9457, datë 21.12.2005; nr.9933, datë 26.6.2008)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të neneve 9 dhe 13 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. “Kontribute” janë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, pagesat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe pagesat e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

4. “Numri i sigurimit shoqëror” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. “Organe tatimore” janë, sipas rastit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatimeve në rrethe.

6. “Paga bruto” është paga që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. “Person i detyruar për të paguar kontribute” është çdo person që detyrohet të paguajë kontributet e detyrueshme, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. “Person i vetëpunësuar” është personi i vetëpunësuar dhe personi me të ardhura të rregullta nga veprimtaria ekonomike.

9. “Punëdhënës”, “persona të punësuar” dhe “punonjës të papaguar të familjes” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. “Shkalla e kontributeve” janë përqindjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të vendosura me ligjet nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme

Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

Neni 4

Transferimi i kontributeve

Procedurat për transferimin e kontributeve dhe të interesave të mbledhura, sipas përcaktimit në këtë ligj, nga organet tatimore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Njoftimi

Organet tatimore u japin Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) të dhënat përkatëse për mbledhjen e kontributeve. Forma dhe përmbajtja e këtyre të dhënave, si dhe kushtet dhe afatet për dhënien e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II PROCEDURAT

Neni 6

Detyrimet e personave që paguajnë kontributet

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.

2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit dhe për punonjësit e papaguar të familjes.

Neni 7

Regjistrimi në organet tatimore

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet duhet të regjistrohet në organet tatimore brenda 15 ditëve nga çasti kur lind detyrimi për të paguar.

2. Procedurat e regjistrimit përcaktohen në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 8

Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe nivelit maksimal që është sa pesëfishi i pagës minimale.

Neni 9

Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes

1. Kontributet për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi pagën minimale, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Kontributet për punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje ndaj të ardhurave vjetore fikse, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Në rast se veprimtaria ekonomike, me anë të një deklaratë, ndërpritet për një periudhë, vlera e kontributit për t'u paguar zvogëlohet përpjesëtimisht, në përputhje me formulën e përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Detyrimi për të deklaruar

(Ndryshuar pikat 2 e 3 me ligjin nr.9329, datë 6.12.2004, neni 1)

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute duhet të dorëzojë në organet tatimore një deklaratë për çdo periudhë për të cilën është i detyruar t'i paguajë këto kontribute.

2. Deklarata duhet të përmbajë shumën e kontributeve për t'u paguar dhe vlerën e kontributeve të paguara.

3. Personat që janë të detyruar të paguajnë kontribute, dorëzojnë në organin tatimor deklaratën përkatëse, ku shënohet për çdo person emri, numri i sigurimeve shoqërore dhe shuma e kontributeve për t'u paguar.

Neni 11

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.9329, datë 6.12.2004, neni 2;
zëvendësuar fjalët te shkronjat “c” e “ç” të pikës 1 me ligjin nr.9457, datë 21.12.2005, neni 1)*

1. Deklarata e parashikuar në pikën 1 të nenit 10 dhe pagesat e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

b) nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

c) nga personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

ç) nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit.

2. Në zbatim të këtij ligji, deklarata e përmendur në pikën 3 të nenit 10 bëhet në afatin e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

3. Çdo person është i detyruar të deklarojë me shkrim në organin tatimor përkatës punëmarrësit e punësuar rishtazi, një ditë para fillimit të punës.

Neni 12

Vendi i pagesës

1. Kontributet paguhen në bankat, të cilat kanë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

2. Pagesa në valutë këmbëhet në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit ditën kur bëhet pagesa.

3. Procedurat për pagesën e kontributeve përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Rimbursimi i kontributeve të paguara mbi vlerën e duhur

1. Nëse si rezultat i një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e kontributeve të paguara tejkalon shumën e llogaritur të detyrimit për kontributin, organi përkatës rimbursion diferencën brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës ose nga njoftimi për këtë të fundit.

2. Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve. Mosplotësimi i kësaj dispozite përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji.

Neni 14
Masat shtrënguese

Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, organi përkatës ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 15
Mbajtja e regjistrimeve

Punëdhënësi duhet ta pajisë punëmarrësin me numrin e sigurimit shoqëror dhe të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara (në të holla ose si përfitime në natyrë) për çdo punëmarrës.

KREU III
KONTROLLI

Neni 16
Kontrolli i organeve tatimore

1. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.

2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 17
Vlerësimi

1. Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë paguar, lëshojnë një njoftim vlerësimi, ku paraqitet shuma e kontributeve shtesë për t'u paguar, së bashku me vlerën e interesave dhe të gjobave që duhen paguar.

2. Pagesa e shumave të vlerësuara bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit të vlerësimit.

Neni 18
Afatet kohore të vlerësimit

1. Organet tatimore kanë të drejtë të bëjnë vlerësime, sipas nenit 17 të këtij ligji, brenda 5 vjetëve nga data kur duhej të ishte depozituar deklarata për periudhën e vlerësuar. Nëse deklarata dorëzohet pas kësaj date, atëherë afati kohor prej 5 vjetësh fillon nga data e dorëzimit.

2. Në rastet e një ndryshimi në vlerësim, si rezultat i apelimit, afati kohor, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shtyhet sa kohëzgjatja e apelimit.

KREU IV
INTERESAT DHE GJOBAT

Neni 19
Interesat për pagesën e vonuar

1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen interesa për pagesë të vonuar. Interesat nuk falen nga asnjë autoritet.

2. Masa e interesit për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 20

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

*(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9329, datë 6.12.2004, neni 3;
ndryshuar neni me ligjin nr.9933, datë 26.6.2008, neni 1)*

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe gjobat përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

KREU V APELIMET

Neni 21

E drejta e apelimet

1. Çdo person, që detyrohet të paguajë kontribute, gëzon të drejtën e apelimet për vlerësimin e kontributit shtesë të interesave ose gjobave.
2. Çdo punëmarrës ka të drejtën e apelimet për llogaritjen e vlerës së kontributit, të mbajtur nga punëdhënësi.

Neni 22

Procedura e apelimet

1. Çdo i punësuar mund të apelojë me shkrim pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për llogaritjen e shumës së kontributeve të mbajtura nga punëdhënësi.
2. Punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojnë me shkrim në organet tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 23

Dispozita kalimtare

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave, të cilët, me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore.
2. Këshilli i Ministrave përcakton grupet e personave, të cilët detyrohen të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, si dhe afatet dhe procedurat përkatëse.
3. Të gjitha kontributet, që lindin para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, mblidhen në përputhje me ligjet nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Personat, të cilët nuk janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, do t'i paguajnë këto kontribute në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 24
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 8, 9 dhe 23 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizime

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3972, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, datë 7.10.2003

Ligji nr.9329, datë 6.12.2004 shpallur me dekretin nr.4433, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.103 date 29.12.2004.

Ligji nr.9457, datë 21.12.2005 shpallur me dekretin nr.4749, datë 13.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.105 datë 17.1.2006.

Ligji nr.9933, datë 26.6.2008 shpallur me dekretin nr.5796, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.112 datë 21.7.2008.

LIGJ
Nr.9588, datë 25.7.2006

PËR RILLOGARITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Përkufizim

Në kuptim të këtij ligji, quhen pensione pleqërie në qytet pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Neni 2

Rillogaritja e pensioneve për periudhën 1.1.1994 - 31.12.1996

Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten duke indeksuar pagat, mbi të cilat është llogaritur baza e vlerësuar dhe pagën neto, sipas koeficientëve të indeksimit, të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Indeksimi bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit.

Neni 3

Rillogaritja e pensioneve për periudhën 1.1.1997 - 14.6.2005

Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten sipas neneve 32, 33, 34, 59, 60, 61 e 62 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të akteve nënligjore në fuqi, të dala në zbatim të tij.

Rillogaritja bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit.

Masa e rillogaritur e pensionit rritet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen e pensioneve.

Neni 4

Të drejtat e fituara

Kur masa e pensionit të rillogaritur rezulton më e vogël se pensioni ekzistues, pensioni nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

Neni 5

Legjislacioni i zbatueshëm

Për pensionet e rillogaritura sipas neneve 2 e 3 të këtij ligji zbatohen të gjitha dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Neni 6

Ky ligj i fillon efektet financiare nga data 1.7.2006.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të tij.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5008, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu,

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, datë 9.8.2006

LIGJ
Nr. 9442, datë 16.11.2005

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.102 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË
PUNËS “PËR SIGURIMET SHOQËRORE (STANDARDET MINIMALE)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.102 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për sigurimet shoqërore (Standardet minimale)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4707, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.95, datë 15.12.2005.

KONVENTA MBI SIGURIMET SHOQËRORE
(STANDARDET MINIMALE) NR.102 E VITIT 1952

Miratuar në Gjenevë më 28.6.1952, në sesionin e 35-të të Konferencës së ILO-s dhe hyrë në fuqi më 27.04.1955

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e 35-të saj më 4 qershor 1952, *pasi ka vendosur* për miratimin e disa propozimeve në lidhje me standardet minimale të sigurimeve shoqërore, që është pika 11-të e rendit të ditës së sesionit dhe, *pasi ka vendosur* që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare, miraton, më 28 qershor 1952, konventën e mëposhtme, e njohur si Konventa e Sigurimeve Shoqërore (standardet minimale), 1952.

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Në këtë Konventë:
a) termi “i përcaktuar” nënkupton i vendosur nga apo sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të vendit;

b) termi “rezidencë” nënkupton rezidencën e rregullt në territorin e vendit anëtar dhe termi “rezident” nënkupton një person rezident i rregullt në territorin e vendit anëtar;

c) termi “bashkëshorte” nënkupton një bashkëshorte që mbahet nga bashkëshorti i saj;

d) termi “vejushë” nënkupton një grua që mbahej nga bashkëshorti i saj në kohën e vdekjes së tij;

e) termi “fëmijë” nënkupton një fëmijë nën moshën shkollore apo nën moshën 15 vjeç, siç përcaktohet;

f) termi “periudhë kualifikimi” nënkupton një periudhë kontributi ose një periudhë punësimi, ose një periudhë rezidence, ose një kombinim i tyre, si të përcaktohet.

2. Në nenet 10, 34, 49, termi “përfitim” nënkupton një përfitim direkt në formën e përkujdesjes ose një përfitim indirekt, që konsiston në rimbursimin e shpenzimeve të përballuar, nga personi i interesuar.

Neni 2

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo Konventë është në fuqi:

a) Do të veprojë në përputhje me:

i) pjesën I;

ii) të paktën tri nga pjesët II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX dhe X, duke përfshirë të paktën njëren nga pjesët IV, V, VI, IX dhe X;

iii) dispozitat përkatëse të pjesëve XI, XII dhe XIII;

iv) pjesën XIV dhe

b) Do të specifikojë në ratifikimin e saj se në cilën nga pjesët II deri X pranon detyrimet e Konventës.

Neni 3

1. Një shtet anëtar, ekonomia dhe institucionet mjekësore të të cilit nuk janë të zhvilluara në mënyrë të mjaftueshme, nëse dhe për aq kohë sa autoriteti kompetent e gjykon të nevojshme, shfrytëzon, me një deklaratë që i bashkëngjitet ratifikimit të saj, përjashtimet e përkoshme të parashikuara në nenet e mëposhtme:

9 (d); 12 (2); 15 (d); 18 (2); 21 (c); 27 (d); 33 (b); 34 (3); 41 (d); 48 (c); 55 (d) dhe 61 (d).

2. Çdo shtet anëtar, i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijë në raportin vjetor, me aplikimin e kësaj Konvente parashtruar në nenin 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, një deklaratë, lidhur me çdo përjashtim që ai do të shfrytëzojë:

a) që arsyeja e tij për të vepruar kështu qëndron;

b) që ai heq dorë nga e drejta për të shfrytëzuar përjashtimin në fjalë duke u nisur nga një datë e caktuar.

Neni 4

1. Çdo shtet anëtar që e ka ratifikuar këtë Konventë mund të njoftojë në vijimësi Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës se pranon detyrimet e Konventës lidhur me një apo më shumë nga pjesët II deri X, të paspecifikuara tashmë në ratifikimin e saj.

2. Ndërmarrjet, të cilave u jemi referuar në paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohen si pjesë përbërëse e ratifikimit dhe që kanë fuqinë e ratifikimit duke nisur nga data kur është bërë njoftimi.

Neni 5

Kur, për hir të përputhjes me secilën prej pjesëve II deri në X të kësaj Konvente, të cilat duhet të mbulohen nga ratifikimi i saj, një shtet anëtar duhet të mbrojë grupe të përcaktuara

personash që përfshijnë jo më pak se një përqindje të caktuar punonjësish apo rezidentësh, shteti anëtar, përpara se të ndërmarrë veprim për të plotësuar kërkesat e një pjese të tillë, duhet të sigurohet se është arritur përqindja e kërkuar.

Neni 6

Për hir të përputhjes me pjesët II, III, IV, V, VIII (për sa ajo lidhet me kujdesin shëndetësor), IX dhe X të kësaj Konvente, shteti anëtar mund të marrë parasysh mbrojtjen e realizuar përmes sigurimit, i cili, ndonëse nuk është i detyrueshëm në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të vendit për personat që mbrohen:

a) mbikëqyret nga autoritetet publike ose administrohet në përputhje me standardet e përcaktuara me veprime të përbashkëta të punëdhënësve dhe punëmarrësve;

b) mbulon një pjesë të rëndësishme të personave, të ardhurat e të cilëve nuk i kalojnë ato të një punonjësi, të seksit mashkull, të kualifikuar në punën manuale;

c) përputhet, në lidhje me format e tjera të mbrojtjes, aty ku është e përshtashme, me dispozitat përkatëse të Konventës.

PJESA II KUJDESI MJEKËSOR

Neni 7

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit lidhur me një gjendje që kërkon kujdes mjekësor me natyrë parandaluese ose kuruese në përputhje me nenet e mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 8

Rastet e mbuluara do të përfshijnë gjendjen patologjike, pavarësisht nga shkaku i saj, si dhe shtatzëninë, lindjen dhe pasojat e tyre.

Neni 9

Personat e mbrojtur do të përfshijnë:

a) grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50% të të gjithë punonjësve, si dhe bashkëshortet dhe fëmijët e tyre;

b) grupe të caktuara të popullsisë ekonomikisht aktive, që përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve, si dhe bashkëshortet dhe fëmijët e tyre.

c) grupe të caktuara të rezidentëve, që përfshijnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë rezidentëve;

d) kur është në fuqi një deklaratë e bërë sipas nenit 3, grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vende pune në industri, që kanë punësuar 20 apo më shumë persona, si dhe bashkëshortët dhe fëmijët e tyre.

Neni 10

1. Përfitimi duhet të përfshijë të paktën:

a) në rastin e gjendjes patologjike:

i) përkujdesje të përgjithshme mjekësore, duke përfshirë vizita mjekësore në shtëpi;

ii) përkujdesje të specialistëve në spitale si për pacientët e shtruar, dhe për pacientët e jashtëm, si dhe kujdesje tjetër specialistësh, e cila mund të kryhet edhe jashtë spitaleve;

iii) sigurimin e medikamenteve të rëndësishme të përcaktuara nga mjeku apo personel tjetër mjekësor i kualifikuar;

iv) shtrimi në spital kur është e nevojshme;

b) në ratin e shtazënisë, lindjes dhe pasojave të tyre:

i) përkujdesje para lindjes, gjatë lindjes dhe pas lindjes nga mjekë apo mami të kualifikuara;

ii) shtrim në spital kur të jetë e nevojshme.

2. Përfituesit ose mbajtësit të familjes mund t'i kërkohej të mbulojë një pjesë të kostos së kujdesit mjekësor që ai përfiton lidhur me një gjendje patologjike; rregullat për përcaktimin e kësaj pjese të kostos do të caktohen në mënyrë të tillë që të shmangin gjendjen e vështirë.

3. Përfitimi i dhënë në përputhje me këtë nen do të përballohet duke pasur parasysh ruajtjen, rehabilitimin apo përmirësimin e shëndetit të personit të mbrojtur dhe të aftësisë së tij për punë dhe për të plotësuar nevojat e tij personale.

4. Institucionet apo departamentet shtetërore që administrojnë përfitimet duhet që, me anë të mjeteve që gjykohen të përshtatshme, të inkurajojnë personat e mbrojtur të përfitojnë nga shërbimet e përgjithshme shëndetësore, të vëna në dispozicion të tyre nga autoritetet publike apo organizma të tjerë të njohur nga autoritetet publike.

Neni 11

Përfitimi i parashikuar në nenin 10, në një rast të mbuluar, do të sigurohet, të paktën për një person të mbrojtur, kur ai vetë apo mbajtësi i familjes së tij ka plotësuar një periudhë të tillë kualifikimi që mund të konsiderohet e nevojshme për të parandaluar abuzimin.

Neni 12

1. Përfitimi i përcaktuar në nenin 10 do të jepet përgjatë rastit të mbuluar, përveçse në rastin e një gjendjeje patologjike, kohëzgjatja e tij mund të kufizohet deri në 26 javë për çdo rast, por përfitimi nuk ndërpritet, ndërkohë që një përfitim për sëmundje vazhdon të paguhet dhe dispozita parashikon mundësinë e zgjatjes së afatit për sëmundje të përcaktuara dhe që njihen si raste që kërkojnë përkujdesje për një kohë më të gjatë.

2. Kur në fuqi është një deklaratë në përputhje me nenin 3, kohëzgjatja e përfitimit mund të kufizohet deri në 13 javë për çdo rast.

PJESA III PËRFITIMI PËR SËMUNDJE

Neni 13

Çdo shtet anëtar, për të cilën kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit të sëmundjes sipas neneve të mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 14

Rastet e mbuluara do të përfshijnë paaftësinë për punë si rezultat i një gjendjeje patologjike, që shoqërohet me ndërprerje të të ardhurave, siç përcaktohet nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi të vendit.

Neni 15

Në grupin e personave të mbrojtur përfshihen:

a) grupe të caktuara të punonjësve, që përfshijnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;

b) grupe të caktuara të popullsisë ekonomike aktive, që përfshijnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve;

c) të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve përgjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar në mënyrë të tillë që plotësojnë kërkesat e nenit 67;

d) kur është në fuqi deklarata e bërë sipas nenit 3, grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vende pune në industri që punësojnë 20 ose më shumë persona.

Neni 16

1. Kur grupet e punonjësve ose grupet e popullsisë ekonomike aktive janë të mbrojtura, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur në mënyrë të tillë që të përputhet me kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66.

2. Në rastet kur të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve përgjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar, janë të mbrojtur, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e nenit 67.

Neni 17

Përfitimi i përcaktuar në nenin 16, në një rast të mbuluar, do t'i jepet të paktën një personi të mbrojtur që ka plotësuar kushtet kualifikuese, siç mund të konsiderohet e nevojshme, për të parandaluar abuzimin.

Neni 18

1. Përfitimi i specifikuar në nenin 15 do të jepet gjatë rastit, veçse përfitimi mund të kufizohet deri në 26 javë në çdo rast sëmundjeje dhe në këtë rast nuk është e nevojshme të paguhet për tri ditët e para të ndërprerjes së të ardhurave.

2. Në rastin kur është në fuqi një deklaratë e bërë sipas nenit 3, kohëzgjatja e dhënies së përfitimit mund të kufizohet:

a) në një periudhë të tillë që numri i përgjithshëm i ditëve, për të cilat jepet përfitimi i sëmundjes në secilin vit, të jetë jo më pak se dhjetëfishi i numrit mesatar të personave të mbrojtur atë vit;

b) në 13 javë, në çdo rast sëmundjeje dhe në këtë rast, nuk është e nevojshme të bëhet pagesë për tri ditët e para të ndërprerjes së të ardhurave.

PJESA IV PËRFITIMI I PAPUNËSISË

Neni 19

Secili shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit të papunësisë në përputhje me nenet e mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 20

Në rastet e mbuluara përfshihet ndërprerja e të ardhurave, siç përcaktohet në ligjet dhe aktet nënligjore të vendit, si pasojë e pamundësisë për të siguruar punësim të përshtatshëm në rastin e personit të mbrojtur, i cili është i aftë dhe në dispozicion për punë.

Neni 21

Në personat e mbrojtur përfshihen:

- a) grupet e punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;
- b) të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve gjatë rasteve nuk i kalojnë kufijtë e parashikuar, në atë mënyrë që të plotësojnë kushtet e nenit 67;
- c) në rastin kur është në fuqi një deklaratë në përputhje me nenin 3, grupet e parashikuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve që punojnë në ndërmarrje industriale dhe që kanë të punësuar 20 apo më shumë persona.

Neni 22

1. Kur grupet e punonjësve janë të mbrojtur, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66.

2. Në rastet kur të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve gjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar, janë të mbrojtur, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur në atë mënyrë që përputhet me kushtet e nenit 67.

Neni 23

Përfitimi i specifikuar në nenin 22 do të jepet, në një rast të mbuluar, të paktën për një person të mbrojtur, që ka plotësuar atë periudhë kualifikimi që mund të konsiderohet e nevojshme për të parandaluar abuzimin.

Neni 24

1. Përfitimi i specifikuar në nenin 22 do të jepet përgjatë rastit, veçse kohështrirja e tij mund të kufizohet:

a) kur grupet e punonjësve janë të mbrojtur deri në 13 javë brenda 1 periudhe prej 12 muajsh;

b) kur të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve gjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e parashikuar, janë të mbrojtur deri në 26 javë brenda periudhës prej 12 muajsh.

2. Kur ligjet dhe aktet nënligjore parashikojnë se kohëzgjatja e përfitimit do të ndryshojë brenda shtrirjes së periudhës kontributive dhe/ose përfitimi i marrë më parë brenda një periudhe të caktuar, dispozitat e nënparagrafit (a) të paragrafit 1 do të konsiderohen se janë përmbushur, nëse kohëzgjatja mesatare e përfitimit është së paku 13 javë brenda një periudhe prej 12 muajsh.

3. Nuk është e nevojshme që përfitimi të paguhet për një periudhë pritëse që nuk është në shtatë ditët e para të çdo rasti të ndërprerjes së të ardhurave, duke llogaritur ditët e papunësisë përpara dhe pas punësimit të përkoshëm, që zgjat jo më tepër se një periudhë e parashikuar si pjesë e të njëjtit rast të ndërprerjes së të ardhurave.

4. Në rastin e punëtorëve sezonalë, kohëzgjatja e përfitimit dhe periudha pritëse mund të përshtaten me kushtet e tyre të punësimit.

PJESA V PËRFITIMI I PLEQËRISË

Neni 25

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit të pleqërisë në përputhje me nenet e mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 26

1. Rastet e mbuluara do të konsiderohen tej një moshe të përcaktuar.
2. Moshë e parashikuar nuk do të jetë më tepër se 65 vjeç apo do të jetë një moshë e tillë e lartë, si të vendoset nga autoritete kompetente, që do të lidhet me aftësinë për punë të personave të moshuar në vendin në fjalë.
3. Ligjet dhe aktet nënligjore mund të parashikojnë që përfitimi i një personi, dhënë në mënyrë tjetër, mund të pezullohet nëse një person i tillë angazhohet në një aktivitet të përcaktuar si fitimprurës ose përfitimi, nëse është kontributiv, mund të reduktohet kur të ardhurat përfituese e kalojnë masën e përcaktuar dhe kur është jokontributiv, kur të ardhurat e përfituesit ose mjetet e tjera të tij ose të dyja së bashku e kalojnë masën e përcaktuar.

Neni 27

Në personat e mbrojtur përfshihen:

- a) grupe të caktuara punonjësish, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;
- b) grupe të caktuara të popullsisë ekonomike aktive, që përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve;
- c) të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve përgjatë rastit nuk e kalojnë kufirin e përcaktuar në atë mënyrë që të përputhet me kushtet e nenit 67;
- d) kur është në fuqi një deklaratë sipas nenit 3, grupe të caktuara punonjësish, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vende pune në industri dhe që punojnë 20 apo më shumë persona.

Neni 28

Përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur si më poshtë:

- a) kur grupet e punonjësve apo grupet e popullsisë ekonomike aktive janë të mbrojtura, në mënyrë të tillë që plotësojnë kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66;
- b) kur të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve përgjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar, janë të mbrojtur, në mënyrë të tillë që plotësojnë kërkesat e nenit 67.

Neni 29

1. Përfitimi i specifikuar në nenin 28 do t'i jepet, në rastin e mbuluar, të paktën:

- a) një personi të mbrojtur, i cili ka plotësuar para rastit, në përputhje me rregullat e përcaktuara, një periudhë kualifikimi, e cila mund të jetë 30 vjet derdhje kontributeve ose punësimi, apo 20 vjet rezidencë;
- b) në rastin kur, në parim, të gjithë personat ekonomike aktive janë të mbrojtur, personit të mbrojtur që ka plotësuar një periudhë të përcaktuar kualifikimi të derdhjes së kontributeve dhe në lidhje me të cilin, për sa ka qenë në moshë pune, është paguar shuma mesatare vjetore e caktuar e kontributeve.

2. Kur përfitimi referuar në paragrafin 1 është i kushtëzuar me një minimum periudhe kontributeve ose punësimi, do t'i sigurohet një përfitim i reduktuar, të paktën:

- a) një personi të mbrojtur që, para periudhës së rastit, ka plotësuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara, një periudhë kualifikuese prej 15 vjetësh të kontributeve ose punësimit.
- b) në rastin kur, në parim, të gjithë personat ekonomike aktive janë të mbrojtur, personit të mbrojtur që ka plotësuar një periudhë të përcaktuar kualifikimi kontributive dhe në lidhje me të cilin, për sa kohë ka qenë në moshë pune, është paguar gjysma e shumës mesatare vjetore të kontributeve të përcaktuara në përputhje me nënparagrafin (b) të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni do të gjykohen të plotësuar kur një përfitim i llogaritur në përputhje me kërkesat e pjesës XI, por një përqindje prej dhjetë pikësh më të ulëta sesa tregohet në tabelën bashkëlidhur asaj pjese, për përfitimin standard në fjalë i sigurohet të paktën një personi të mbrojtur, që ka plotësuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara, 10 vjet kontribute apo punësim apo 5 vjet rezidencë.

4. Mund të bëhet një pakësim proporcional i përqindjes, i treguar në tabelën bashkëngjitur pjesës XI, kur periudha e kualifikimit për përfitimin që i korrespondon përqindjes së reduktuar i kalon 10 vjet kontribute apo punësim, por është më pak se 30 vjet kontribute ose punësim; nëse kjo periudhë kualifikuese i kalon 15 vjet, do të paguhet një përfitim i reduktuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

5. Kur përfitimi referuar paragrafit 1, 3 ose 4 të këtij neni kushtëzohet me një periudhë minimale kontributive apo punësimi, një përfitim i reduktuar do t'i paguhet në kushte të përcaktuara një personi të mbrojtur, i cili, vetëm për arsye të moshës së avancuar në periudhën kur kanë hyrë në fuqi dispozitat për aplikimin e kësaj pjese, nuk ka mundur të plotësojë kushtet e paragrafit 2 të këtij neni, në qoftë se një përfitim, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1, 3 ose 4 të këtij neni, nuk i është dhënë një personi të tillë në një moshë më të madhe se mosha normale.

Neni 30

Përfitimet e specifikuar në nenet 28 dhe 29 do të jepen gjatë gjithë periudhës së rastit.

PJESA VI PËRFITIMI PËR DËMTIM NË PUNË

Neni 31

Çdo shtet anëtar, për të cilën është në fuqi kjo Konventë, do t'u sigurojë personave të mbrojtur dhënien e përfitimit për dëmtim në punë në përputhje me nenet në vazhdim të kësaj pjese.

Neni 32

Rastet e mbuluara do të përfshijnë kategoritë e mëposhtme, të cilat vijnë si rezultat i aksidenteve apo sëmundjeve të përcaktuara si të lidhura me punësimin:

- a) një gjendje patologjike;
- b) paaftësia për punë, që rezulton nga një gjendje e tillë dhe që ndërpret të ardhurat, siç përcaktohet nga ligjet dhe aktet nënligjore të vendit.
- c) humbja e përgjithshme e aftësisë për të siguruar të ardhura apo humbja e pjesëshme në një shkallë të caktuar, e cila ka gjasa të bëhet e përhershme, apo humbja përkatëse e aftësisë;
- d) humbja e përkrahjes që pëson vejusha apo fëmija nga vdekja e mbajtësit të familjes; në rastin e një të veje, e drejta për përfitim mund të kushtëzohet në përputhje me ligjet me aktet nënligjore të vendit me të qenit e saj e paaftë për të mbajtur vetveten.

Neni 33

Në personat e mbrojtur do të përfshihen:

- a) grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve, dhe për përfitim në rast vdekjeje të mbajtësit të familjes, edhe bashkëshortet edhe fëmijët e tyre;
- b) kur është në fuqi një deklaratë në përputhje me nenin 3, grupe të caktuara punonjësish, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vende pune në industri, që punësojnë 20 apo më shumë punonjës, dhe për përfitim në rast vdekjeje të mbajtësit të familjes, edhe bashkëshortet dhe fëmijët e tyre.

Neni 34

1. Në lidhje me kushtet patologjike, përfitimi do të jetë përkujdesje mjekësore, siç përcaktohet në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Përkujdesi mjekësor do të përfshijë:

a) mjekun e përgjithshëm dhe specialistin për pacientët në spitale dhe jashtë tyre, duke përfshirë edhe vizita në shtëpi;

b) kujdesin e stomatologut;

c) kujdesin e infermierisë në shtëpi ose spitale, apo institucione të tjera mjekësore;

d) mbajtjen në spitale, shtëpi pushimi, sanatorium apo institucione të tjera mjekësore;

e) pajisje dentare, farmaceutike, si dhe pajisje të tjera mjekësore apo kirurgjikale, duke përfshirë protezat, mirëmbajtjen e tyre dhe syze;

f) kujdes të siguar nga profesionistë të tjerë, të cilët mund të njihen në çdo kohë si ligjorë e të lidhur me profesionin mjekësor, nën mbikëqyrjen e një mjeku të përgjithshëm apo stomatologu.

3. Kur është në fuqi një deklaratë e bërë në zbatim të nenit 3, kujdesi mjekësor do të përfshijë të paktën:

a) kujdesin e mjekut të përgjithshëm, përfshirë edhe vizitën në shtëpi;

b) kujdesin e specialistit në spitale për pacientët e shtruar dhe të jashtëm, si dhe trajtim tjetër shëndetësor që mundësohet jashtë spitaleve;

c) medikamente të rëndësishme të përcaktuara nga mjeku apo specialistë të tjerë të kualifikuar;

d) shtrim në spital kur është e nevojshme.

4. Kujdesi mjekësor i siguar në përputhje me paragrafët e mësipërm do të jepet me qëllim ruajtjen, rehabilitimin dhe përmirësimin e shëndetit të personit të mbrojtur dhe të aftësisë së tij për punë, si dhe për të ndjekur nevojat e tij individuale.

Neni 35

1. Institucionet apo departamentet shtetërore që administrojnë kujdesin shëndetësor do të bashkëpunojnë, kur është e përshtatshme, me shërbimet e përgjithshme të rehabilitimit profesional, me qëllim rivendosjen e personave handikapë në vende të përshtatshme pune.

2. Ligjet apo aktet nënligjore të vendit mund t'i autorizojnë këto institucione apo departamente të sigurojnë masat paraparake për rehabilitimin profesional të handikapëve.

Neni 36

1. Për shkak të paaftësisë për punë, humbjes totale të kapacitetit për të siguar të ardhura, që mund të bëhet edhe e përhershme, apo humbjes së aftësisë, apo vdekjes së mbajtësit të familjes, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt, e llogaritur në mënyrë të tillë që të përputhet me kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66.

2. Në rast të humbjes së pjesshme të aftësisë për të siguar të ardhurat, që mund të shkojë deri në humbje të përhershme, apo në rast humbjeje të aftësisë përkatëse, përfitimi, atje ku mund të jetë i pagueshëm, do të jetë një pagesë e rregullt që përfaqëson një përpjesëtim të përshtatshëm të asaj që jepet për humbjen totale të kapacitetit për të siguar të ardhura apo të mundësisë përkatëse.

3. Pagesa e rregullt mund të zëvendësohet me një shumë të vetme parash:

a) kur shkalla e paaftësisë është më e vogël;

b) kur autoriteti kompetent është i bindur se shuma e parave do të përdoret në mënyrë të dobishme.

Neni 37

Përfitimi i specifikuar në nenet 34 dhe 36, në një rast të mbuluar, do të sigurohet të paktën për një person të mbrojtur, i cili ka qenë i punësuar në territorin e shtetit anëtar në kohën e

aksidentit, nëse dëmtimi ka ndodhur për shkak të aksidentit apo në kohën e marrjes së sëmundjes, nëse dëmtimi është për shkak të sëmundjes, dhe për pagesat e rregullta për vdekjen e mbajtësit të familjes, edhe për vejushat dhe fëmijët e personit në fjalë.

Neni 38

Përfitimi i specifikuar në nenet 34 dhe 36 do të jepet përgjatë rastit, me përjashtim të rastit kur, për shkak të paaftësisë për punë, nuk është e nevojshme që përfitimi të paguhet gjatë tri ditëve të para në çdo rast të ndërprerjes së të ardhurave.

PJESA VII PËRFITIMI PËR FAMILJEN

Neni 39

Secili vend anëtar, për të cilin është në fuqi kjo Konventë, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit familjar, në përputhje me nenet në vazhdim të kësaj pjese.

Neni 40

Rastet e mbuluara do të jenë përgjegjësia për mbajtjen e fëmijëve, siç parashikohet.

Neni 41

Në personat e mbrojtur do të përfshihen:

- a) grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;
- b) grupe të caktuara të popullsisë ekonomikisht aktive, që përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve;
- c) të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve, përgjatë rastit, nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar;
- d) kur ka në fuqi një deklaratë në përputhje me nenin 3, grupe të caktuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vende pune në industri ku punojnë 20 apo më shumë persona.

Neni 42

Përfitimi do të jetë:

- a) një pagesë e rregullt, që i jepet çdo personi të mbrojtur që ka plotësuar periudhën e përcaktuar kualifikuese;
- b) sigurimi, për apo në lidhje me fëmijët, i ushqimit, veshmbathjes, strehimit, ditëve të pushimit apo ndihmës shtëpiake;
- c) një kombinim i (a) dhe (b).

Neni 43

Përfitimi i specifikuar në nenin 42 do t'i sigurohet të paktën një personi të mbrojtur, i cili brenda një periudhe të përcaktuar ka plotësuar një periudhë kualifikimi, që mund të jetë tre muaj derdhje kontributesh apo punësimi, apo një vit rezidencë, si të jetë përcaktuar.

Neni 44

Vlera e përgjithshme e përfitimeve të dhëna në përputhje me nenin 42 për personat e mbrojtur duhet të jetë e tillë që të përfaqësojë:

a) 3 për qind të pagës së një punëtori të zakonshëm, të rritur, të seksit mashkull, siç përcaktohet në rregullat e parashikuara në nenin 66, shumëzuar me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të personave të mbrojtur;

b) 1,5 për qind e pagës së deklaruar, shumëzuar me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të të gjithë rezidentëve.

Neni 45

Kur përfitimi është një pagesë e rregullt, ai jepet përgjatë rastit.

PJESA VIII PËRFITIMI PËR BARRËLINDJE

Neni 46

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personin e mbrojtur dhënien e përfitimit për barrëlindje, në përputhje me nenet në vazhdim të kësaj pjese.

Neni 47

Rastet e mbuluara do të përfshijnë periudhën e barrës dhe të paslindjes, dhe pasojat e tyre, si dhe ndërprerjen e të ardhurave, siç përcaktohet në ligjet dhe aktet nënligjore të vendit që rezultojnë për këtë qëllim.

Neni 48

Personat e mbrojtur do të përfshijnë:

a) të gjitha gratë e grupeve të caktuara të punonjësve, grupe të cilat përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve, dhe për përfitimin mjekësor të barrëlindjes, edhe bashkëshortet e burrave që i përkasin këtyre grupeve;

b) të gjitha gratë e grupeve të caktuara të popullsisë ekonomiksht aktive, grupe të cilat përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve; dhe për përfitimin mjekësor të barrëlindjes, edhe bashkëshortet e burrave të këtyre grupeve;

c) kur ka në fuqi një deklaratë në lidhje me nenin 3, të gjitha gratë në grupet e përcaktuara të punonjësve, grupe të cilat përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vendet e punës në industri, ku janë të punësuar 20 apo më shumë persona dhe për përfitimin mjekësor të barrëlindjes edhe bashkëshortet e burrave të këtyre grupeve.

Neni 49

1. Në lidhje me shtatzëninë dhe periudhën pas lindjes dhe pasojat e tyre, përfitimi mjekësor i barrëlindjes do të jetë kujdes shëndetësor siç përcaktohet në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Kujdesi mjekësor do të përfshijë të paktën:

a) përkujdesje para lindjes, gjatë lindjes dhe pas lindjes nga mjekë specialistë apo mami të kualifikuara;

b) shtrim në spital, kur është e nevojshme.

3. Përkujdesi mjekësor, i specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, do të jepet me qëllim ruajtjen, rehabilitimin ose përmirësimin e gjendjes shëndetësore të gruas së mbrojtur dhe aftësisë së saj për punë, si dhe për të plotësuar nevojat e saj.

4. Institucionet apo departamentet shtetërore që administrojnë përfitimin e barrëlindjes, me mjete që i gjykojnë të përshtatshme, do të inkurajojnë gratë e mbrojtura të përfitojnë nga shërbimet e

përgjithshme shëndetësore vënë në dispozicion të tyre nga autoritetet publike apo nga organizma të tjerë të njohura nga autoritetet publike.

Neni 50

Lidhur me ndërprerjen e të ardhurave si rezultat i shtatzënisë dhe periudhës së paslindjes, si dhe i pasojave të tyre, përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt e llogaritur në mënyrë të tillë që të përputhet me kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66. Masa e pagesës periodike mund të ndryshojë përgjatë rastit, por është një mesatare e saj që del duke plotësuar këto kërkesa.

Neni 51

Përfitimi i specifikuar në nenet 49 dhe 50 do të sigurohet në një rast të mbuluar, të paktën për një grua që i përket grupeve të mbrojtura, e cila ka plotësuar atë periudhë kualifikimi që është e nevojshme për të parandaluar abuzimin, dhe përfimi i specifikuar në nenin 49 gjithashtu do të sigurohet për bashkëshorten e një burri që i përket grupeve të mbrojtura, rastin kur ky i fundit e ka plotësuar një periudhë kualifikimi të tillë.

Neni 52

Përfitimi i specifikuar në nenet 49 dhe 50 do të jepet përgjatë rastit, veçse pagesa e rregullt mund të refuzohet deri në 12 javë nëse nuk kërkohet apo nuk autorizohet një periudhë më e gjatë shkëputjeje nga puna nga ligjet dhe aktet nënligjore kombëtare dhe në një rast të tillë, ajo nuk mund të kufizohet në një periudhë më të shkurtër se kjo periudhë më e gjatë.

PJESA IX PËRFITIMI I INVALIDITETIT

Neni 53

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit të invaliditetit në përputhje në nenet e mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 54

Në rastet e mbuluara përfshihet të qenit i paaftë për t'u angazhuar në çdo lloj aktiviteti fitimprurës gjatë një kohe të parashikuar, paaftësi e cila ka gjasa të jetë e përhershme apo vazhdon pas përfundimit të përfitimit për sëmundje.

Neni 55

Në personat e mbrojtur përfshihen:

- a) grupet e parashikuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;
- b) grupet e parashikuara të popullsisë ekonomikisht aktive, që përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve;
- c) të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve gjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e parashikuar në atë masë që të përputhet me kushtet e nenit 67;
- d) kur është në fuqi një deklaratë në përputhje me nenin 3, grupet e parashikuara të punonjësve, që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve që punojnë në ndërmarrje industriale që kanë të punësuar 20 apo më shumë persona.

Neni 56

Përfitimi do të jetë një pagesë e rregullt e llogaritur si më poshtë:

a) në rastet kur grupet e punonjësve apo grupet e popullsisë ekonomikisht aktive janë të mbrojtura në atë mënyrë që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 65 apo kushtet e parashikuara në nenin 66;

b) në rastet kur të gjithë rezidentët, mjetet e të cilëve gjatë rastit nuk kalojnë kufijtë e përcaktuar, janë të mbrojtur, në mënyrë që të plotësojnë kushtet e parashikuara të nenit 67.

Neni 57

1. Përfitimi i specifikuar në nenin 56 do të jepet, në një rast të mbuluar, të paktën:

a) për një person të mbrojtur që ka plotësuar përpara rastit, në përputhje me aktet nënligjore të parashikuara, një periudhë kualifikimi që mund të jetë 15 vjet kontribuim apo punësim ose 10 vjet rezidencë;

b) kur, në parim, të gjithë personat ekonomikisht aktivë janë të mbrojtur, për një person të mbrojtur, i cili ka plotësuar një periudhë kualifikimi prej tre vitesh kontributive dhe për të cilin, ndërsa ai ishte në moshë pune, është paguar masa kontributive mesatare vjetore e parashikuar.

2. Kur përfitimi referuar në paragrafin 1 kushtëzohet me një minimum periudhe kontributive apo punësimi, do të jepet të paktën një përfitim i reduktuar:

a) për një person të mbrojtur që ka plotësuar, përpara rastit, në përputhje me aktet nënligjore të parashikuara, një periudhë kualifikimi prej pesë vjetësh kontribuim apo punësim;

b) kur, në parim, të gjithë personat ekonomikisht aktivë janë të mbrojtur, për një person të mbrojtur që ka plotësuar një periudhë kualifikimi prej tre vjetësh kontribuim dhe për të cilin, ndërsa ai ishte në moshë pune, është paguar gjysma e masës kontributive mesatare vjetore e parashikuar në përputhje me nënparagrafin (b) të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kushtet e paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen të plotësuara, kur një përfitim është llogaritur sipas kërkesave të pjesës XI, por me një përqindje dhjetë pikë më të ulëta se sa jepet në tabelën bashkëngjitur asaj pjese, sepse përfitimi standard në fjalë i jepet të paktën një personi të mbrojtur që ka plotësuar, në përputhje me aktet nënligjore të parashikuara, pesë vjet periudhë kontributive, punësimi apo rezidence.

4. Mund të aplikohet një reduktim proporcional i përqindjes së treguar në tabelën e bashkëngjitur pjesës XI, kur periudha kualifikuese për pension që i korrespondon përqindjeve të reduktuara i kalon pesë vjet kontribuim apo punësim, por është më e vogël se 15 vjet kontribuim apo punësim; pensioni i reduktuar do të jepet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 58

Përfitimi i specifikuar në nenet 56 dhe 57 do të jepet përgjatë rastit apo deri kur të fillojë të paguhet përfitimi i pleqërisë.

PJESA X PËRFITIMI FAMILJAR (NË RAST VDEKJEJE)

Neni 59

Çdo shtet anëtar, për të cilin kjo pjesë e kësaj Konvente është në fuqi, do të sigurojë për personat e mbrojtur dhënien e përfitimit familjar në përputhje me nenet e mëposhtme të kësaj pjese.

Neni 60

1. Në rastet e mbuluara përfshihet humbja e mbështetjes në rastin e personit të ve apo të fëmijës si rezultat i vdekjes së mbajtësit të familjes; në rastin e personit të ve, e drejta e përfitimit

mund të kushtëzohet, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të vendit, me një gjendje pamundësie për të mbajtur veten.

2. Ligjet dhe aktet nënligjore të vendit mund të parashikojnë që përfitimi i një personi dhënë ndryshe, mund të ndërpritet, nëse ky person është i angazhuar në një aktivitet fitimprurës të parashikuar apo që përfitimi, nëse është kontributiv, mund të reduktohet kur të ardhurat e përfituesit e kalojnë masën e parashikuar dhe nëse është jokontributiv, mund të reduktohet kur të ardhurat e përfituesit apo mjetet e tjera të tij apo të dyja së bashku e kalojnë një shumë të përcaktuar.

Neni 61

Në personat e mbrojtur përfshihen:

a) bashkëshortet dhe fëmijët e mbajtësve të familjes në grupet e parashikuara të punonjësve që përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve;

b) bashkëshortet dhe fëmijët e mbajtësve të familjes në grupet e parashikuara të popullsisë ekonomikisht aktive, grupe që përbëjnë jo më pak se 20 për qind të të gjithë rezidentëve;

c) të gjitha veçurat dhe fëmijët rezidentë që kanë humbur mbajtësin e familjes së tyre, kur mjetet e jetesës së të cilëve gjatë rastit nuk i kalojnë kufijtë e parashikuar në mënyrë që të përputhen me kërkesat e nenit 67;

d) kur në fuqi është një deklaratë në bazë të nenit 3, bashkëshortet dhe fëmijët e mbajtësve të familjes në grupet e parashikuara të punonjësve, grupe të cilat përbëjnë jo më pak se 50 për qind të të gjithë punonjësve në vendet e punës në industri me 20 apo më shumë persona.

Neni 62

Përfitimi do të jetë një pagesë periodike e llogaritur si më poshtë:

a) kur grupe të punonjësve apo grupe ekonomikisht aktive janë të mbrojtur, llogaritja bëhet në mënyrë të tillë që të përputhet me kërkesat e nenit 65 ose të nenit 66;

b) për të gjithë rezidentët e mbrojtur, mjetet e të cilëve përgjatë ratit nuk e kalojnë limitin e përcaktuar, llogaritja bëhet në përputhje me kërkesat e nenit 67.

Neni 63

1. Përfitimi i specifikuar në nenin 62, në një rast të mbuluar, jepet të paktën:

a) për një person të mbrojtur, mbajtësi i familjes së të cilit ka plotësuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara, një periudhë kualifikimi, që mund të jetë 15 vjet kontribim apo punësim, apo 10 vjet rezidencë;

b) kur, në parim, bashkëshortet dhe fëmijët e të gjithë personave ekonomikisht aktivë janë të mbrojtur, një personi të mbrojtur, mbajtësi i familjes së të cilit ka plotësuar një periudhë kualifikimi prej tre vjetësh kontribimi dhe kur në lidhje me këtë mbajtës të familjes, për sa kohë që ai ka qenë në moshë pune, është paguar një shumë mesatare vjetore kontributive e parashikuar.

2. Kur përfitimi i referuar në paragrafin 1 kushtëzohet me një periudhë minimale kontribimi apo punësimi, jepet një përfitim i reduktuar të paktën:

a) për një person të mbrojtur, mbajtësi i familjes së të cilit ka plotësuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara, një periudhë kualifikimi prej pesë vjetësh kontribimi apo punësimi;

b) kur, në parim, bashkëshortet dhe fëmijët e të gjithë personave ekonomikisht aktivë janë të mbrojtur, për një person të mbrojtur, mbajtësi i familjes së të cilit ka plotësuar një periudhë kualifikimi prej tre vjetësh kontribimi dhe kur në lidhje me këtë mbajtës të familjes, për sa kohë që ai ka qenë në moshë pune, është paguar gjysma e shumës mesatare vjetore e kontributeve, e parashikuar në përputhje me nënparagrafin (b) të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kërkesat e paragrafit 3 të këtij neni konsiderohen të plotësohen, kur një përfitim, i llogaritur në përputhje me kërkesat e pjesës XI, por në një përqindje prej dhjetë pikësh më të ulëta sesa paraqitet në tabelën bashkëngjitur asaj pjese për përfituesin standard të interesuar, i jepet të

paktën një personi të mbrojtur, mbajtësi i familjes së të cilit ka plotësuar, në përputhje me rregullat e parashikuara, pesë vjet periudhë kontribuimi, punësimi apo rezidence.

4. Mund të bëhet një reduktim proporcional i përqindjes së treguar në tabelën e bashkëlidhur pjesës XI, kur periudha e kualifikimit për përfitimin që i korrespondon përqindjes së reduktuar i kalon pesë vjet kontribuimi apo kohë punësimi, por është më e vogël se 15 vjet kontribute apo kohë punësimi; përfitimi i reduktuar do të paguhet në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

5. Në mënyrë që një grua pa fëmijë, që presupozohet të jetë e paafte për të mbuluar shpenzimet e jetesës, të fitojë të drejtën e përfitimit familjar, mund të kërkohet që ajo të ketë plotësuar një periudhë minimum martese.

Neni 64

Përfitimi i specifikuar në nenet 62 dhe 63 do të jepet përgjatë rastit.

PJESA XI STANDARDET QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR PAGESËN PERIODIKE

Neni 65

1. Në rastin e një pagese periodike, për të cilën aplikohet ky nen, masa e përfitimit, e shtuar edhe me shumën e ndonjë shpërblimi familjar që paguhet përgjatë rastit, do të jetë e tillë që të arrijë, në lidhje me rastin në fjalë, përfitimin standard të paraqitur në tabelën bashkëlidhur kësaj pjese ose të paktën përqindjen e treguar aty të totalit të të ardhurave të mëparshme të përfituesit ose të mbajtësit të familjes së tij dhe të masës së çdo shpërblimi familjar që i paguhet një personi të mbuluar me të njëjtat përgjegjësi familjare si përfituesi standard.

2. Të ardhurat e mëparshme të përfituesit apo të mbajtësit të familjes së tij do të llogariten në përputhje me rregullat e përcaktuara dhe kur personat e mbrojtur apo mbajtësit e familjes së tyre janë të organizuar në grupe sipas të ardhurave të tyre, të ardhurat e tyre të mëparshme mund të llogariten nga të ardhurat bazë të grupeve të cilave ata u përkisnin.

3. Mund të parashikohet një kufi maksimum për shkallën e përfitimit apo për të ardhurat që merren në konsideratë për llogaritjen e përfitimit, nëse kufiri maksimal fiksohet në mënyrë të atillë që dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni të përputhen me atë pjesë ku të ardhurat e mëparshme të përfituesit të familjes së tij janë të barabarta apo më të ulëta sesa paga e një të punësuarit të kualifikuar në punën me dorë të seksit mashkull.

4. Të ardhurat e mëparshme të përfituesit apo të mbajtësit të familjes së tij, paga e një të punësuarit të kualifikuar të punës me dorë të seksit mashkull, përfitimi dhe çdo shpërblim familjar do të llogariten në të njëjtën bazë kohore.

5. Për përfituesit e tjerë, në përcaktimin e përfitimit do të mbahet parasysh një raport i arsyeshëm me përfitimin për përfituesin standard.

6. Për hir të këtij neni, i punësuar i kualifikuar që kryen punë dore i seksit mashkull do të jetë:

a) një montator apo një tornitor i angazhuar në prodhimin e makinerive, por jo të makinerive elektrike;

b) një person që konsiderohet tipik për punën e kualifikuar, i përzgjedhur në përputhje me dispozitat e paragrafit të mëposhtëm;

c) një person, të ardhurat e të cilit janë të barabarta ose më të larta se të ardhurat e 75 për qind të të gjithë personave të mbrojtur; këto të ardhura duhet të përcaktohen mbi bazë vjetore apo periudhash më të shkurtra, siç mund të përcaktohet;

d) një person, të ardhurat e të cilit janë të barabarta me 125 për qind e të ardhurave mesatare të të gjithë personave të mbrojtur.

7. Personi tipik i një pune të kualifikuar për qëllimet e nënparagrafit (b) të paragrafit të mëparshëm do të jetë një person i punësuar në grupet kryesore të aktiviteteve ekonomike me numrin

më të madh të personave ekonomikisht aktivë të seksit mashkull, të mbrojtur, në rastin në fjalë apo të mbajtësve të familjes të personave të mbrojtur, sipas rastit, në ndarjet që përfshijnë numrin më të madh të këtyre personave apo të mbajtësve të familjes; për hir të këtij paragrafi, do të përdoret klasifikimi standard ndërkombëtar i punës për të gjitha aktivitetet ekonomike, miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara në sesionin e 27-të në gusht 1948 dhe riprodhuar në aneksin e kësaj Konvente ose një klasifikim i tillë i amenduar në çdo kohë.

8. Kur masa e përfitimit ndryshon sipas rajonit, punonjësi mashkull i kualifikuar në punën me dorë mund të përcaktohet për çdo rajon në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni.

9. Paga e punonjësit mashkull të kualifikuar në punën me dorë do të përcaktohet në bazë të masës së pagave për orar normal të punës të vendosur në marrëveshjet kolektive, sipas apo në zbatim të legjislacionit apo rregullave të vendit, ku është e zbatueshme, ose duke përfshirë shpërblimet për koston e jetesës, nëse ka të tilla; kur këto masa ndryshojnë sipas rajonit, por paragrafi 8 i këtij neni nuk aplikohet, merret një masë mesatare.

10. Masat e pagesave aktuale periodike për efekt pleqërie, dëmtimit në punë (përveç rastit të paaftësisë për punë), invaliditetit dhe vdekjes së mbajtësit të familjes, do të rishikohen në bazë të ndryshimeve të konsiderueshme në nivelin e përgjithshëm të të ardhurave, kur këto rezultojnë nga ndryshimet e konsiderueshme të koston së jetesës.

Neni 66

1. Në rast pagese periodike, për të cilën aplikohet ky nen, masa e përfitimit e shtuar me masën e një shpërblimi për familjen që paguhet gjatë rastit, do të jetë e tillë që për rastin në fjalë të arrijë standardin e përcaktuar për përfituesin në tabelën e bashkëngjitur kësaj pjese, të paktën për të arritur përqindjen e treguar këtu të pagës së përgjithshme të një punëtori të rritur, të zakonshëm, të seksit mashkull dhe të masës së shpërblimit për familjen që i paguhet një personi të mbrojtur me të njëjtat përgjegjësi familjare si përfituesi standard.

2. Paga e një punëtori të zakonshëm, të rritur, të seksit mashkull, përfitimi dhe çdo shpërblim për familjen do të llogariten në të njëjtën bazë kohore.

3. Për përfituesit e tjerë, përfitimi do të ketë të njëjtën lidhje të arsyeshme me përfitimin për përfituesin standard.

4. Për hir të këtij neni, punëtor i zakonshëm, i rritur, i seksit mashkull do të quhet:

a) një person i konsideruar tipik i punës së pakualifikuar në prodhimin e makinerive, por jo të pajisjeve elektrike;

b) një person i konsideruar tipik i punës së pakualifikuar i përzgjedhur në përputhje me dispozitat e paragrafit të mëposhtëm.

5. Personi i konsideruar tipik i punës së pakualifikuar, për hir të nënparagrafit (b) të paragrafit të mëparshëm, do të jetë një person i punësuar në grupet kryesore të aktiviteteve ekonomike me numrin më të madh të personave ekonomikisht aktivë të seksit mashkull të mbrojtur, në rastin në fjalë, apo të mbajtësve të familjes të personave të mbrojtur, sipas rastit, në ndarjet që përfshijnë numrin më të madh të këtyre personave apo të mbajtësve të familjes; për këtë qëllim do të përdoret klasifikimi standard ndërkombëtar i punës për të gjitha aktivitetet ekonomike, miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara në sesionin e 27-të në gusht 1948 dhe riprodhuar në aneksin e kësaj Konvente ose një klasifikim i tillë i amenduar në çdo kohë.

6. Kur masa e përfitimit ndryshon sipas rajonit, punëtori i rritur, mashkull, i zakonshëm mund të përcaktohet për çdo rajon në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Paga e punëtorit të rritur, mashkull, të zakonshëm do të përcaktohet në bazë të masës së pagave në një orar normal pune të vendosur në marrëveshjet kolektive, sipas apo në zbatim të legjislacionit apo rregullave të vendit, ku është e zbatueshme, ose duke përfshirë shpërblimet për koston e jetesës, nëse ka të tilla; kur këto masa ndryshojnë sipas rajonit, por paragrafi 6 i këtij neni nuk aplikohet, merret një masë mesatare.

8. Masat e pagesave aktuale periodike për efekt pleqërie, dëmtimi në punë (përveç rastit të paaftësisë për punë), invaliditetit dhe vdekjes së mbajtësit të familjes, do të rishikohen në bazë të

ndryshimeve të konsiderueshme në nivelin e përgjithshëm të të ardhurave, kur këto rezultojnë nga ndryshimet e konsiderueshme të kostos së jetesës.

Neni 67

Në rastin e pagesës periodike, për të cilën aplikohet ky nen:

- a) masa e përfitimit do të përcaktohet sipas një shkalle të përcaktuar apo një shkalle të fiksuar nga autoritetet publike kompetente në përputhje me rregulla të përcaktuara;
- b) kjo masë përfitimi mund të reduktohet vetëm në atë masë që mjetet e tjera të familjes së përfituesit kalojnë masat bazë të përcaktuara apo masat bazë të fiksuara nga autoriteti publik kompetent në përputhje me rregulla të përcaktuara:

IX	Përfitim invaliditeti	Burri me gruan me dy fëmijë	40
X	Përfitim për familjen	Vejushë me dy fëmijë	40

PJESA XII

TRAJTIMI I BARABARTË I SHTETASVE REZIDENTË JONACIONALË

Neni 68

1. Rezidentët jovendas do të kenë të njëjtat të drejta si edhe rezidentët vendas, nëse për rezidentët jovendas dhe vendas, të lindur jashtë territorit të shtetit anëtar, mund të përcaktohen rregulla të veçanta lidhur me përfitimet apo pjesët e përfitimeve, të cilat paguhen tërësisht apo kryesisht nga fondet publike dhe në lidhje me skemat transitive.

2. Në skemat kontributive të mbrojtjes sociale, të cilat mbrojnë punonjësit, personat e mbrojtur që janë shtetas të një vendi tjetër anëtar, i cili ka pranuar detyrimet e pjesës përkatëse të Konventës, sipas asaj pjese, do të kenë të njëjtat të drejta si shtetasit e shtetit anëtar në fjalë, nëse aplikimi i këtij paragrafi mund të jetë subjekt i ekzistencës së një marrëveshjeje dypalëshe dhe shumëpalëshe e cila siguron reciprocitet.

PJESA XIII

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 69

Përfitimi, të drejtën për të cilin një person i mbrojtur e ka fituar ndryshe sipas çdonjëres prej pjesëve II deri X të kësaj Konvente mund të ndërpritet deri në atë shkallë që mund të përcaktohet:

- a) për aq kohë sa personi në fjalë nuk është i pranishëm në territorin e vendit anëtar;
- b) për aq kohë sa personi në fjalë mbahet me shpenzime publike apo me shpenzimet e një institucioni apo shërbimi të mbrojtjes sociale, subjekti i çdo pjese të përfitimit që kalon vlerën e kësaj përkrahjeje dhënë personave në varësi të përfituesit;
- c) për aq kohë sa personi në fjalë vazhdon të marrë një përfitim në të holla nga një skemë tjetër e mbrojtjes sociale, e ndryshme nga përfitimi p3857XI jen dhe gjatë një periudhe për të cilën ai është siguruar për rastin nga një palë e tretë, subjekt i pjesës së përfitimit që është ndërprerë, duke mos kaluar përfitimin tjetër apo zhdëmtimin nga një palë e tretë;
- d) kur personi në fjalë ka paraqitur një pretendim të rremë;
- e) kur rasti është pasojë e një veprimi kriminal të kryer nga personi në fjalë;
- f) kur rasti është shkaktuar nga një shkelje apo sjellje e keqe e paramenduar e personit në fjalë;

g) në raste të përshtatshme, kur personi në fjalë neglizhon të përdorë shërbimet mjekësore apo të rehabilitimit të vëna në dispozicion të tij apo kur ai nuk vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara për verifikimin e ndodhisë apo vazhdimin e rastit ose për sjelljen e përfituesve;

h) në rastin e përfitimit të papunësisë, kur personi në fjalë nuk arrin të shfrytëzojë shërbimet e punësimit vënë në dispozicion të tij;

i) në rastin e përfitimit të papunësisë, kur personi në fjalë ka humbur punën si rezultat direkt i ndërprerjes së punës për shkak të një mosmarrëveshjeje pune ose kur ai është larguar vullnetarisht pa ndonjë arsye të justifikuar;

j) në rastin e përfitimit familjar, për aq kohë sa një e ve jeton me një burrë si bashkëshortja e tij.

Neni 70

1. Çdo person që ka një kërkesë apo pretendim ka të drejtë të apelojë në rast refuzimi të përfitimit apo të ankohet për madhësinë apo cilësinë e tij.

2. Kur në zbatim të kësaj Konvente, një departamenti shtetëror përgjegjës në një legjislaturë i besohet administrimi i kujdesit shëndetësor, e drejta për apelim, parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të zëvendësohet nga e drejta për t'u ankuar lidhur me refuzimin e kujdesit shëndetësor apo cilësinë e përkujdesjes së marrë, investiguar nga autoritetet përkatëse.

3. Kur kërkesa zgjidhet nga një trup gjyqësor i veçantë i ngritur për të trajtuar çështje të mbrojtjes sociale dhe në të cilin ka përfaqësues nga personat e mbrojtur, nuk kërkohet e drejta e apelimt.

Neni 71

1. Kostot e përfitimeve, të dhëna në përputhje me këtë Konventë dhe kostoja e administrimit të këtyre përfitimeve do të përballohen kolektivisht nga kontributet e sigurimeve apo taksat, apo të dyja së bashku, në mënyrë të atillë që të evitohen krijimin e vështirësive për personat me pak mjete jetese dhe merr parasysh gjendjen ekonomike të vendit anëtar dhe të grupeve të personave të mbrojtur.

2. E gjithë masa e kontributeve të sigurimeve që përballohet nga punonjësit nuk do të kalojë 50 për qind të totalit të burimeve financiare të alokuara për mbrojtjen e punonjësve dhe të bashkëshorteve e fëmijëve të tyre. Për t'u siguruar që ky kusht është plotësuar, të gjitha përfitimet e dhëna nga vendi anëtar, në përputhje me këtë Konventë, përveç përfitimit familjar dhe, nëse jepet nga një degë e veçantë, edhe përfitimi për aksident në punë, mund të merren së bashku.

3. Shteti anëtar do të pranojë përgjegjësinë për dhënien në kohë të përfitimeve në përputhje me këtë Konventë dhe do të marrë të gjitha masat për këtë qëllim; ai do të sigurojë, kur është e përshtatshme, që studimet e nevojshme aktuariale dhe llogaritjet lidhur me ekuilibrin financiar do të bëhen periodikisht dhe në çdo rast, para çdo ndryshimi të përfitimeve, masës së kontributeve të sigurimit apo taksave të alokuara për të mbuluar rastet në fjalë.

Neni 72

1. Kur administrimi nuk i besohet ndonjë institucioni me rregullore të përcaktuar nga autoritetet publike apo nga një departament shtetëror përgjegjës për një legjislaturë, përfaqësuesit e personave të mbrojtur do të marrin pjesë në menaxhim apo do të angazhohen në lidhje me të në një strukturë konsultative sipas kushteve të përcaktuara; legjislacioni apo rregullat kombëtare po ashtu mund të vendosin për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të punëdhënësve, si dhe të autoriteteve publike.

2. Shteti anëtar do të pranojë të gjithë përgjegjësinë për administrimin e duhur të institucioneve dhe shërbimeve në fjalë në zbatim të Konventës.

PJESA XIV
DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 73

Konventa nuk do të aplikohet për:

- a) rastet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të pjesës përkatëse të Konventës për shtetin anëtar në fjalë;
- b) përfitimet në rastet që janë shfaqur pas hyrjes në fuqi të pjesës përkatëse të Konventës për shtetin anëtar në fjalë, për sa kohë që të drejtat për përfitime të tilla janë rrjedhim i periudhave që paraprijnë këtë datë.

Neni 74

Kjo Konventë nuk do të konsiderohet si rishikim i ndonjë konvente ekzistuese.

Neni 75

{Shënim. Dispozitat në vijim të nenit 75 janë të përfshira në konventat nr.121 (neni 29), 128 (neni 45) dhe 130 (neni 36).}

Në rast se ndonjë konventë, që mund të miratohet në vijim nga konferenca, parashikon lidhur me ndonjë subjekt apo subjekte, të cilat trajtohen në këtë Konventë, atëherë këto dispozita të kësaj Konvente, siç mund të specifikohet në Konventën në fjalë, nuk do të aplikohen më në secilin vend anëtar që ka ratifikuar Konventën në fjalë duke nisur nga data që Konventa në fjalë hyn në fuqi për atë vend anëtar.

Neni 76

1. Secili shtet anëtar që ratifikon këtë Konventë do të përfshijë në raportin vjetor për aplikimin e kësaj Konvente sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës:

- a) informacion të plotë mbi ligjet dhe rregullat që bëjnë efektive dispozitat e Konventës;
- b) të dhëna që, për sa i përket formës së paraqitjes, duhet të realizojnë sa më shumë që të jetë e mundur sugjerimet e bëra nga Zyra Ndërkombëtare e Punës për një uniformitet më të madh, mbi plotësimin e kërkesave për statistikat të specifikuara në:
 - i) Nenet 9 (a), (b), (c) ose (d); 15 (a), (b) ose (d); 21 (a) ose (c); 27 (a), (b) ose (d); 33 (a) ose (b); 41 (a), (b) ose (d); 48 (a), (b) ose (c), 55 (a (a), (b) ose (d); 61 (a), (b) ose (d), lidhur me numrin e personave të mbrojtur;
 - ii) Nenet 44, 65, 66 ose 67, për sa i përket masës së përfitimit;
 - iii) Nënparagrafin (a) të paragrafit 2 të nenit 18, për sa i përket kohëzgjatjes së përfitimit për sëmundje;
 - iv) Paragrafin 2 të nenit 24, për sa i përket kohëzgjatjes së përfitimit të papunësis; dhe.
 - v) Paragrafin 2 të nenit 71, për sa i përket pjesës së burimeve financiare që përbëhet nga kontributet e sigurimeve të punonjësve të mbrojtur.

2. Secili shtet anëtar që ratifikon këtë Konventë, do t'i raportojë, në intervale të caktuara kohe, Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, sipas kërkesës së Këshillit Drejtues, mbi situatën e legjislacionit dhe praktikave të tij, për sa i përket pjesëve II deri në X të Konventës, të cilat nuk janë specifikuar në ratifikimin e saj apo në ndonjë njoftim të bërë në vijim duke u mbështetur në nenin 4.

Neni 77

1. Kjo Konventë nuk gjen zbatim për detarët apo peshkatarët; dispozita për mbrojtjen e detarëve dhe peshkatarëve është hartuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në Konventën për Mbrojtjen Sociale (Detare) e vitit 1946 dhe Konventën për Pensionet e Detarëve e vitit 1946.

2. Një shtet anëtar mund të përjashtojë detarët dhe peshkatarët nga numri i punonjësve, popullsisë ekonomike aktive apo i rezidentëve, kur llogarit përqindjen e punonjësve apo të rezidentëve të mbrojtur në përputhje me secilën nga pjesët II deri në X, të mbuluara nga ratifikimi i saj.

PJESA XV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 78

Ratifikimi formal i kësaj Konvente do t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 79

1. Kjo Konventë do të jetë detyruese vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën ratifikimi i dy shteteve anëtare është regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për secilin shtet anëtar dymbëdhjetë muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimeve të tyre.

Neni 80

1. Deklaratat që do t'i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, do të bëjnë të njohura:

a) territoret në lidhje me të cilat shteti anëtar në fjalë merr përsipër që të zbatojë dispozitat e Konventës pa i ndryshuar ato;

b) territoret në lidhje me të cilat ai merr përsipër të zbatojë dispozitat e Konventës me ndryshime, së bashku me të dhëna të hollësishme për këto ndryshime;

c) territoret në lidhje me të cilat Konventa është e pazbatueshme, dhe në këto raste, arsyet përse ajo nuk mund të zbatohet;

d) territoret në lidhje me të cilat ai ka rezerva për vendimin dhe mendon se ka nevojë për një studim të mëtejshëm të situatës;

2. Veprimet e ndërmarra, referuar në nënparagrafët (a) dhe (b) të paragrafit 1 të këtij neni, do të konsiderohen pjesë përbërëse e ratifikimit dhe do të kenë fuqinë e ratifikimit.

3. Secili shtet anëtar mundet që në çdo kohë të pezullojë, me anë të një deklaratë, në tërësi ose pjesërisht çdo rezervim që ka bërë në deklaratën e tij origjinale, lidhur me nënparagrafët (b), (c) ose (d) të paragrafit 1 të këtij neni.

4. Secili shtet anëtar, në çdo kohë që Konventa është subjekt i denoncimit në përputhje me dispozitat e nenit 82, mund t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë që modifikon termat e çdo deklaratë të mëparshme dhe që shpreh situatën aktuale lidhur me territoret, siç mund të specifikohet.

Neni 81

1. Deklaratat që i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me paragrafët 4 ose 5 të nenit 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës duhet të tregojnë nëse dispozitat e Konventës do të zbatohen në territorin në fjalë pa modifikime apo do t'i nënshtrohen modifikimeve; kur në deklaratë të shprehet dispozitat do të zbatohen duke iu nënshtuar modifikimeve, do të jepen detaje për modifikimet në fjalë.

2. Shteti anëtar, shtetet anëtare apo autoriteti ndërkombëtar i interesuar mundet që me anë të një deklaratë të mëvonshme të denoncojë në çdo kohë, në tërësi apo pjesërisht, të drejtën për rekurs ndaj çdo modifikimi të shprehur në çdo deklaram të mëparshëm.

3. Shteti anëtar, shtetet anëtare apo autoriteti ndërkombëtar i interesuar, në çdo kohë që Konventa bëhet subjekt i denoncimit, në përputhje me dispozitat e nenit 82, mund t'i komunikojë drejtorit të përgjithshëm një deklaratë që modifikon në çdo lloj drejtimi termat e çdo deklaratë të mëparshme dhe që paraqet situatën aktuale në lidhje me zbatimin e Konventës.

Neni 82

1. Secili shtet anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë, ka të drejtë që pas dhjetë vjetësh nga data e hyrjes për herë të parë në fuqi të Konventës të denoncojë Konventën ose një apo më shumë nga pjesët II deri në X të saj me anë të një akti që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk do të ketë fuqi për një periudhë njëvjeçare pas datës së regjistrimit.

2. Secili shtet anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që nuk ushtron të drejtën e denoncimit, në përputhje me sa parashikon ky nen, brenda vitit që pason mbarimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraardhës, është i detyruar ta zbatojë edhe për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj mund ta denoncojë këtë Konventë ose ndonjë nga pjesët II deri në X të saj në mbarim të secilës periudhë dhjetëvjeçare sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 83

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i janë komunikuar atij nga anëtarët e organizatës.

2. Kur të njoftojë anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i është komunikuar, Drejtori i Përgjithshëm do të tërheqë vëmendjen e shteteve anëtare të Organizatës për datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 84

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i komunikojë për regjistrim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në bazë të nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të dhënat e plota për të gjitha ratifikimet dhe aktet e denoncimit të regjistruara prej tij në përputhje me dispozitat e neneve paraardhëse.

Neni 85

Sa herë që do të konsiderohet e nevojshme, Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë nëse mund të vihet në rend të ditës të Konferencës çështja e rishikimit të saj në tërësi apo pjesërisht.

Neni 86

1. Nëse Konferenca miraton një konventë të re që e rishikon këtë Konventë tërësisht apo pjesërisht, atëherë nëse nuk parashikohet ndryshe në konventën e re:

a) ratifikimi nga një shtet anëtar i konventës së re të rishikuar do të kërkojë de jure denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 82, nëse dhe kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi;

b) nga data kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo konventë nuk është më e hapur për ratifikim nga shtetet anëtare.

2. Kjo Konventë në çdo rast mbetet në fuqi me formën dhe përmbajtjen aktuale për ato shtete anëtare që e kanë ratifikuar atë, por nuk e kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 87

Versionet anglisht dhe frëngjisht të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të barabarta.

SHTOJCË KLASIFIKIMI STANDARD NDËRKOMBËTAR I PUNËVE PËR TË GJITHA AKTIVITETET EKONOMIKE (RISHIKUAR DERI NË 1968)

Lista e kategorive kryesore të punës, kategoritë dhe grupet kryesore

Kategoria kryesore 1. Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi

Kategoria	Grupi kryesor	
11		Bujqësia dhe gjuetia
	111	Bujqësia dhe prodhimi blegtoral
	112	Shërbimet bujqësore
	113	Gjuetia, kapja dhe shumimi i kafshëve të gjahut
12		Pylltaria dhe prerja e transportimi i trupave
	121	Pylltaria
	122	Prerja dhe transportimi i trupave
13	130	Peshkimi

Kategorita kryesore 2. Shfrytëzimi i minierave dhe gurëve

Kategoria	Grupi kryesor	
21	210	Nxjerrja e qymyrit
22	220	Prodhimi i naftës së papërpunuar dhe gazit natyror
23	230	Nxjerrja e xeherorit të metalit
29	290	Shfrytëzime të tjera minerare

Kategoria kryesore 3. Prodhimi

Kategoria	Grupi kryesor	
31		Prodhimi i mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit
	311-312	Prodhimi i mallrave ushqimore
	313	Industria e pijeve
	314	Manifaktura e duhanit
32		Industria e tekstileve, veshjeve dhe lëkurës
	321	Prodhimi i tekstileve
	322	Prodhimi i veshjeve, përveç prodhimit të këpucëve
	323	Manifaktura e lëkurës dhe prodhimeve të lëkurës, e materialeve që zëvendësojnë lëkurën dhe peliçeve, përveç prodhimit të këpucëve dhe veshjeve

	324	Prodhimi i këpucëve, përveç këpucëve plastike apo të derdhura
33		Përpunimi i drurit dhe prodhimet prej druri, duke përfshirë mobiljet
	331	Përpunimi i drurit dhe prodhimi i produkteve prej druri dhe tape, përveç mobiljeve
	332	Prodhimi i mobiljeve dhe orendive të fiksuara, përveç atyre me bazë metalike
34		Prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës, shtypshkrimi dhe botimi
	341	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre
	342	Shtypshkrimi, botimi dhe industritë simotra
35		Prodhimi i kimikateve dhe i produkteve kimike, të naftës, qymyrit, gomës e kauçukut dhe atyre plastike
	351	Prodhimi i kimikateve industriale
	352	Prodhimi i produkteve të tjera kimike
	353	Rafineritë e naftës
	354	Prodhimi i produkteve të ndryshme të naftës dhe qymyrit
	355	Prodhimi i produkteve të gomës dhe kauçukut
	356	Prodhimi i produkteve plastike që nuk janë klasifikuar në tjetër vend
36		Prodhimi i produkteve minerare jometalike, përveç produkteve të naftës dhe qymyrit
	361	Prodhimi i produkteve prej qeramike, porcelani dhe argjile (baltë)
	362	Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit
	369	Prodhimi i produkteve të tjera minerare jometalike
37		Industritë bazë të metalit
	371	Industritë bazë të hekurit dhe çelikut
	372	Industritë bazë të metaleve me ngjyra
38		Prodhimi i produkteve të metaleve të fabrikua, makinerive dhe pajisjeve
	381	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve
	382	Prodhimi i makinerive, përveç pajisjeve elektrike
	383	Prodhimi i aparaturave, pajisjeve dhe mjeteve elektrike
	384	Prodhimi i mjeteve të transportit
	385	Prodhimi i mjeteve profesionale, shkencore, matëse, kontrolluese, të paklasifikuara tjetërkund dhe i mallrave fotografike
39	390	Industri të tjera prodhuese

Kategoria kryesore 4. Energjia elektrike, gazi dhe uji

Kategoria	Grupi kryesor	
41	410	Energjia elektrike, gazi dhe avulli
42	420	Sistemet e furnizimit me ujë dhe pajisjet përkatëse

Kategoria kryesore 5. Ndërtimi

Kategoria	Grupi kryesor	
50	500	Ndërtimi

Kategoria kryesore 6. Tregtia me shumicë dhe pakicë, restorantet dhe hotelet

Kategoria	Grupi kryesor	
61	610	Tregtia me shumicë
62	620	Tregtia me pakicë
63		Restorantet dhe hotelet
	631	Restorantet, kafenetë dhe vende të tjera ku hahet dhe pihet
	632	Hotelet, pensionet, kampet dhe vende të tjera banimi

Kategoria kryesore 7. Transporti, magazinimi dhe komunikacioni

Kategoria	Grupi kryesor	
71		Transporti dhe magazinimi
	711	Transporti tokësor
	712	Transporti ujor
	713	Transporti ajror
	719	Shërbimet që lidhen me transportin
72	720	Komunikacioni

Kategoria kryesore 8. Financat, sigurimet, shërbimet për pasuritë e patundshme dhe biznesin

Kategoria	Grupi kryesor	
81	810	Institucionet financiare
82	820	Sigurimet
83		Shërbimet për pasuritë e patundshme dhe biznesin
	831	Pasuritë e patundshme
	832	Shërbime biznesi, përveç marrjes dhe dhënies me qira të makinerive dhe pajisjeve
	833	Marrja dhe dhënia me qira e makinerive dhe pajisjeve

Kategoria kryesore 9. Shërbimet komunitare, sociale dhe personale

Kategoria	Grupi kryesor	
91	910	Administrimi publik dhe mbrojtja
92	920	Shërbimet sanitare dhe të tjera të përafërta
93		Shërbimet sociale dhe ato që lidhen me komunitetin
	931	Shërbimet edukative dhe arsimore
	932	Institutet kërkimore dhe shkencore
	933	Shërbimet mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera shëndetësore dhe veterinarë
	934	Institucionet e ndihmës sociale
	935	Shoqatat e biznesit, profesionale dhe të punës
	939	Shërbime të tjera sociale dhe që lidhen me komunitetin
94		Shërbime për çlodhje kulturore
	941	Filma dhe shërbime të tjera argëtuese

	942	Biblioteka, muzeume, kopshte botanike dhe zoologjike dhe shërbime të tjera kulturore, të paklasifikuara tjetërkund
	949	Shërbime për argëtim dhe çlodhje, të paklasifikuara tjetërkund
95		Shërbime personale dhe shtëpiake
	951	Shërbime riparimi, të paklasifikuara tjetërkund
	952	Lavanderi me vetëshërbim, shërbim larje-hekurosje dhe impiante larjeje dhe ngjyrosjeje
	953	Shërbime shtëpiake
	959	Shërbime të ndryshme personale
96	960	Organizata ndërkombëtare dhe organizata të tjera ekstra-territoriale

Kategoria kryesore 0. Aktivitete të papërcaktuara qartë

Kategoria	Grupi kryesor	
0	000	Aktivitete të papërcaktuara qartë

LIGJ
Nr. 8960, datë 24.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E KARTËS SOCIALE EUROPIANE, E NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 19, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 28 dhe 29 të Kartës Sociale Europiane, të ndryshuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3539, datë 6.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.75, viti 2002

HYRJE

Qeveritë nënshkruese të kësaj, duke qënë anëtare të Këshillit të Europës.

Duke konsideruar që synimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllim që të ruajnë dhe realizojnë idealet dhe parimet që janë trashëgimi e tyre e përbashkët dhe për të lehtësuar përparimin ekonomik dhe shoqëror, veçanërisht nëpërmjet ruajtjes dhe realizimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke konsideruar që në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, dhe Protokollin e saj, Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës ranë dakord t'u sigurojnë popullsisë së tyre liritë dhe të drejtat politike të specifikuar aty;

Duke konsideruar që në Kartën Sociale Europiane, të hapur për nënshkrim në Torino më 18 tetor 1961, dhe Protokollin e saj, Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës ranë dakord të përmirësojnë standardin e tyre të jetesës dhe mirëqenien e tyre sociale;

Duke rikujtuar që Konferenca Ministrore mbi të Drejtat e Njeriut e mbajtur në Romë më 5 nëntor 1990 theksoi nevojën, nga njëra anë të ruajë natyrën e pandashme të të gjitha të drejtave të njeriut, qofshin ato civile, politike, ekonomike, sociale ose kulturore dhe, nga ana tjetër, t'i japë një impuls të ri Kartës Sociale Europiane;

Të vendosura, siç u vendos gjatë Konferencës Ministrore të mbajtur në Torino më 21 dhe 22 tetor 1991, për të aktualizuar dhe përshtatur përmbajtjen thelbësore të Kartës në mënyrë që të merren parasysh veçanërisht ndryshimet themelore sociale që kanë ndodhur që nga koha kur u miratua teksti;

Duke njohur avantazhin e trupëzimit në një Kartë të ndryshuar, të planifikuar për të zënë progresivisht vendin e Kartës Sociale Europiane, të të drejtave të garantuara nga Karta siç është amenduar, të të drejtave të garantuara nga Protokollin Shtesë i 1988-ës dhe të shtojnë të drejta të reja.

Ranë dakord si më poshtë:

PJESA I

Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive:

1. Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.
2. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për kushte të drejta pune.
3. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme.
4. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për një pagë të drejtë të mjaftueshme për një standard jetese të përshtatshëm për ata dhe familjet e tyre.
5. Të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit kanë të drejtën e lirisë së shoqërizimit në organizata kombëtare ose ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale.
6. Të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit kanë të drejtë të negociojnë në mënyrë kolektive.
7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen.
8. Gratë e punësuar, në rast të shtatzënisë, kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë.
9. Cilido ka të drejtë për lehtësi të përshtatshme për orientim profesional me synimin që të ndihmohet për të zgjedhur një punë që i përshtatet aftësive dhe interesave të tij profesionale.
10. Cilido ka të drejtë për lehtësi të përshtatshme për trajnim profesional.
11. Cilido ka të drejtë të përfitojë nga çfarëdo masash që i lejojnë atij të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit.
12. Të gjithë punëtorët dhe personat e varur prej tyre kanë të drejtë për sigurim shoqëror.

13. Cilido pa burime të përshtatshme ka të drejtë për asistencë sociale dhe mjekësore.
14. Cilido ka të drejtë të përfitojë nga shërbimet e mirëqenies sociale.
15. Personat e gjymtuar kanë të drejtë për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.
16. Familja si një njësi themelore e shoqërisë ka të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale për të siguruar zhvillimin e saj të plotë.
17. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale.
18. Shtetasit e cilëso nga Palët kanë të drejtën të angazhohen në punë fitimprurëse në territorin e cilëso nga të tjerat në bazë barazie me shtetasit e të fundit, duke iu nënshtruar kufizimeve të bazuara në arsye bindëse ekonomike ose shoqërore.
19. Punëtorët emigrantë, të cilët janë shtetas të një Pale, dhe familjet e tyre kanë të drejtë për mbrojtje dhe asistencë në territorin e çdo Pale tjetër.
20. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa dallim mbi bazë seksu.
21. Punëtorët kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen brenda ndërmarrjes.
22. Punëtorët kanë të drejtë të marrin pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisin e punës në ndërmarrje.
23. Çdo person i moshuar ka të drejtë për mbrojtje sociale.
24. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mbrojtje në rast të përfundimit të punësimit.
25. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mbrojtje të pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të punëdhënësit të tyre.
26. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për dinjitet në punë.
27. Të gjithë personat me përgjegjësi familjare dhe që janë angazhuar ose dëshirojnë të angazhohen në punësim kanë të drejtë ta bëjnë këtë pa iu nënshtruar diskriminimit dhe, sa të jetë e mundur, pa konflikt ndërmjet përgjegjësive të tyre familjare dhe të punësimit.
28. Përfaqësuesit e punëtorëve në ndërmarrje kanë të drejtë për mbrojtje kundër akteve paragjyqëse ndaj tyre dhe duhet t'u jepen lehtësi të përshtatshme për të kryer funksionet e tyre.
29. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen në procedura shkurtimesh kolektive nga puna.
30. Cilido ka të drejtë për mbrojtje kundër varfërisë dhe përjashtimit social.
31. Cilido ka të drejtë për strehim.

PJESA II

Palët angazhohen, siç parashikohet në pjesën III, ta konsiderojnë veten të detyruara nga detyrimet e parashtruara në nenet dhe paragrafët e mëposhtme.

Neni 1 E drejta për punë

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen:

1. të pranojnë si një nga synimet dhe përgjegjësitë e tyre parësore arritjen dhe mbajtjen e një niveli sa më të lartë e të qëndrueshëm të mundshëm punësimi, me synim që të arrihet punësim i plotë;
2. të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht;
3. të krijojnë dhe mbajnë shërbime punësimi falas për të gjithë punëtorët;
4. të japin dhe të nxisin orientim, trajnim dhe rihabilitim profesional të përshtatshëm.

Neni 2

E drejta për kushte të drejta pune

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për kushte të drejta pune, Palët angazhohen:

1. të marrin masa për orar pune ditorë e javorë të arsyeshëm, që java e punës të ulet progresivisht në masën që e lejojnë rritja e produktivitetit dhe faktorëve të tjerë përkatës;
2. të marrin masa për ditë pushimi publik të paguara;
3. të marrin masa për një leje vjetore të paguar prej një minimumi prej katër javësh;
4. të eliminojnë rreziqet në punë vetvetisht të rrezikshme ose të pashëndetshme dhe, kur nuk ka qenë akoma e mundur, të eliminojnë ose ulin këto rreziqe mjaftueshëm, të marrin masa ose për një shkurtim të orëve të punës ose për pushime shtesë të paguara për punëtorët e angazhuar në këto punë;
5. të sigurojnë një periudhë javore pushimi, e cila, sa të jetë e mundur, të përkojë me ditën e njohur nga tradita ose zakoni në vendin ose rajonin në fjalë si një ditë pushimi;
6. të sigurojnë që punëtorët të jenë të informuar me shkrim, sa më parë të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se dy muaj pas datës së fillimit të punësimit të tyre, për aspektet thelbësore të kontratës ose marrëdhënies së punësimit;
7. të sigurojnë që punëtorët që bëjnë punë natën të përfitojnë nga masa që marrin parasysht natyrën e veçantë të punës.

Neni 3

E drejta për kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune, Palët angazhohen, në konsultim me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve:

1. të formulojnë, realizojnë dhe rishikojnë periodikisht një politikë kombëtare koherente për sigurimin në punë, shëndetin në punë dhe mjedisin e punës. Synimi parësor i kësaj politike do të jetë përmirësimi i sigurimit dhe shëndetit në punë dhe të parandalohen aksidentet dhe dëmtimet e shëndetit që lindin nga, lidhen me ose ndodhin gjatë punës, veçanërisht duke minimizuar shkaqet e rreziqeve të vetvetishme në mjedisin e punës;
2. të nxjerrin rregullore shëndeti dhe siguri;
3. të marrin masa për zbatimin e këtyre rregulloreve me masa mbikëqyrjeje;
4. të nxisin zhvillimin progresiv të shërbimeve të shëndetit në punë për të gjithë punëtorët me funksione thelbësisht parandaluese dhe këshillimore.

Neni 4

E drejta për pagë të drejtë

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për një pagë të drejtë, Palët angazhohen:

1. të njohin të drejtën e punëtorëve për një pagë të tillë që do t'u japë atyre dhe familjeve të tyre një standard të përshtatshëm jetese;
2. të njohin të drejtën e punëtorëve për njësi page të shtuar për punën jashtë orarit, me përjashtime në raste të veçanta;
3. të njohin të drejtën e punëtorëve burra e gra për pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë;
4. të njohin të drejtën e të gjithë punëtorëve për një periudhë të arsyeshme njoftimi për përfundimin e punësimit;
5. të lejojnë zbritjet nga rroga vetëm në kushtet dhe në masën e parashikuar nga ligjet ose rregulloret kombëtare ose të fiksuar në marrëveshjet kolektive ose në vendimet e arbitrazhit.

Ushtrimi i këtyre të drejtave do të arrihet me marrëveshje kolektive të përfunduara lirisht, me mekanizma ligjorë të fiksimit të pagave ose me mjete të tjera të përshtatshme me kushtet kombëtare.

Neni 5

E drejta për t'u organizuar

Me synimin për të siguruar dhe nxitur lirinë e punëtorëve dhe punëdhënësve për të formuar organizata lokale, kombëtare ose ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale dhe për t'u anëtarësuar në ato organizata, Palët angazhohen që legjislacioni kombëtar nuk do të jetë i tillë që të pengojë dhe as do të zbatohet që të pengojë këtë liri. Masa në të cilën këto garanci të dhëna do të zbatohen për policinë do të përcaktohen me ligje ose rregullore kombëtare. Parimi që rregullon zbatimin e këtyre garancive për anëtarët e forcave të armatosura dhe masa në të cilën ato do të zbatohen për personat e kësaj kategorie do të rregullohet gjithashtu me ligje ose rregullore kombëtare.

Neni 6

E drejta për të negociuar kolektivisht

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për të negociuar kolektivisht, Palët angazhohen:

1. të nxisin konsultimet e përbashkëta ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve;
2. të nxisin, ku është e nevojshme dhe e përshtatshme, mekanizmin për negociata vullnetare ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve, me synimin për rregullimin e termave dhe kushteve të punësimit me anë të marrëveshjeve kolektive;
3. të nxisin krijimin dhe përdorimin e mekanizmave të përshtatshëm për pajtim dhe arbitrazh vullnetar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës;
4. dhe njohin të drejtën e punëtorëve dhe të punëdhënësve për veprim kolektiv në rastet e konfliktit të interesave, duke përfshirë të drejtën për grevë, duke iu nënshtruar detyrimeve që mund të lindin nga marrëveshjet kolektive për të cilat është rënë dakord më parë.

Neni 7

E drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje, Palët angazhohen:

1. të marrin masa që mosha minimale për pranim në punësim të jetë 15 vjeç, duke iu nënshtruar përjashtimeve për fëmijët që punojnë në punë të lehtë të përcaktuar të padëmshme për shëndetin, moralin ose arsimimin e tyre;
2. të marrin masa që mosha minimale për pranim në punësim të jetë 18 vjeç përsa u përket punëve të përcaktuara që konsiderohen të rrezikshme ose të pashëndetëshme;
3. të marrin masa që personat të cilët u nënshtrohen akoma arsimit të detyrueshëm nuk do të punësohen në punë të tillë që do t'i pengonte ata nga përfitimi i plotë i arsimit të tyre;
4. të marrin masa që orët e punës për personat nën 18 vjeç të kufizohen në përputhje me nevojat e zhvillimit të tyre dhe veçanërisht të nevojës së tyre për trajnim profesional;
5. të njohin të drejtën e punëtorëve të rinj dhe punëtorëve nxënës për një rrogë të drejtë ose shpërblime të tjera të përshtatshme;
6. të marrin masa që koha e shpenzuar nga të rinjtë në trajnim profesional gjatë orëve normale të punës me miratimin e punëdhënësve të trajtohet sikur formon pjesë të ditës së punës;
7. të marrin masa që personat e punësuar nën 18 vjeç të kenë të drejtë për pushim vjetor të paguar për një minimum prej katër javësh;
8. të marrin masa që personat nën 18 vjeç të mos punësohen në punë nate, me përjashtim të disa punëve që parashikohen nga ligjet ose rregulloret kombëtare;

9. të marrin masa që personat nën 18 vjeç të punësuar në punë të përcaktuara nga ligjet ose rregulloret kombëtare t'u nënshtrohen kontrolleve periodike mjekësore;

10. të sigurojnë mbrojtje të veçantë kundër rreziqeve fizike dhe morale, ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht kundër atyre që rezultojnë direkt ose indirekt nga puna e tyre.

Neni 8

E drejta e grave të punësuar për mbrojtje të shtatzënisë

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës së grave të punësuar për mbrojtje të shtatzënisë, Palët angazhohen:

1. të marrin masa që, ose nëpërmjet lejes së paguar, ose përfitimeve të përshtatshme nga sigurimet shoqërore ose nëpërmjet përfitimit nga fonde publike, gratë e punësuar të marrin leje para dhe pas lindjes së fëmijës deri në një total prej të paktën katërmëdhjetë javësh;

2. të konsiderojnë që është e paligjshme për një punëdhënëse t'i japë një gruaje njoftim për pushim nga puna që nga momenti që ajo njofton punëdhënësin e saj se është shtatzënë deri në fund të lejes së saj të shtatzënisë, ose t'i japë asaj njoftimin e pushimit në kohë të atillë që afati i njoftimit të përfundojë brenda kësaj kohe;

3. të marrin masa që nënat që ushqejnë foshnjat e tyre me gji të kenë të drejtë për ndërprerje të mjaftueshme të punës për këtë qëllim;

4. të disiplinojnë me rregullore punësimin në punë nate të grave shtatzëna, grave që kanë lindur rishtazi dhe grave që ushqejnë foshnjat me gji;

5. të ndalojnë punësimin e grave shtatzënë, grave që kanë lindur rishtazi ose që ushqejnë foshnjat me gji në miniera nëntokë dhe në çdo punë tjetër që është e papërshtatshme për arsye të natyrës së saj të rrezikshme, të pashëndetëshme ose të rëndë dhe të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat e punësimit të këtyre grave.

Neni 9

E drejta për orientim profesional

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për orientim profesional, Palët angazhohen të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, një shërbim i cili do të ndihmojë të gjithë personat, përfshirë të gjymtuarit, për të zgjidhur problemet lidhur me zgjedhjen dhe përparimin profesional, duke patur parasysh siç duhet karakteristikat individuale dhe lidhjen e tyre me mundësinë e punësimit: kjo asistencë duhet të vihet në dispozicion falas si për të rinjtë, përfshirë fëmijët e shkollave, ashtu edhe për të rriturit.

Neni 10

E drejta për trajnim profesional

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për trajnim profesional, Palët angazhohen:

1. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, trajnimin teknik dhe profesional të të gjithë personave, përfshirë të gjymtuarit, në këshillim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënëseve dhe të japin lehtësitë që lejojnë për praninë në arsimin më të lartë teknik dhe universitar, të bazuar vetëm në aftësitë individuale;

2. të ofrojnë ose nxisin një sistem të punëtorëve nxënës dhe rregullime të tjera sistematike për trajnimin e djemve dhe vajzave të reja në punësimet e tyre të ndryshme;

3. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme:

a) lehtësi trainimi të përshtatshme dhe lehtësisht në dispozicion për punëtorët e rritur;

b) lehtësi të veçanta për ritrajnimin e punëtorëve të rritur, i nevojshëm si rezultat i zhvillimit teknologjik ose i tendencave të reja në punësim;

4. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, masa të veçanta për ritrajnimin dhe ri-integrimin e të papunëve afatgjatë;

5. të inkurajojnë përdorimin e plotë të lehtësive të ofruara nëpërmjet masave të përshtatshme të tilla si:

a) ulja ose heqja e ndonjë tarife ose pagese;

b) dhënia e asistencës financiare në rastet e përshtatshme;

c) përfshirja në orët normale të punës e kohës së shpenzuar nga punëtori për trajnim shtesë të kërkuar nga punëdhënësi, gjatë punësimit;

d) sigurimi, nëpërmjet mbikëqyrjes së përshtatshme, në këshillim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, i efektivitetit të mësimit të punëtorëve nxënës dhe i rregullimeve të tjera për trajnim për punëtorët e rinj dhe mbrojtje e përshtatshme për punëtorët e rinj e në përgjithësi.

Neni 11

E drejta për mbrojtjen e shëndetit

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për mbrojtjen e shëndetit, Palët angazhohen që, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike ose private, të marrin masa të përshtatshme që synojnë, ndër të tjera:

1. për të eliminuar sa më shumë të jetë e mundur shkaqet e shëndetit të keq;

2. për të ofruar lehtësi këshillimi dhe edukimi për nxitjen e shëndetit dhe inkurajimin e përgjegjësisë individuale për çështjet e shëndetit;

3. për të parandaluar sa më shumë të jetë e mundur epidemitë, sëmundjet epidemike e të tjera, si edhe aksidentet.

Neni 12

E drejta për sigurim shoqëror

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për sigurim shoqëror, Palët angazhohen:

1. të krijojnë ose mbajnë një sistem të sigurimit shoqëror;

2. të mbajnë sistemin e sigurimit shoqëror në një nivel të kënaqshëm, të paktën të barabartë me atë të nevojshëm për ratifikimin e Kodit Europian të Sigurimit Shoqëror;

3. të përqipen të ngrenë sistemin e sigurimit shoqëror në një nivel më të lartë;

4. të ndërmarrin hapa, me përfundimin e marrëveshjeve të përshtatshme dypalëshe dhe shumëpalëshe ose me mjete të tjera, dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në ato marrëveshje, për të siguruar:

a) trajtim të barabartë me atë të shtetasve të tyre, të shtetasve të Palëve të tjera lidhur me të drejtat e sigurimit shoqëror, përfshirë mbajtjen e përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni i sigurimit shoqëror, pavarësisht nga lëvizjet që personat e mbrojtur mund të bëjnë ndërmjet territoreve të Palëve;

b) dhënia, mbajtja dhe rifillimi i të drejtave të sigurimit shoqëror me mjete të tilla si akumulim i periudhave të sigurimit ose punësimit të plotësuar sipas legjislacionit të secilës nga Palët.

Neni 13

E drejta për asistencë mjekësore dhe sociale

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për asistencë mjekësore dhe sociale, Palët angazhohen:

1. të sigurojnë që çdo personi, i cili është pa burime të mjaftueshme dhe i cili nuk ka mundësi të sigurojë këto burime si nëpërmjet përpjekjeve të tij, ashtu edhe nga burime të tjera,

veçanërisht nga përfitimet prej një skeme të sigurimit shoqëror, t'i jepet asistencë e përshtatshme dhe, në rast sëmundjeje, kujdesi i nevojshëm për atë gjendje;

2. të sigurojnë që personat që marrin asistencë të tillë nuk do të vuajnë, për këtë arsye, nga zvogëlimi i të drejtave të tyre politike ose sociale;

3. të marrin masa që cilido të mund të marrë nga shërbimet e përshtatshme, publike ose private, këshilla dhe ndihmë personale, ashtu siç mund të kërkohet për të parandaluar, eliminuar ose lehtësuar gjendjen nevojtare personale ose të familjes;

4. të zbatojnë dispozitat e referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni në mënyrë të barabartë me shtetasit e tyre ndaj shtetasve të Palëve të tjera, që ndodhen ligjërisht brenda territorit të tyre, në përputhje me detyrimet e Konventës Europiane për Asistencën Mjekësore dhe Sociale, të nënshkruar në Paris më 11 dhjetor 1953.

Neni 14

E drejta për të përfituar nga shërbimet e mirëqenies sociale

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për shërbime të mirëqenies sociale, Palët angazhohen:

1. të nxisin ose të ofrojnë shërbime, të cilat, duke përdorur metoda të punës sociale, do të kontribuonin në mirëqenien dhe zhvillimin e individëve dhe grupeve në komunitet dhe përshtatjen e tyre në mjedisin social;

2. të inkurajojë pjesëmarrjen e individëve dhe organizatave vullnetare dhe të tjera në krijimin dhe mbajtjen e shërbimeve të tilla.

Neni 15

E drejta e personave me gjymtime për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit

Me synimin që t'u sigurohet personave me gjymtime, pavarësisht nga mosha dhe natyra e origjina e gjymtimeve të tyre, ushtrimi i të drejtës për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit, Palët angazhohen, në veçanti:

1. të marrin masa të nevojshme që t'u japin personave me gjymtime orientim, arsim dhe trajnim profesional në kuadrin e skemave të përgjithshme kudo që të jetë e mundur ose, ku kjo nuk është e mundur, nëpërmjet organeve të specializuara, publike ose private;

2. të nxisin aksesin e tyre në punësim, nëpërmjet të gjitha masave që tentojnë të inkurajojnë punëdhënësit, të marrin dhe mbajnë në punë persona me gjymtime në mjedisin e zakonshëm të punës dhe të përshtasin kushtet e punës për nevojat e të gjymtuarve ose, ku kjo nuk është e mundur për shkak të gjymtimit, duke rregulluar ose krijuar punësim të mbrojtur në përputhje me nivelin e gjymtimit. Në disa raste, këto masa mund të kërkojnë ndihmën e shërbimeve të specializuara për gjetjen e vendeve të punës dhe mbështetjes;

3. të nxisin integrimin e tyre të plotë social dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit në veçanti nëpërmjet masave, përfshirë ndihmesa teknike, që synojnë të tejkalojnë barrierat e komunikimit dhe lëvizshmërisë dhe duke lejuar aksesin në transport, strehim, veprimtari kulturore dhe të kohës së lirë.

Neni 16

E drejta e familjes për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale

Me synim që të sigurohen kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, që është një njësi themelore e shoqërisë, Palët angazhohen të nxisin mbrojtjen ekonomike, ligjore dhe sociale të jetës së familjes me mjete të tilla si përfitime familjare dhe sociale, rregullime fiskale, dhënia e shtëpive për familje, përfitime për të martuarit ristas dhe mjete të tjera të përshtatshme.

Neni 17

E drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve që të rriten në një mjedis i cili inkurajon zhvillimin e plotë të personalitetit të tyre dhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike, Palët angazhohen që, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike dhe private, të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme, që synojnë për:

1.a) të siguroar që fëmijët dhe të rinjtë, duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, të kenë kujdesin, asistencën, arsimimin dhe trajnimin për të cilin kanë nevojë, veçanërisht, duke marrë masa për krijimin ose mbajtjen e institucioneve dhe shërbimeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme për këtë qëllim;

b) të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë nga neglizhenca, dhuna dhe shfrytëzimi;

c) të ofruar mbrojtje dhe ndihmë të veçantë nga shteti për fëmijët dhe të rinjtë që janë të privuar përkohësisht ose përfundimisht nga mbështetja e familjes;

2. t'u ofruar fëmijëve dhe të rinjve një arsim fillestar dhe të mesëm falas, si dhe të inkurajojnë frekuentimin e rregullt të shkollave.

Neni 18

E drejta për t'u angazhuar në punë fitimprurese në territorin e Palëve të tjera

Me synimin për të siguroar ushtrimin efektiv të së drejtës për t'u angazhuar në punë fitimprurese në territorin e çdo Pale tjetër, Palët angazhohen:

1. të zbatojnë rregulloret aktuale me frymë liberale;

2. të thjeshtojnë formalitetet ekzistuese dhe të ulin ose të heqin tarifat konsullore dhe pagesa të tjera që paguhen nga punëtorët e huaj ose punëdhënësit e tyre;

3. të liberalizojnë, individualisht ose kolektivisht, rregullat që qeverisin punësimin e punëtorëve të huaj;

4. dhe njohin të drejtën e shtetasve të tyre të largohen nga vendi për t'u angazhuar në punë fitimprurëse në territoret e Palëve të tjera.

Neni 19

E drejta e punëtorëve migrues dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë

Me synimin për të siguroar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve migrues dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë në territorin e çdo Pale tjetër, Palët angazhohen:

1. të mbajnë ose të jenë kënaqura se mbahen shërbime të përshtatshme falas për të asistuar këta punëtorë, veçanërisht në marrjen e informacioneve të sakta dhe të marrin të gjitha hapat e përshtatshme, aq sa e lejojnë legjislacioni dhe rregulloret kombëtare, kundër propagandës çoroditëse lidhur me emigrimin dhe imigrimin;

2. të marrin masat e përshtatshme brenda juridiksionit të tyre të lehtësojnë nisjen, udhëtimin dhe pritjen e këtyre punëtorëve dhe familjeve të tyre dhe t'u ofrojnë atyre, brenda juridiksionit të tyre, shërbime të përshtatshme për shëndetin, vëmendje mjekësore dhe kushte të mira higjienike gjatë udhëtimit;

3. të nxisin bashkëpunimin, siç është e përshtatshme, ndërmjet shërbimeve sociale, publike dhe private, në vendet e emigrimit dhe imigrimit;

4. të sigurojnë për këta punëtorë, ligjërisht, brenda territorit të tyre, për sa këto çështje rregullohen me ligj ose rregullore ose u nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai i shtetasve të vet lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) pagën dhe kushte të tjera punësimi dhe pune;

b) anëtarësinë në sindikata dhe gëzimin e përfitimeve nga negociatat kolektive;

c) strehimin;

5. të sigurojnë për këta punëtorë ligjërisht brenda territorit të tyre, trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i shtetasve të vet lidhur me taksat, tarifat ose kontributet e punësimit lidhur me personat e punësuar;

6. të lehtësojnë sa të jetë e mundur ribashkimin e familjes së një punëtori të huaj, i cili është lejuar të vendoset në territor;

7. të sigurojnë për këta punëtorë ligjërisht brenda territorit të tyre trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i shtetasve të vet për procedura ligjore lidhur me çështje të referuara në këtë nen;

8. të sigurojë që këta punëtorë, të cilët banojnë ligjërisht brenda territoreve të tyre, të mos përzihen, përveç se kur rrezikojnë sigurimin kombëtar ose kryejnë shkelje kundër interesit dhe moralit publik;

9. të lejojnë, brenda kufijve ligjorë, transferimin e pjesëve të tilla të fitimeve dhe kursimeve të këtyre punëtorëve siç mund të dëshirojnë ata;

10. të zgjerojnë mbrojtjen dhe asistencën e parashikuar në këtë nen për migrantët e vetëpunësuar, për aq sa këto masa janë të zbatueshme;

11. të nxisin dhe lehtësojnë mësimin e gjuhës kombëtare të shtetit pritës ose, nëse ka disa, të njëjës nga ato gjuhë, punëtorëve migrantë dhe pjestarëve të familjeve të tyre;

12. të nxisin dhe lehtësojnë, sa të jetë praktike, mësimin e gjuhës amtare të punëtorëve migrantë për fëmijët e punëtorit migrant;

Neni 20

E drejta e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa diskriminim për shkak të seksit

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa diskriminim për shkak të seksit, Palët angazhohen të njohin atë të drejtë dhe të marrin masa të përshtatshme për të siguruar ose nxitur zbatimin e saj në fushat e mëposhtme:

- a) akses në punësim, mbrojtje kundër pushimit nga puna dhe riintegrimin në punë;
- b) orientim profesional, trajnim, ritrajnim dhe rihabilitim;
- c) kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, duke përfshirë pagën;
- d) zhvillimi i karrierës, duke përfshirë ngritjen në përgjegjësi.

Neni 21

E drejta për informim dhe këshillim

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të punëtorëve për t'u informuar dhe këshilluar brenda ndërmarrjes, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë masa që mundësojnë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare:

a) të informohen rregullisht ose në kohë të përshtatshme dhe në një mënyrë gjithëpërfshirëse rreth situatës ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes që i punëson, duke kuptuar që dhënia e disa informacioneve, të cilat mund të paragjykojnë ndërmarrjen, mund të refuzohet ose t'i nënshtrohet konfidencialitetit; dhe

b) të këshillohen në kohë për vendime të propozuara, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme interesat e punëtorëve, veçanërisht për ato vendime që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm për situatën e punësimit në ndërmarrje.

Neni 22

E drejta për të marrë pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisin e punës

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për të marrë pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisit të punës në ndërmarrje, Palët

angazhohen të marrin dhe inkurajojnë masa që mundësojnë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, të kontribuojnë:

- a) në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës, organizimin e punës dhe mjedisin e punës;
- b) në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimit brenda ndërmarrjes;
- c) në organizimin e shërbimeve sociale dhe social-kulturore dhe lehtësive brenda ndërmarrjes;
- d) mbikëqyrjen e respektimit të rregulloreve mbi këto çështje.

Neni 23

E drejta e personave të moshuar për mbrojtje sociale

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtave të personave të moshuar për mbrojtje sociale, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike ose private, masa të përshtatshme, që synojnë veçanërisht:

- të mundësojnë personat e moshuar që të mbeten anëtarë të plotë të shoqërisë për sa më gjatë të jetë e mundur, nëpërmjet:

a) burimeve të përshtatshme që mundësojnë ata të bëjnë një jetë të përshtatshme dhe të luajnë një rol aktiv në jetën publike, sociale dhe kulturore;

b) ofrimit të informacionit për shërbimet dhe lehtësitë në dispozicion për personat e moshuar dhe mundësitë e tyre për t'i përdorur ato;

- të mundësojnë personat e moshuar të zgjedhin lirisht mënyrën e tyre të jetesës dhe të bëjnë një jetë të pavarur në mjedisin e tyre familjar për sa kohë që ata e dëshirojnë dhe kanë mundësi ta bëjnë, nëpërmjet:

a) ofrimit të strehimit të përshtatshëm për nevojat e tyre dhe gjendjen e tyre të shëndetit ose mbështetjes së përshtatshme për përshtatjen e vendbanimit të tyre;

b) kujdesit shëndetësor dhe shërbimet e nevojshme për gjendjen e tyre;

- garantimit të personave të moshuar që jetojnë në institucione mbështetje, të përshtatshme, duke respektuar privatësinë e tyre dhe pjesëmarrjen në vendime lidhur me kushtet e jetesës në institucion.

Neni 24

E drejta për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimit

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për mbrojtje në rastin e përfundimit të punësimit, Palët angazhohen të njohin:

a) të drejtën e të gjithë punëtorëve që të mos u përfundohet punësimi pa arsye të vlefshme për atë përfundim të lidhura me aftësinë ose sjelljen e tyre ose bazuar në kërkesat operacionale të ndërmarrjes, organizmit ose shërbimit;

b) të drejtën e punëtorëve, punësimi i të cilëve përfundohet pa arsye të vlefshme për kompensim të përshtatshëm ose lehtësim tjetër të përshtatshëm.

Për këtë qëllim, Palët angazhohen të sigurojnë që një punëtor, i cili konsideron që punësimi i tij është përfunduar pa një arsye të vlefshme, do të ketë të drejtën të apelojë në një organ të pavarur.

Neni 25

E drejta e punëtorëve për mbrojtjen e pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të pronarit të tyre

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të punëtorëve për mbrojtjen e pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të punëdhënësit të tyre, Palët angazhohen të ofrojnë që pretendimet e punëtorëve që lindin nga kontrata punësimi ose marrëdhënie punësimi të garantohen nga një institucion garantimi ose nga ndonjë formë tjetër efektive mbrojtjeje.

Neni 26

E drejta e dinjitetit në punë

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për mbrojtjen e dinjitetit të tyre në punë, Palët angazhohen, në konsultim me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve:

1. të nxisin sensibilizimin ndaj, informimin për, dhe parandalimin e ngacmimit seksual në vendin e punës ose në lidhje me punën dhe të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur punëtorët nga një sjellje e tillë;

2. të nxisin sensibilizimin ndaj, informimin për, dhe parandalimin e veprimeve të dënueshme ose dukshëm negative e ofensive të drejtuara në mënyrë të përsëritur kundër punëtorëve individuale në vendin e punës ose në lidhje me punën dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur punëtorët nga një sjellje e tillë.

Neni 27

E drejta e punëtorëve me përgjegjësi familjare për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për barazi të mundësive dhe trajtimit të punëtorëve burra dhe gra me përgjegjësi familjare dhe ndërmjet këtyre punëtorëve dhe punëtorëve të tjerë, Palët angazhohen:

1. të marrin masa të përshtatshme:

a) të mundësojnë punëtorët me përgjegjësi familjare të hyjnë dhe të mbeten në punësim, si edhe të rihyjnë në punësim pas një mungese për shkak të atyre përgjegjësive, duke përfshirë masat në fushën e orientimit dhe trajnimit profesional;

b) të marrin parasysh nevojat e tyre lidhur me kushtet e punësimit dhe sigurimit shoqëror;

c) të zhvillojnë dhe nxisin shërbime, publike ose private, në veçanti shërbime për kujdesjen e fëmijëve gjatë ditës dhe rregullime të tjera për kujdesjen e fëmijëve;

2 të ofrojnë një mundësi për njërin nga prindit të marrë, gjatë një periudhe pas lejes së shtatzënisë, leje prindërore për t'u kujdesur për fëmijën, kohëzgjatja dhe kushtet e së cilës duhet të përcaktohen nga legjislacioni kombëtar, rregullimet kolektive ose praktika;

3. të sigurojnë që përgjegjësitë familjare nuk do të përbëjnë, si të tilla, një arsye të vlefshme për përfundim të punësimit.

Neni 28

E drejta e përfaqësuesve të punëtorëve për mbrojtje në ndërmarrje dhe lehtësitë që do t'u akordohen atyre

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së përfaqësuesve të punëtorëve që të kryejnë funksionet e tyre, Palët angazhohen të sigurojnë që në ndërmarrje:

a) ata gëzojnë mbrojtje efektive ndaj veprimeve paragjyquese ndaj tyre, duke përfshirë pushimin nga puna, të bazuar mbi statusin e tyre ose veprimtaritë si përfaqësues të punëtorëve brenda ndërmarrjes;

b) atyre t'u vihen në dispozicion lehtësi, siç mund të jenë të përshtatshme, në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të shpejtë dhe efektive, duke marrë në konsideratë sistemin e marrëdhënieve industriale të vendit dhe nevojat, përmasat dhe mundësitë e ndërmarrjes në fjalë.

Neni 29

E drejta për informacion dhe këshillim në procedurat e shkurtimeve kolektive

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës së punëtorëve që të informohen dhe këshillohen në situata të shkurtimeve kolektive, Palët angazhohen të sigurojnë që punëdhënësit do të informojnë dhe këshillohen me përfaqësuesit e punëtorëve, në afat kohe të dobishëm para

këtyre shkurtimeve kolektive, për mënyrat dhe mjetet për të evituar shkurtime kolektive ose kufizimin e ndodhjes së tyre dhe zbutjes së pasojave të tyre, për shembull duke iu drejtuar masave sociale shoqërore, që synojnë veçanërisht të ndihmojnë për rivendosjen ose ritrajnimin e punëtorëve në fjalë.

Neni 30

E drejta e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, Palët angazhohen:

a) të marrin masa brenda kuadrit të një përqaasjeje të përgjithshme dhe të koordinuar për të nxitur aksesin efektiv të personave që jetojnë ose rrezikojnë të jetojnë në një situatë të përjashtimit shoqëror ose varfëri, si edhe të familjeve të tyre, veçanërisht në punësim, strehim, trajnim, arsimim, kulturë dhe asistencë sociale dhe mjekësore;

b) të rishikojnë këto masa, me synim që t'i përshtasin ato, nëse është e nevojshme.

Neni 31

E drejta për strehim

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për strehim, Palët angazhohen të marrin masa që synojnë:

1. të nxisin aksesin në strehim të një standardi të mjaftueshëm;
2. të parandalojnë dhe ulin numrin e të pastrehëve me synim të eliminimit të tij gradual;
3. të bëjnë çmimin e strehimit të arritshëm nga ata pa burime të mjaftueshme.

PJESA III

Neni A

Angazhime

1. Duke iu nënshtuar dispozitave të nenit B më poshtë, secila nga Palët angazhohet:

a) ta konsiderojë pjesën I të kësaj Karte si një deklaratë të qëllimeve, të cilat ajo do të ndjekë me të gjitha mjetet e përshtatshme, siç është deklaruar në paragrafin hyrës të saj;

b) ta konsiderojë veten të detyruar nga të paktën gjashtë prej neneve të mëposhtme të pjesës II të kësaj Karte: nenet 1, 5, 6, 7, 12, 13, 16, 19 dhe 20;

c) ta konsiderojë veten të detyruar nga një numër shtesë nenesesh ose paragrafesh me numër të pjesës II të Kartës që mund t'i zgjedhë, me kusht që numri i përgjithshëm i neneve ose paragrafëve me numër nga të cilat do të detyrohet të mos jetë më i vogël se gjashtëmbëdhjetë nene ose gjashtëdhjetë e tre paragrafë me numër.

2. Nenet ose paragrafët e zgjedhura në përputhje me nënparagrafët b dhe c të paragrafit 1 të këtij neni i njoftohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në kohën kur depozitohet instrumenti i ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Çdo Palë mundet, në një datë të mëvonshme, të deklarojë, me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm, që ajo konsideron veten të detyruar nga cilatdo nene ose paragrafe të numëruara të pjesës II të Kartës, të cilat ajo nuk i kishte pranuar tashmë sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni. Këto angazhime do të konsiderohen më tej të jenë pjesë përbërëse e ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe do të kenë të njëjtin efekt që nga dita e parë e muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës së njoftimit.

4. Çdo Palë do të mbajë një sistem të inspektimit të punës të përshtatshëm me kushtet kombëtare.

Neni B
Lidhjet me Kartën Sociale Europiane dhe Protokollin Shtesë të 1998-ës

1. Asnjë Palë e Kartës Sociale Europiane ose Palë në Protokollin Shtesë të 5 Majit 1988 nuk mund të ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Kartë pa e konsideruar veten të detyruar nga të paktën dispozitat që i korrespondojnë dispozitave të Kartës Sociale Europiane dhe, ku është e përshtatshme, të protokollit shtesë, nga të cilat ka qenë e detyruar.

2. Pranimi i detyrimeve të çdo dispozite të kësaj Karte do të rezultojë, nga data e hyrjes në fuqi e atyre detyrimeve për Palën në fjalë, në pushimin e qenies në fuqi për Palën në fjalë të dispozitave korresponduese të Kartës Sociale Europiane dhe, ku të jetë e përshtatshme, të protokollit të saj shtesë të 1998-ës, në rastin kur ajo Palë ka qenë e detyruar nga i pari ose të dy këto instrumente.

PJESA IV

Neni C
Mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që përmbahen në këtë Kartë

Zbatimi i detyrimeve ligjore që përmbahen në këtë Kartë do t'i nënshtrohet të njëjtës mbikëqyrje si Karta Sociale Europiane.

Sistemi i mbikëqyrjes është paraqitur në pjesën IV të Kartës, e cila është përfshirë më poshtë; amendamentet e vendosura nga Protokollin i Torinos paraqiten me gërma të zeza në të djathtë.

“PJESA IV

Neni 21
Raport për dispozitat që janë pranuar

Palët Kontraktuese do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në formën që do të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave, raporte dyvjeçare mbi zbatimin e dispozitave të kreut II të Kartës që ata kanë pranuar.

Neni 22
Raport për dispozitat që nuk janë pranuar

Palët Kontraktuese do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm, në intervale të përshtatshme kohe dhe me kërkesën e Komitetit të Ministrave, raporte për dispozitat e kreut II të Kartës, të cilat nuk janë pranuar prej tyre as në kohën e ratifikimit ose të miratimit, as edhe pas një njoftimi të mëvonshëm. Komiteti i Ministrave do të përcaktojë, në intervale të rregullta, se për cilat dispozita do të kërkohen raporte dhe cilat do të jenë kërkesat për to.

Neni 23
Përcjellja e kopjeve

1. Çdo Palë Kontraktuese do t'i përcjellë kopje të raporteve që parashikojnë nenet 21 dhe 22 organizatave kombëtare të saj, të cilat kanë aderuar në organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve e të punonjësve dhe që, në përputhje me nenin 27 paragrafi 2, do të ftohen të përfaqësohen në takimet e Nënkomitetit të Komitetit Social Qeveritar.

2. Palët Kontraktuese do t'i transmetojnë Sekretarit të Përgjithshëm të gjitha vërejtjet e bëra nga ana e këtyre organizatave kombëtare rreth raporteve në fjalë, në qoftë se kërkohet një gjë e tillë prej tyre.

“Neni 23

Komunikimi i kopjeve të raporteve dhe komenteve

1. Çdo Palë Kontraktuese, kur i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm një raport sipas neneve 21 dhe 22, do t'i dërgojë një kopje të atij raporti organizatave të saj kombëtare, të tilla që janë anëtarë të organizatave ndërkombëtare të punëdhënësve dhe sindikatave të ftuara, sipas nenit 27 paragrafit 2, që të përfaqësohen në takime të Komitetit Qeveritar. Ato organizata do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm çfarëdo komentesh mbi raportet e Palëve Kontraktuese. Sekretari i Përgjithshëm do t'i dërgojë një kopje të atyre komenteve Palëve Kontraktuese në fjalë, të cilat mund të dëshirojnë të përgjigjen.

2. Sekretari i Përgjithshëm do t'i dërgojë një kopje të raporteve të Palëve Kontraktuese organizatave joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë status konsultativ me Këshillin e Europës dhe kanë kompetencë të veçantë në çështjet e qeverisura nga kjo Kartë.

3. Raportet dhe komentet e referuara në nenet 21 dhe 22 dhe në këtë nen do t'i vihen në dispozicion publikun kundrejt kërkesës.

Neni 24

Shqyrtimi i raporteve

Raportet që i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenet 21 dhe 22 do të shqyrtohen nga një komitet ekspertësh, i cili do të disponojë gjithashtu të gjitha vërejtjet që i janë transmetuar Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 2 të nenit 23.

Neni 24

Shqyrtimi i raporteve

1. Raportet e dërguara Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me nenet 21 dhe 22 do të shqyrtohen nga një Komitet Ekspertësh të Pavarur të krijuar në bazë të nenit 25. Komiteti do të jetë përpara gjithashtu çfarëdo komentesh të paraqitura Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 1 të nenit 23. Në përfundim të shqyrtimit të tij, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të hartojë një raport që përmban konkluzionet e tij.

2. Lidhur me raportet e referuara në nenin 21, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të vlerësojë nga një pikëpamje juridike përputhshmërinë e legjislacionit dhe praktikës kombëtare me detyrimet që rrjedhin nga Karta për Palët Kontraktuese në fjalë.

3. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund t'i bëjë kërkesa për informacion shtesë dhe sqarim drejtpërdrejt Palëve Kontraktuese. Lidhur me këtë, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund, gjithashtu, në se është e nevojshme, të bëjë mbledhje me përfaqësuesit e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e tij ose me kërkesën e Palës Kontraktuese në fjalë. Organizatat e referuara në paragrafin 1 të nenit 23 do të mbahen të informuara.

4. Konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur do të bëhen publike dhe do t'i komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm Komitetit Qeveritar, Asamblesë Parlamentare dhe organizatave që janë përmendur në paragrafin 1 të nenit 23 dhe paragrafin 2 të nenit 27.

Neni 25

Komiteti i Ekspertëve

1. Komiteti i Ekspertëve do të ketë në përbërjen e tij jo më shumë se shtatë anëtarë, që do të caktohen nga Komiteti i Ministrave nga një listë ekspertësh të pavarur të integritetit më të lartë dhe me kompetenca të njohura në çështje sociale ndërkombëtare, të cilët do të propozohen nga Palët Kontraktuese.

2. Anëtarët e Komitetit do të jenë të emëruar për 6 vjet; mandati i tyre mund të ripërtërihet. Megjithatë, mandati i dy prej anëtarëve të emëruar për herë të parë do të mbarojë në fund të një periudhe prej katër vjetësh.

3. Anëtarët, mandati i të cilëve mbaron në fund të periudhës fillestare prej katër vjetësh, do të zgjidhen me short nga Komiteti i Ministrave menjëherë pas emërimit të parë.

4. Një anëtar i Komitetit të Ekspertëve, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar të cilit nuk i ka mbaruar mandati, do të përmbushë periudhën që ka mbetur nga mandati i paraardhësit të tij.

Neni 25

Komiteti i Ekspertëve të Pavarur

1. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të përbëhet nga të paktën nëntë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Parlamentare me një shumicë votash të dhëna për një listë ekspertësh me standardin më të lartë të ndershmërisë dhe me kompetenca të mirënjohura në çështjet sociale kombëtare e ndërkombëtare, të emëruar nga Palët Kontraktuese. Nunri i saktë i anëtarëve do të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave.

2. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen për një periudhë prej gjashtë vjetësh. Ata mund të rizgjidhen një herë.

3. Një anëtar i Komitetit të Ekspertëve të Pavarur, i zgjedhur për të zëvendësuar një anëtar, afati i të cilit nuk ka mbaruar, do të qëndrojë në post për pjesën që mbetet nga afati i paraardhësit të tij.

4. Anëtarët e Komitetit do të kryejnë funksionin me titull individual. Gjatë gjithë kohës së afatit të tyre, ata nuk mund të kryejnë asnjë funksion në mospërputhjen me kërkesat për pavarësi, paanësi dhe të qenit në dispozicion që kërkohen nga funksioni i tyre.

Neni 26

Pjesëmarrja në Organizatën Ndërkombëtare të Punës

Organizata Ndërkombëtare e Punës do të ftohet të emërojë një përfaqësues për të marrë pjesë me status konsultativ në diskutimet e Komitetit të Ekspertëve.

Neni 27

Nënkomiteti i Komitetit Social Qeveritar

1. Raportet e Palëve Kontraktuese dhe konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve do t'i paraqiten për shqyrtim një nënkomiteti të Komitetit Social Qeveritar të Këshillit të Evropës.

2. Nënkomiteti do të ketë në përbërjen e tij një përfaqësues nga çdo Palë Kontraktuese. Ai do të ftojë jo më shumë se dy organizata ndërkombëtare të punonjësve për të marrë pjesë si vëzhgues me status konsultativ në mbledhjet e tij. Përveç të tjerash, ai mund të thërrasë në konsultim pranë Këshillit të Evropës jo më shumë se dy përfaqësues të organizatave ndërkombëtare joqeveritare, që kanë status konsultativ, për çështje të tilla si përkrahja sociale dhe mbrojtja ekonomike dhe shoqërore e familjes, për trajtimin e të cilave këto organizata janë veçanërisht të kualifikuara.

3. Nënkomiteti do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave një raport me konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve. Asambleja Konsultative do t'i transmetojë mendimin e saj për këto konkluzione Komitetit të Ministrave.

Neni 27

Komiteti Qeveritar

1. Raportet e Palëve Kontraktuese, komentet dhe informacionet e komunikuar në përputhje me paragrafët 1 të nenit 23 dhe 3 të nenit 24 dhe raportet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur do t'i paraqiten një Komiteti Qeveritar.

2. Komiteti do të përbëhet nga një përfaqësues prej secilës Palë Kontraktuese. Ai do të ftojë jo më shumë se dy organizata ndërkombëtare të punëdhënësve dhe jo më shumë se dy organizata sindikale ndërkombëtare që të dërgojnë vëzhgues me aftësi konsultative në mbledhjet e tij. Për më tepër, ai mund të konsultohet me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë një status konsultativ në Këshillin e Europës dhe kanë kompetenca të veçanta në çështjet që qeverisen nga kjo Kartë.

3. Komiteti Qeveritar do të përgatisë vendimet e Komitetit të Ministrave. Në veçanti, në dritën e raporteve të Komitetit të Ekspertëve të Pavarur dhe të Palëve Kontraktuese, ai do të zgjedhë, duke dhënë arsye për zgjedhjen e tij, në bazë të konsideratave të politikave sociale, ekonomike dhe të tjera për situatat të cilat, sipas opinionit të tij, do të jenë tema e rekomandimeve për secilën Palë Kontraktuese në fjalë, në përputhje me nenin 28 të Kartës. Ai do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave një raport i cili do të bëhet publik.

4. Në bazë të gjetjeve të tij për zbatimin në përgjithësi të Kartës Sociale në përgjithësi, Komiteti Qeveritar mund t'i paraqesë propozime Komitetit të Ministrave, që synojnë në kryerjen e studimeve për çështje sociale dhe për nenet e Kartës të cilat mundet të aktualizohen.

Neni 28

Asambleja Konsultative

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i përcjellë Asamblesë Konsultative konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve. Asambleja Konsultative do t'i transmetojë mendimin e saj për këto konkluzione Komitetit të Ministrave.

Neni 28

Komiteti i Ministrave

1. Komiteti i Ministrave do të miratojë, me një shumicë prej dy të tretash të votuesve, me të drejtën e votimit të kufizuar në Palët Kontraktuese, në bazë të raportit të Komitetit Qeveritar, një rezolutë që mbulon gjithë ciklin e mbikëqyrjes dhe që të përmbajë rekomandime individuale për Palët Kontraktuese në fjalë.

2. Duke mbajtur parasysh propozimet e bëra nga Komiteti Qeveritar sipas paragrafit 4 të nenit 27, Komiteti i Ministrave do të marrë vendime, siç e sheh të arsyeshme.

Neni 29

Komiteti i Ministrave

Komiteti i Ministrave, në bazë të raportit të nënkomitetit dhe pas konsultimit me Asamblesë Konsultative, mund t'i bëjë çdo Palë Kontraktuese rekomandimet e nevojshme, me një shumicë të përbërë nga dy të tretat e anëtarëve që kanë të drejtë të jenë anëtarë të Komitetit."

Neni 29

Asambleja Parlamentare

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë Asamblesë Parlamentare, me synimin e mbajtjes së debateve plenare periodike, raportet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur dhe të Komitetit Qeveritar, si edhe rezolutat e Komitetit të Ministrave."

Neni D

Ankesat kolektive

1. Dispozitat e Protokollit Shtesë të Kartës Sociale Europiane, që parashikojnë një sistem ankesash kolektive, do të zbatohen për angazhimet e marra në këtë Kartë për shtetet të cilat kanë ratifikuar Protokollin e përmendur.

2. Çdo Shtet i cili nuk është i detyruar nga Protokollin Shtesë i Kartës Sociale Europiane që parashikon një sistem të ankesave kolektive mundet, që kur të depozitohet instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Karte ose në një kohë të mëvonshme, të deklarojë me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që ai pranon mbikëqyrjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Karte duke ndjekur procedurën e parashikuar në Protokollin në fjalë.

Procedura e ankesave kolektive është paraqitur në Protokollin Shtesë të Kartës të vitit 1995, teksti i të cilit është përfshirë më poshtë:

"Neni 1

Palët Kontraktuese të këtij Protokollin njohin të drejtën e organizatave të mëposhtme për të paraqitur ankesa që pretendojnë zbatimin e pakënaqshëm të Kartës:

a) organizata ndërkombëtare të punëdhënësve dhe sindikata të referuara në paragrafin 2 të Nenit 27 të Kartës;

b) organizata të tjera joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë një status konsultativ me Këshillin e Europës dhe janë vendosur në një listë të krijuar për këtë qëllim nga Komiteti Qeveritar;

c) organizata kombëtare përfaqësuese të punëdhënësve dhe sindikata brenda juridiksionit të Palës Kontraktuese, kundër së cilës ata kanë bërë një ankesë.

Neni 2

1. Çdo Shtet Kontraktues mundet, gjithashtu, kur ai shpreh miratimin e tij të detyrohet nga ky Protokoll, në përputhje me dispozitat e nenit 13, ose në çdo moment më pas, të deklarojë që ai njih të drejtën e çdo organizate tjetër joqeveritare kombëtare përfaqësuese brenda juridiksionit të tij që ka kompetenca të veçanta në çështjet e qeverisura nga Karta, që të bëjë ankesë kundër tij.

2. Këto deklarata mund të bëhen për një periudhë specifike.

3. Deklaratat do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, i cili do t'i transmetojë kopje të tyre Palëve Kontraktuese dhe do t'i botojë ato.

Neni 3

Organizatave joqeveritare ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare kombëtare, të referuara respektivisht në nenin 1.b dhe nenin 2, mund të paraqesin ankesa në përputhje me procedurën e përshkruar nga dispozitat e lartpërmendura vetëm në lidhje me ato çështje për të cilat ato janë njohur të kenë kompetencë të veçantë.

Neni 4

Ankesa do të depozitohet me shkrim, do të lidhet me një dispozitë të Kartës të pranuar nga Pala Kontraktuese në fjalë dhe do të tregojë se në çfarë drejtimi kjo e fundit nuk ka siguruar zbatimin e kënaqshëm të kësaj dispozite.

Neni 5

Çdo ankesë do t'i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do të konfirmojë marrjen e saj, do t'ia njoftojë atë Palës Kontraktuese në fjalë dhe do t'ia transmetojë atë menjëherë Komitetit të Pavarur të Ekspertëve.

Neni 6

Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund t'i kërkojë Palës Kontraktuese në fjalë dhe organizatës që depozitoi ankesën që të paraqesin informacion dhe vërejtje me shkrim për pranueshmerinë e ankesës brenda afatit që ai do të rekomandojë.

Neni 7

1. Nëse vendos që ankesa është pranueshme, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të njoftojë Palët Kontraktuese të Kartës nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Ai do t'i kërkojë Palës Kontraktuese në fjalë dhe organizatës që depozitoi ankesën që të paraqesë, brenda afatit që ai do të rekomandojë, të gjitha shpjegimet ose informacionet me shkrim, dhe Palët Kontraktuese të tjera në këtë Protokoll, komentet që ato dëshirojnë të paraqesin, brenda të njëjtit afat kohor.

2. Nëse ankesa është depozituar nga një organizatë kombëtare e punëdhënësve ose sindikatë kombëtare ose nga ndonjë organizatë tjetër kombëtare ose ndërkombëtare joqeveritare, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të njoftojë organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve ose të sindikatave, të referuara në paragrafin 2 të nenit 27 të Kartës, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, dhe do t'i ftojë ata të paraqesin vërejtje brenda afatit që ai do të rekomandojë.

3. Në bazë të shpjegimeve, informacionit ose vërejtjeve të paraqitura nën paragrafët 1 dhe 2 më lart, Pala Kontraktuese në fjalë dhe organizata që depozitoi ankesën mund të paraqesin çfarëdo informacioni ose vërejtjeje shtesë me shkrim brenda afatit që do të rekomandojë Komiteti i Ekspertëve të Pavarur.

4. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund të organizojë një dëgjim me përfaqësues të palëve.

Neni 8

1. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të hartojë një raport në të cilin ai do të përshkruajë hapat e ndërmarra prej tij për shqyrtimin e ankesës dhe të paraqesë konkluzionet në se Pala Kontraktuese në fjalë ka siguruar zbatimin e kënaqshëm të dispozitës së Kartës, që referohet në ankesë.

2. Raporti do t'i transmetohet Komitetit të Ministrave. Ai do t'i transmetohet gjithashtu organizatës që depozitoi ankesën dhe Palës Kontraktuese të Kartës, e cila nuk do të ketë lirinë ta botojë atë.

Ai do t'i transmetohet Asamblesë Parlamentare dhe do të bëhet publik në të njëjtën kohë me rezolutën e referuar në nenin 9 ose jo më vonë se katër muaj pasi ai i është transmetuar Komitetit të Ministrave.

Neni 9

1. Në bazë të raportit të Komitetit të Ekspertëve të Pavarur, Komiteti i Ministrave do të miratojë një rezolutë me shumicën e votuesve. Nëse Komiteti i Ekspertëve të Pavarur konstaton që Karta nuk është zbatuar në mënyrë të kënaqshme, Komiteti i Ministrave do të miratojë, me shumicë dy të tretash të votuesve, një rekomandim që i adresohet Palës Kontraktuese në fjalë. Në të dy rastet, e drejta për të votuar do të kufizohet në Palët Kontraktuese të Kartës.

2. Me kërkesën e Palës Kontraktuese në fjalë, Komiteti i Ministrave mund të vendosë, me shumicë dy të tretash të Palëve Kontraktuese të Kartës, të këshillohet me Komitetin Qeveritar, aty ku raporti i Komitetit të Ekspertëve të Pavarur ngre çështje të reja.

Neni 10

Pala Kontraktuese në fjalë do të japë informacion mbi masat që ka marrë për të vënë në fuqi rekomandimin e Komitetit të Ministrave, në raportin e ardhshëm që ajo i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 21 të Kartës.

Neni 11

Nenet 1 deri 10 të këtij Protokollit do të zbatohen edhe për nenet e pjesës II të Protokollit të parë Shtesë të Kartës në lidhje me Shtetet Palë në atë Protokoll, në masën që këto nene janë pranuar.

Neni 12

Shtetet Palë në këtë Protokoll konsiderojnë që paragrafi i parë i shtojcës së Kartës, lidhur me pjesën III, lexohet si vijon:

“Kuptohet që Karta përmban detyrime juridike të karakterit ndërkombëtar, zbatimi i të cilave i nënshtrohet vetëm mbikëqyrjes së parashikuar në pjesën IV të saj dhe në dispozitat e këtij Protokollit.”

PJESA V

Neni E

Mosdiskriminimi

Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.

Neni F

Derogimi në kohë lufte ose emergjence publike

1. Në kohë lufte ose emergjence tjetër publike që kërcënon jetën e kombit, çdo Palë mund të marrë masa derogimi nga detyrimet sipas kësaj Karte në masën që kërkohet rigorozisht nga nevojat e situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në mospërputhje me detyrimet e tjera të saj sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Çdo Palë që ka shfrytëzuar këtë të drejtë derogimi do të informojë plotësisht Sekretarin e Përgjithshëm, brenda një afati kohe të arsyeshëm, për masat e marra dhe për arsyet e tyre. Ajo, gjithashtu do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm kur këto masa kanë pushuar së funksionuari dhe kur dispozitat e Kartës, të cilat ajo ka pranuar, janë duke u zbatuar përsëri plotësisht.

Neni G

Kufizime

1. Të drejtat dhe parimet e parashikuara në pjesën I, kur realizohen në mënyrë efektive, dhe ushtrimi i tyre efektiv siç parashikohet në pjesën II, nuk do t'u nënshtrohen asnjë kufizimi që nuk specifikohet në ato pjesë, përveçse atyre të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve ose për mbrojtjen e interesave publike, të sigurimit kombëtar, shëndetit ose moralit publik.

2. Kufizimet e lejuara sipas kësaj Karte për të drejtat dhe detyrimet e parashikuara këtu nuk do të zbatohen për asnjë qëllim tjetër përveçse për atë për të cilin janë parashikuar.

Neni H

Marrëdhëniet ndërmjet Kartës dhe të drejtës kombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Karte nuk do të paragjykojnë dispozitat e së drejtës kombëtare ose të çfarëdo traktati dypalësh ose shumëpalësh, konvente ose marrëveshjeje që është tashmë në fuqi, ose mund të hyjë në fuqi, nën të cilën personave të mbrojtur do t'u jepej trajtim më i favorshëm.

Neni I

Zbatimi i angazhimeve të marra

1. Pa paragjykim për metodat e zbatimit të parashikuara në këto nene, dispozitat përkatëse të neneve 1 deri 31 të pjesës II të kësaj Kartë do të zbatohen nëpërmjet:

- a) ligjeve dhe rregullave;
 - b) marrëveshjeve ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të punëtorëve;
 - c) një kombinimi të atyre dy metodave;
 - d) mjeteve të tjera të përshtatshme.
2. Respektimi i angazhimeve që rrjedhin nga dispozitat e paragrafëve 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 të nenit 2, paragrafëve 4, 6 dhe 7 të nenit 7, paragrafëve 1, 2, 3 dhe 5 të nenit 10 dhe neneve 21 dhe 22 të pjesës II të kësaj Karte do të konsiderohet si efektiv, nëse dispozitat zbatohen, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, për shumicën dërrmuese të punëtorëve në fjalë.

Neni J **Ndryshime**

1. Çdo ndryshim i pjesëve I dhe II të kësaj Karte me qëllim që të zgjerohen të drejtat dhe garancitë e garantuara nga kjo Kartë, si edhe çdo ndryshim i pjesëve III dhe IV, propozuar nga një Palë ose nga Komiteti Qeveritar, do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe do t'i dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm Palëve të kësaj Karte.
2. Çdo ndryshim i propozuar në përputhje me dispozitat e paragrafit paraardhës do të shqyrtohet nga Komiteti Qeveritar, i cili do t'i paraqesë tekstin e miratuar prej tij Komitetit të Ministrave për miratim pas këshillimeve me Asamblenë Parlamentare. Pas miratimit të tij nga Komiteti i Ministrave, ky tekst do t'u dërgohet Palëve për pranim.
3. Çdo ndryshim i pjesëve I dhe II të kësaj Karte do të hyjë në fuqi për ato Palë që e kanë pranuar atë, në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën tre Palë kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.
- Për çdo Palë që e pranon atë më pas, ndryshimi do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën ajo Palë ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e saj.
4. Çdo ndryshim në pjesët III dhe IV të kësaj Karte do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

PJESA VI

Neni K **Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Kartë do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit dhe miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
2. Kjo Kartë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën tre Shtete Anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur konfirmimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Kartë në përputhje me paragrafin paraardhës.
3. Lidhur me çdo Shtet Anëtar që shpreh më vonë miratimin e tij për t'u detyruar nga kjo Kartë, ajo do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të periudhës prej një muaji pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni L **Zbatimi territorial**

1. Kjo Kartë do të zbatohet në territorin metropolitan të çdo Pale. Çdo nënshkrues mundet që, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të specifikojë, me deklaratë adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, territorin që do të konsiderohet të jetë territori i tij metropolitan për këtë qëllim.

2. Çdo nënshkrues mundet të deklarojë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose në një kohë më pas, me anë të një njoftimi adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që Karta do të shtrihet në të gjithë ose një pjesë të territorit ose territoreve të tij jometropolitanë, të specifikuara në deklaratën në fjalë, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës ose për të cilat ai merr përgjegjësi ndërkombëtare. Ai do të specifikojë në deklaratë nenet ose paragrafët e pjesës II të Kartës të cilat ai pranon si detyruese lidhur me territoret e përmendura në deklaratë.

3. Karta do të shtrijë zbatimin e saj në territorin ose territoret e përmendura në deklaratën në fjalë nga dita e parë e muajit pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës së marrjes së njoftimit të kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Çdo Palë mund të deklarojë në një datë të mëvonëshme me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që, lidhur me një ose më shumë nga territoret e të cilëve Karta është zbatuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, ajo pranon si detyruese çfarëdo nenes ose paragrafësh me numër, të cilat ajo nuk i ka pranuar tashmë lidhur me atë territor ose territore. Këto angazhime të mëvonëshme do të konsiderohen të jenë pjesë tërësore e deklaratës fillestare lidhur me territorin në fjalë dhe do të ketë të njëjtin efekt që nga dita e parë e muajit që vijon kalimin e një periudhe prej një muaji pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni M **Denoncimi**

1. Çdo Palë mund të denoncojë këtë Kartë vetëm në fund të një periudhe prej pesë vjetësh nga data në të cilën Karta ka hyrë në fuqi për të ose në fund të çfarëdo periudhe vijuese prej dy vjetësh dhe, në secilin rast, pasi të ketë njoftuar gjashtë muaj më parë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do të njoftojë për këtë Palët e tjera.

2. Çdo Palë mundet të denoncojë, në përputhje me dispozitat e parashikuara në paragrafin paraardhës, çdo nen ose paragraf të pjesës II të Kartës të pranuar prej tij, me kusht që numri i neneve ose paragrafëve nga të cilat ajo Palë është e detyruar nuk do të jetë asnjëherë më i vogël se gjashtëmbëdhjetë për të parat dhe gjashtëdhjetë e tre për të dytat dhe ky numër nenes ose paragrafësh do të vazhdojë të përfshijë nenet e zgjedhura nga Pala ndërmjet atyre të cilat janë cituar veçanërisht në nenin A, paragrafi 1, nënparagrafi b.

3. Çdo Palë mund të denoncojë këtë Kartë ose çdonjërin prej neneve ose paragrafëve të pjesës II të Kartës sipas kushteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni lidhur me çdo territor për të cilin kjo Kartë është e zbatueshme, me anë të një deklaratë të bërë në përputhje me paragrafin 2 të nenit L.

Neni N **Shtojcë**

Shtojca e kësaj Karte do të jetë pjesë tërësore e saj.

Neni O **Njoftime**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për:

- a) çdo firmosje;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Karte në përputhje me nenin K;
- d) çdo deklaratë të bërë në zbatim të neneve A, paragrafët 2 dhe 3, D, paragrafët 1 dhe 2,

F, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4;

- e) çdo ndryshim në përputhje me nenin J;
- f) çdo denoncim në përputhje me nenin M;
- g) çdo akt tjetër, njoftimi ose komunikimi lidhur me këtë Kartë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Kartë të ndryshuar.

Bërë në Strasburg, më 3 maj 1996, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë autentikë, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara çdo Shteti Anëtar të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

SHTOJCË E KARTËS SOCIALE EUROPIANE TË NDRYSHUAR

Fushështrirja e Kartës Sociale Europiane të Ndryshuar
përsa u përket personave të mbrojtur

1. Pa paragjykuar nenin 12, paragrafi 4, dhe nenin 13, paragrafi 4, personat e mbuluar nga nenet 1 deri 17 dhe 20 deri 31 përfshijnë të huajt vetëm për sa ata janë shtetas të Palëve të tjera që banojnë ligjërisht ose punojnë rregullisht brenda territorit të Palës në fjalë, duke iu nënshtruar kuptimit që këto nene duhet të interpretohen në frymën e dispozitave të neneve 18 dhe 19.

Ky interpretim nuk do të paragjykonte zgjerimin e lehtësive të ngjashme në persona të tjerë nga asnjë prej Palëve.

2. Secila Palë do t'u garantojë refugjatëve, siç janë përkufizuar në Konventën lidhur me Statusin e Refugjatëve, nënshkruar në Gjenevë më 28 korrik 1951 dhe në Protokollin e 31 Janarit 1967, dhe që qëndrojnë ligjërisht në territorin e saj, trajtim sa më të favorshëm të mundshëm, dhe në çdo rast jo më pak të favorshëm se sipas detyrimeve të pranuar nga Pala në konventën e përmendur dhe sipas çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar ekzistues i zbatueshëm për ata refugjatë.

3. Secila Palë do t'u japë personave të pashtet, siç janë përkufizuar në Konventën mbi Statusin e Personave të Pashtet, të bërë në Nju Jork më 28 shtator 1954 dhe që qëndrojnë ligjërisht në territorin e saj, trajtim sa më të favorshëm të mundshëm dhe në çdo rast jo më pak të favorshëm sesa sipas detyrimeve të pranuar nga Pala në atë instrument dhe sipas çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar ekzistues i zbatueshëm për ata persona pa shtet.

Pjesa I, paragrafi 18, dhe pjesa II, neni 18, paragrafi 1

Kuptohet që këto dispozita nuk lidhen me çështjen e hyrjeve në territoret e Palëve dhe nuk paragjykojnë dispozitat e Konventës Europiane për Vendosjen, nënshkruar në Paris më 13 dhjetor 1955.

PJESA II

Neni 1, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk do të interpretohet sikur ndalon ose autorizon ndonjë dispozitë ose praktikë për sigurinë sindikale.

Neni 2, paragrafi 6

Palët mund të marrin masa që kjo dispozitë nuk do të zbatohet:

a) për punëtorët që kanë një kontratë ose marrëdhënie punësimi për një kohëzgjatje të përgjithëshme që nuk kalon një muaj dhe/ose me një javë pune që nuk kalon tetë orë;

b) aty ku kontrata ose marrëdhënia e punësimit është e një natyre rastësore dhe/ose specifike, me kusht, në këto raste, që moszbatimi i saj të justifikohet nga konsiderata objektive.

Neni 3, paragrafi 4

Kuptohet që, për qëllimet e kësaj dispozite, funksionet, organizimi dhe kushtet e veprimit të këtyre shërbimeve do të vendosen nga ligje ose rregullore kombëtare, marrëveshje kolektive ose mjete të tjera të përshatshme për kushtet kombëtare.

Neni 4, paragrafi 4

Kjo dispozitë do të kuptohet që të mos ndalojë pushimin e menjëhershëm në rastin e një shkeljeje të rëndë.

Neni 4, paragrafi 5

Kuptohet që një Palë mund të marrë angazhimin që kërkohet në këtë paragraf nëse shumica dërmuese e punëtorëve nuk lejohet të pësojë ulje pagash as me ligj as me marrëveshje ose vendime arbitrazhi, duke bërë përjashtim për ata persona që nuk mbulohen në këtë mënyrë.

Neni 6, paragrafi 4

Kuptohet që çdo Palë mundet, për aq sa i intereson, të rregullojë me ligj ushtrimin e të drejtës për të bërë grevë, me kusht që çdo kufizim i mëtejshëm që kjo mund të përbëjë mbi të drejtën të mund të justifikohet nën kushtet e nenit G.

Neni 7, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk parandalon Palët nga marrja e masave në legjislacionin e tyre që të rinjtë, të cilët nuk kanë arritur moshën minimale të përcaktuar, të mund të kryejnë punë, për aq sa është absolutisht e nevojshme për trajnimin e tyre profesional për të cilin kryhet kjo punë, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent, dhe merren masa që të mbrohet shëndeti dhe siguria e atyre të rinjve.

Neni 7, paragrafi 8

Kuptohet që një Palë mund të japë angazhimin e kërkuar në këtë paragraf nëse ajo plotëson frymën e angazhimit, duke parashikuar me ligj që shumica dërmuese e personave nën tetëmbëdhjetë vjeç nuk do të punësohen në punë nate.

Neni 8, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk do të interpretohet të përcaktojë një ndalim absolut. Përjashtime mund të bëhen, për shembull, në rastet e mëposhtme:

- a) në se një grua e punësuar ka qënë plotësisht fajtoresh për shkelje që justifikon marrëdhënien e punësimit;
- b) në se ndërmarrja në fjalë pushon së funksionuari;
- c) në se kohëzgjatja e përcaktuar në kontratën e punësimit ka përfunduar.

Neni 12, paragrafi 4

Fjalët “dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këto marrëveshje” në hyrje të këtij paragrafi merren që të kuptojnë ndër të tjera se lidhur me përfitimet që janë në dispozicion

pavarësisht nga ndonjë kontribut sigurimi, një Palë mund të kërkojë plotësimin e një periudhe të përcaktuar qëndrimi para se t'u japë këto përfitime shtetasve të Palëve të tjera.

Neni 13, paragrafi 4

Qeveritë jo Palë në Konventën Europiane për Asistencën Mjekësore dhe Sociale mund të ratifikojnë Kartën lidhur me këtë paragraf, me kusht që ato t'u japin shtetasve të Palëve të tjera një trajtim që është në përputhje me dispozitat e konventës në fjalë.

Neni 16

Kuptohet që mbrojtja e dhënë në këtë dispozitë mbulon familjet me një prind.

Neni 17

Kuptohet që kjo dispozitë mbulon të gjithë personat nën 18 vjeç, përveçse kur sipas ligjit fëmija quhet madhor më herët, pa paragjykuar dispozitat e tjera specifike të parashikuara nga Karta, veçanërisht nenin 7.

Kjo nuk nënkupton një detyrim për të dhënë arsim të detyruar deri në moshën e përmendur më lart.

Neni 19, paragrafi 6

Për qëllimin e zbatimit të kësaj dispozite, termi “familje e një punëtori të huaj” kuptohet se do të thotë të paktën gruan dhe fëmijët e pamartuar të punëtorit, për sa kohë këta të fundit konsiderohen të mitur nga shteti pranues dhe varen nga punëtori migrant.

Neni 20

1. Kuptohet që çështjet e sigurimit social, si edhe dispozita të tjera lidhur me përfitimet për papunësinë, përfitimet e pleqërisë dhe përfitimet e mbijetesës, mund të përjashtohen nga fushështirja e këtij neni.

2. Dispozitat lidhur me mbrojtjen e grave, veçanërisht lidhur me shtatzëninë, qëndrimin në shtrat dhe periudhën pas lindjes, nuk do të kuptohen të jenë diskriminim sipas referimit në këtë nen.

3. Ky nen nuk do të ndalojë adaptimin e masave specifike që synojnë të heqin pabarazitë faktike.

4. Aktivitetet e punës, të cilat, për arsye të natyrës së tyre ose kontekstit në të cilin kryhen, mund t'u besohen vetëm personave të një seksi të caktuar, mund të përjashtohen nga fushështirja e këtij neni ose e disa prej dispozitave të tij. Kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet sikur u kërkon Palëve të përfshijnë në ligje ose rregullore një listë punësh, të cilat, për arsye të kontekstit në të cilin kryhen, mund t'u rezervohen personave të një seksi të caktuar.

Nenet 21 dhe 22

1. Për qëllimin e zbatimit të këtyre neneve, termi “përfaqësues të punëtorëve” do të thotë persona që njihen si të tillë sipas legjislacionit ose praktikës kombëtare.

2. Termat “legjislacion dhe praktikë kombëtare” përmbledhin, sipas rastit, përveç ligjeve dhe rregulloreve, marrëveshje kolektive, marrëveshje të tjera ndërmjet punëdhënësve dhe përfaqësuesve të punëtorëve, zakone dhe vendime gjyqësore lidhur me to.

3. Për qëllimin e zbatimit të këtyre neneve, termi “ndërmarrje” kuptohet se i referohet një tërësie komponentësh të prekshëm dhe të paprekshëm, me ose pa personalitet juridik, e formuar për të prodhuar mallra ose për të ofruar shërbime për fitim financiar dhe me kompetenca për të përcaktuar politikën e saj të tregut.

4. Kuptohet që bashkësitë fetare dhe institutet e tyre mund të përjashtohen nga zbatimi i këtyre neneve, edhe nëse këto institute janë “ndërmarrje” brenda kuptimit të paragrafit 3. Organizmat që ndjekin aktivitete që frymëzohen nga disa ideale ose të udhëhequra nga disa koncepte të caktuara morale, ideale dhe koncepte që mbrohen nga legjislacioni kombëtar, mund të përjashtohen nga zbatimi i këtyre neneve në masë të atillë që është e nevojshme për të mbrojtur orientimin e ndërmarrjes.

5. Kuptohet që aty ku në një shtet të drejtat e parashikuara në këto nene ushtrohen në organizmat e ndryshme të ndërmarrjes, Pala në fjalë do të konsiderohet se përmbush detyrimet e saj që rrjedhin nga këto dispozita.

6. Palët mund të përjashtojnë nga fusha e zbatimit të këtyre neneve, ato ndërmarrje që punësojnë më pak se një numër të caktuar punëtorësh, që do të përcaktohet nga legjislacioni dhe praktika kombëtare.

Neni 22

1. Kjo dispozitë nuk ndikon as kompetencat dhe detyrimet e shteteve lidhur me adaptimin e rregulloreve të shëndetit dhe sigurimit për vendet e punës, as kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ngarkuara me kontrollin e zbatimit të tyre.

2. Termat “lehtësi dhe shërbime sociale dhe social-kulturore” kuptohen se u referohen lehtësive sociale dhe/ose kulturore për punëtorët të ofruara nga ndërmarrje të tilla si për asistencë mirëqenieje, fusha sportit, dhoma për nënat me foshnja në gji, biblioteka, kampe pushimesh për fëmijë, etj.

Neni 23, paragrafi 1

Për qëllimin e zbatimit të këtij paragrafi, termi “për sa më gjatë të jetë e mundur” i referohet kapaciteteve fizike, intelektuale dhe psikologjike të personit të moshuar.

Neni 24

1. Kuptohet që për qëllimin e këtij neni, termat “përfundim i punësimit” dhe “përfunduar” do të thonë përfundimin e punësimit me inisiativën e punëdhënësit.

2. Kuptohet që ky nen përfshin të gjithë punëtorët, por që një Palë mund të përjashtojë nga e gjithë mbrojtja ose një pjesë e saj kategoritë e mëposhtme të personave të punësuar:

a) punëtorët e angazhuar me një kontratë punësimi për një periudhë të caktuar kohe ose një detyrë të caktuar;

b) punëtorët që janë në një periudhë prove ose periudhë kualifikimi të punësimit, me kusht që kjo të përcaktohet paraprakisht dhe të jetë me një kohëzgjatje të arsyeshme;

c) punëtorët e angazhuar me bazë rastësore për një periudhë të shkurtër.

3. Për qëllimet e këtij neni sa më poshtë, veçanërisht, nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:

a) anëtarësia në sindikata ose pjesëmarrja në veprimtari sindikale jashtë orëve të punës ose, me miratimin e punëdhënësit, brenda orëve të punës;

b) të kërkuarit e një pozite si përfaqësues i punëtorëve, të vepruarit ose të vepruarit në të kaluarën në funksionin e përfaqësuesit të punëtorëve;

c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelje të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente;

d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzënia, besimi fetar, opinionimi politik, prejadhja kombëtare ose origjina sociale;

e) leje shtatzënie ose leje prindërore;

f) mungesa e përkohëshme nga puna për shkak sëmundjeje ose dëmtimi.

4. Kuptohet që kompensimi ose mjete të tjera të përshtatshme lehtësimi në rastin e përfundimit të punësimit pa arsye të vlefshme do të përcaktohet nga ligjet ose rregulloret kombëtare, marrëveshjet kolektive ose mjete të tjera të përshtatshme për kushtet kombëtare.

Neni 25

1. Kuptohet që autoriteti kombëtar kompetent mundet, nëpërmjet përjashtimit dhe pas konsultimeve me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve, të përjashtojë disa kategori punëtorësh nga mbrojtja që u jepet në këtë dispozitë për arsye të natyrës së veçantë të marrëdhënies së tyre të punësimit.

2. Kuptohet që përkufizimi i termit “falimentim” duhet të përcaktohet nga ligjet dhe praktika kombëtare.

3. Pretendimet e punëtorëve të përfshira në këtë dispozitë do të përfshijnë të paktën:

a) pretendimet e punëtorëve për paga lidhur me një periudhë të përcaktuar, e cila nuk do të jetë më e shkurtër se tre muaj në një sistem privilegji dhe tetë javë në një sistem garancie, para falimentimit ose përfundimit të punësimit;

b) pretendimet e punëtorëve për pagë pushimi, që u takon si rezultat i punës së kryer gjatë vitit në të cilin ndodhi falimentimi ose përfundimi i punësimit;

c) pretendimet e punëtorëve për shuma që u takojnë lidhur me mungesa të paguara, lidhur me një periudhë të përcaktuar, e cila nuk do të jetë më e shkurtër se tre muaj në një sistem privilegji dhe tetë javë në një sistem garancie, para falimentimit ose përfundimit të punësimit.

4. Ligjet dhe rregulloret kombëtare mund të kufizojnë mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve në një shumë të caktuar, e cila do të jetë në nivel të pranueshëm nga pikëpamja sociale.

Neni 26

Kuptohet që ky nen nuk kërkon nga Palët që të miratojnë ligje.

Kuptohet që paragrafi 2 nuk përfshin ngacmimin seksual.

Neni 27

Kuptohet që ky nen zbatohet për punëtorë burra dhe gra me përgjegjësi familjare lidhur me fëmijët në vartësi, si edhe lidhur me anëtarë të tjerë të familjes së tyre të ngushtë që kanë nevojë qartësisht për kujdesin ose mbështetjen e tyre ku këto përgjegjësi kufizojnë mundësitë e tyre për t'u përgatitur për aktivitet ekonomik, për të hyrë ose për të përparuar në të. Termat “fëmijë në vartësi” dhe “anëtarë të tjerë të familjes së tyre të ngushtë që kanë nevojë qartësisht për kujdesin dhe mbështetjen e tyre” do të thotë persona që përkufizohen të tillë nga legjislacioni kombëtar i Palës në fjalë.

Nenet 28 dhe 29

Për qëllimin e zbatimit të këtij neni, termi “përfaqësuesit e punëtorëve” do të thotë persona që njihen si të tillë në legjislacionin ose praktikën kombëtare.

PJESA III

Kuptohet që Karta përmban detyrime ligjore të një karakteri ndërkombëtar, zbatimi i të cilave u nënshtrohet vetëm mbikëqyrjes që parashikohet në pjesën IV të saj.

Neni A, paragrafi 1

Kuptohet që paragrafët e numëruara mund të përfshijnë nene që konsistojnë në vetëm një paragraf.

Neni B, paragrafi 2

Për qëllimin e paragrafit 2 të nenit B, dispozitat e Kartës së ndryshuar korrespondojnë me dispozitat e Kartës me të njëjtin nen ose numër paragrafi me përjashtim të:

- a. neni 3, paragrafi 2, i Kartës së ndryshuar që korrespondon me nenin 3, paragrafet 1 dhe 3, të Kartës;
- b. neni 3, paragrafi 3 i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me nenin 3, paragrafi 2 dhe 3, të Kartës;
- c. neni 10, paragrafi 5, i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me Nenin 10, paragrafi 4, të Kartës;
- d. Neni 17, paragrafi 1, i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me nenin 17 të Kartës.

PJESA V

Neni E

Një trajtim i diferencuar i bazuar në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv nuk do të konsiderohet diskriminues.

Neni F

Termet “në kohë lufte dhe emergjencë tjetër civile” do të kuptohen në atë mënyrë që të përfshijnë gjithashtu kërcënimin e luftës.

Neni I

Kuptohet që punëtorët që përjashtohen në përputhje me shtojcën e neneve 21 dhe 22 nuk merren parasysh në përbërjen e numrit të punëtorëve në fjalë.

Neni J

Termi “ndryshim” do të zgjerohet që të përfshijë edhe shtesën e neneve të reja në Kartë.

LIGJ

Nr.9066, datë 15.5.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3838, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.51, datë 25.6.2003

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë kanë rënë dakord për pikat e mëposhtme në fushën e mbrojtjes shoqërore.

PJESA I

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Në këtë Marrëveshje:

1.1 “Vend” do të thotë, në lidhje me Republikën e Shqipërisë, Republika e Shqipërisë dhe në lidhje me Republikën e Turqisë, Republika e Turqisë.

1.2 “Legjislacion” do të thotë ligj, sipas ligjit dhe rregullore të përcaktuara në nenin 2.

1.3 “Përfitim” do të thotë, në lidhje me një palë, përfitim në para, pension ose shpërblim, për të cilin ka një dispozitë në legjislacionin e asaj pale, duke përfshirë çdo shumë shtesë apo rritje të atij përfitimi, pensioni ose shpërblimi.

1.4 “Autoritet kompetent” do të thotë, në lidhje me Republikën e Shqipërisë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, ministrat ose autoritetet e tjera korrespondues përgjegjës për degët dhe skemat e mbrojtjes shoqërore në të gjithë ose në pjesë të veçanta të territorit të saj dhe në lidhje me Republikën e Turqisë, Ministri i Punës dhe Sigurimit Shoqëror, ministrat ose autoritetet e tjera korrespondues përgjegjës për degët dhe skemat e mbrojtjes shoqërore në të gjithë ose në pjesë të veçanta të territorit të saj.

1.5 “Institucion kompetent” do të thotë institucioni ose organizata përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të përmendur në nenin 2.

1.6 “Periudhë sigurimi” do të thotë periudha gjatë së cilës janë paguar kontribute për sigurime shoqërore ose periudhat për të cilat është gjykuar se janë paguar kontribute.

1.7 “Person i siguruar” do të thotë personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të përmendur në nenin 2.

1.8 “Anëtar i familjes” do të thotë çdo person i parashikuar si i tillë nga legjislacioni, aplikuar nga institucionet e palëve.

1.9 “Rezidencë” do të thotë rezidenca e zakonshme.

1.10 “Rezidencë e përkohshme” do të thotë vendi ku një person, i cili zakonisht banon në territorin e një pale, banon gjatë qëndrimit të tij/saj të përkohshëm në territorin e palës tjetër.

2. Çdo term, që nuk është përcaktuar në këtë nen, do të ketë kuptim të përcaktuar për të në legjislacionin që aplikohet.

Neni 2 **Hapësira ligjore**

1. Kjo Marrëveshje do të aplikohet sipas legjislacionit të mëposhtëm:
 - a) Në lidhje me Republikën e Turqisë:
 - a.1. ligji i sigurimeve shoqërore që mbulon punëtorët dhe ligji i sigurimeve shoqërore për punëtorët e bujqësisë;
 - a.2. ligji i fondit të pensioneve të Republikës së Turqisë që mbulon punonjësit shtetërorë (invaliditet, pleqëri dhe në rastet e humbjes së mbajtësit të familjes);
 - a.3. ligji i Institucionit të Sigurimeve Shoqërore për tregtarët, artizanët dhe të vetëpunësuarit e tjerë, si dhe ligji i sigurimeve shoqërore për personat e vetëpunësuar në bujqësi.
 - a.4. legjislacioni lidhur me fondin e pensioneve siç përcaktohet në nenin 20 të ligjit të Sigurimeve Shoqërore 506;
 - b) Në lidhje me Republikën e Shqipërisë:
 - b.1. legjislacioni i sigurimeve shoqërore (sëmundje dhe barrë lindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, invaliditet, pension pleqërie dhe familjar) që mbulon personat e punësuar, si dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit);
 - b.2. legjislacioni lidhur me përfitimet familjare;
 - b.3. legjislacioni lidhur me sigurimin shëndetësor;
 - b.4. legjislacioni lidhur me kujdesin shëndetësor.
2. Kjo Marrëveshje do të aplikohet, gjithashtu, sipas ligjeve dhe rregullave të cilat amendojnë, kombinojnë ose pasojnë legjislacionin e specifikuar në paragrafin 1, me kusht që termat e paragrafit 3 të rezervohen.
3. Kjo Marrëveshje do të aplikohet sipas ligjeve dhe rregullimeve, të cilat e shtrijnë hapësirën e legjislacionit të një pale në kategori të reja përfituesish dhe përcaktojnë përfitime të reja, nëse Palës tjetër nuk i është komunikuar ndonjë ndryshim brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ligjeve dhe rregullimeve.
4. Kjo Marrëveshje do të aplikohet në legjislacionin lidhur me një degë të re të sigurimeve shoqërore me kushtin që ndërmjet palëve të jetë përfunduar një marrëveshje për këtë qëllim.

Neni 3 **Hapësira personale**

Kjo Marrëveshje do të aplikohet për personat, të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të Republikës së Turqisë dhe të Republikës së Shqipërisë dhe të personave që kanë humbur mbajtësin e familjes dhe anëtarëve të varur të familjes që mbulohen nga legjislacioni i secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 4 **Trajtim i barabartë**

Të gjithë personat e përcaktuar në nenin 3 do të kenë trajtim të barabartë përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve sipas legjislacionit të secilës palë.

Neni 5 **Transferimi i përfitimeve**

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje:

1. Përfitimet që do t'i paguhen në bazë të legjislacionit të njëjës palë çdo personi të përcaktuar në nenin 3, si dhe ato që jepen në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të paguhen në territorin e palës tjetër dhe nuk i nënshtrohen ndonjë zbritjeje, ndryshimi, pezullimi ose sekuestrimi për shkak të rezidencës së personit në territorin e palës tjetër.

2. Përfitimet që do të paguhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do t'i paguhen gjithashtu një personi në një vend të tretë, i cili është apo ka qenë subjekt i legjislacionit të të dyja palëve, ose personave në varësi të tij/saj, ose atyre që kanë humbur mbajtësin e familjes sipas rastit.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk aplikohen për përfitimet e mëposhtme:

a) përfitime për papunësi;

b) përfitime të veçanta të dhëna si ndihmë ekonomike ose në rast nevoje.

PJESA II DISPOZITA LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E APLIKUESHËM

Neni 6

Rregullat për mbulimin

1. Me kusht që termat e mëposhtëm të kësaj Marrëveshjeje rezervohen:

1.1 Një person i punësuar në territorin e njëres palë, është subjekt i vetëm i legjislacionit të asaj pale që i përket punës së tij/saj.

1.2. Një person, i cili ka rezidencën e tij të përhershme në territorin e njëres palë dhe që ka një aktivitet në emër të tij/saj në territorin e palës tjetër ose në territorin e të dyja palëve, do të jetë subjekt i vetëm i legjislacionit të palës, në territorin e së cilës ai ka rezidencën.

2. Një person i cili është subjekt i legjislacionit të njëres Palë, por që dërgohen në territorin e palës tjetër për të punuar për më pak se 24 muaj, do të jetë subjekt i legjislacionit të palës së parë sikur ai punon në territorin e asaj pale. Periudha prej 24 muajsh mund të shtrihet deri në 60 muaj me aprovimin e mëparshëm të autoriteteve kompetente të të dyja palëve.

3. Atje ku ekuipazhi i një anijeje është subjekt i legjislacioneve të të dyja palëve pa aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ekuipazhi i punësuar në bordin e një anijeje me flamur turk i nënshtrohet legjislacionit turk, përsa i përket asaj pune, dhe ekuipazhi i punësuar në bordin e një anijeje me flamur shqiptar i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, përsa i përket asaj pune.

4. Personat e punësuar në territorin e një pale si agjentë të qeverisë së palës tjetër do të jenë subjekt i legjislacionit të palës që e punëson, në rast se ata janë subjekt të asaj pale. Megjithatë, në rast se ata janë subjekte të palës, në territorin e së cilës ata janë punësuar ose kanë rezidencën e përhershme në atë territor, ata mund të kërkojnë aplikimin e legjislacionit të asaj pale. Kjo zgjedhje nuk do të aplikohet në mënyrë retrospektive.

5. Autoritetet kompetente të të dyja palëve mund të paraqesin ndryshime të rregullave të zbatimit për ndonjë person apo grupe me marrëveshje reciproke.

PJESA III DISPOZITA LIDHUR ME PËRFITIMET

SEKSIONI 1 BASHKIMI I PERIUDHAVE

Neni 7

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Kur njohja, ruajtja apo dhënia më pas e së drejtës për përfitim sipas legjislacionit të një prej Palëve Kontraktuese është subjekt i plotësimit të periudhës së sigurimit, institucioni kompetent i Palës Kontraktuese merr në konsideratë periudhat e sigurimit sikur ato të ishin plotësuar në bazë të legjislacionit të tyre, për aq sa këto periudha nuk përputhen.

2. Në përcaktimin e kushteve, lidhur me fillimin e punës për herë të parë, do të merren parasysh ruajtja ose njohja e së drejtës për një përfitim, periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe data e fillimit të punës.

Neni 8

Periudhat e plotësuar sipas legjislacionit të një vendi të tretë

Kur një person nuk plotëson kushtet për të marrë një përfitim sipas legjislacionit të të dyja palëve mbi bazën e periudhave të bashkuara të sigurimit, që përcaktohen në dispozitat e nenit 7, çështja e së drejtës për përfitim do të zgjidhet duke marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një vendi të tretë me të cilin të dyja Palët Kontraktuese kanë arritur një marrëveshje për sigurimet shoqërore për bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 9

Zgjatja minimum e periudhave që bashkohen

Pa paragjykime lidhur me ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, kur zgjatja totale e periudhave të sigurimit e plotësuar nga një person sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese është më pak se një vit dhe kur nuk ekziston e drejta për përfitim sipas atij legjislacioni mbi bazën e atyre periudhave, nuk mund të pretendohet që për këto periudha të jepet një përfitim nga institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, këto periudha do të merren në konsideratë nga Pala tjetër Kontraktuese, ndërsa përcakton të drejtën për përfitim në përputhje me legjislacionin e aplikuar.

SEKSIONI 2

PËRFITIMI PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE

Neni 10

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Kur njohja, ruajtja ose rifitimi i së drejtës për përfitim për sëmundje ose barrëlindje sipas legjislacionit të njërit nga Palët Kontraktuese është subjekt i plotësimit të periudhave të sigurimit ose të punësimit, institucioni kompetent i njërit Palë Kontraktuese do të marrë në konsideratë periudhat e sigurimit ose punësimit të plotësuar sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, sikur ato të jenë plotësuar sipas legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese.

Neni 11

Përfitimet mjekësore

1. Kur kushtet e një shqiptari të siguruar dhe që është punësuar në Turqi përkohësisht në një projekt të veçantë prej punëdhënësve të tij/saj të vazhdueshëm dhe të anëtarëve të familjes së tij/saj që banojnë me të apo të një turku të siguruar, të punësuar po ashtu në Shqipëri dhe të anëtarëve të familjes së tij/saj kërkojnë trajtim mjekësor urgjent, ata do të marrin përfitim për sëmundje ose barrëlindje, duke përfshirë edhe shtrim në spital, për llogari të Palës Kontraktuese ku është qendra kryesore e biznesit.

2. Kur kushtet e punëtorëve të regjistruar si të siguruar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe të anëtarëve të familjes që banojnë me ta kërkojnë trajtim mjekësor urgjent gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ata do të marrin përfitime për sëmundje dhe barrëlindje, duke përfshirë dhe shtrim në spital për llogari të Palës Kontraktuese ku ata janë të regjistruar si të siguruar.

3. Kur punëtorët e regjistruar si të siguruar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dhe anëtarët e familjes që banojnë me ta, transferohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ndërsa marrin përfitime për sëmundje ose barrëlindje nga institucionet e sigurimeve shoqërore turke ose shqiptare, ata do të vazhdojnë t'i marrin këto përfitime. Megjithatë, përfituesi duhet të marrë autorizimin e institucionit kompetent para transferimit. Kërkesa për autorizim do të refuzohet vetëm mbi bazën e një raporti mjekësor dorëzuar atij institucioni në rast se gjendja shëndetësore e personit në fjalë nuk lejon transferimin e tij/ saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Autorizimi mund të jepet në vazhdim, edhe nëse nuk është marrë më parë nga forca madhore.

4. Njohja e së drejtës për të përfituar do të përcaktohet në zbatim të legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është punësuar i siguruari, ndërsa anëtarët e familjes, shtrirja e përfitimeve dhe dispozitat e tyre do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese të vendbanimit të përkohshëm ose të përhershëm.

5. Anëtarët e familjes së një personi, të cilit i takon një përfitim në bazë të legjislacionit të një Pale Kontraktuese sipas së cilës ai/ajo është i/e regjistruar si i/e siguar, do të marrin përfitime mjekësore nga dega e sigurimit për sëmundje dhe barrë lindje, nëse nuk përfitojnë nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ata banojnë.

6. Kur anëtarët e familjes transferohen në territorin e institucionit kompetent, ata marrin përfitime sipas dispozitave të legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese. Kjo dispozitë aplikohet edhe në rastet kur anëtarët e familjes tashmë kanë filluar të marrin përfitime për të njëjtën rast sëmundjeje ose barrë lindjeje nga institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese para transferimit. Nëse në këtë rast përcaktohet një kohë kufi për dhënien e përfitimeve mjekësore nga legjislacioni i aplikueshëm i atij institucioni kompetent, atëherë merren në konsideratë periudhat, gjatë të cilave janë dhënë përfitimet para transferimit.

7. Shpenzimet për përfitime përballohen nga Pala Kontraktuese në të cilën personi në fjalë është regjistruar si i siguar.

Neni 12

Përfitimet shëndetësore për pensionistët

1. Kur një person, të cilit i është dhënë një pension ose përfitim në para në përputhje me legjislacionin e të dyja Palëve Kontraktuese me kusht bashkimin e periudhave të sigurimit të plotësuar në të dy Palët Kontraktuese, bashkë me familjen e tij/saj, ka fituar të drejtën e përfitimeve mjekësore sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ai/ajo është rezident, përfitimet do të mbulohen nga institucioni i palës ku personi ka rezidencën dhe në përputhje me legjislacionin që ai institucion aplikon.

2. Kur një personi i është dhënë një pension ose përfitim në para sipas legjislacionit vetëm të njëjës prej Palëve Kontraktuese, dhe është rezident në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përfitimet mjekësore që janë njohur si e drejtë në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese përgjegjëse për pagesën e pensionit për personin e siguar dhe anëtarët e familjes së tij/saj, do të jepen nga vetë institucioni i vendit të rezidencës, në emër dhe me shpenzimet e institucionit kompetent të Palës Kontraktuese, përgjegjëse për atë pension.

3. Kur personat të cilët marrin pensione ose përfitime sipas legjislacioneve të të dyja Palëve Kontraktuese dhe ata persona që marrin pensione ose përfitime sipas legjislacionit vetëm të një prej Palëve Kontraktuese, si dhe anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta marrin rezidencë të përkohshme në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kur kushtet e tyre do të kërkojnë një trajtim urgjent, ata do të marrin përfitime mjekësore me shpenzimet, në rastin e parë, të institucionit kompetent të palës ku janë rezidentë të përhershëm dhe, në rastin fundit, të institucionit kompetent të palës përgjegjëse për pagesën e pensionit.

4. Njohja e së drejtës për këto përfitime, për ata të cilët marrin pensione nga të dyja palët, do të vendoset në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës përfituesi është rezident i përhershëm, dhe në rastin kur përfituesi merr pension vetëm nga njëra palë, do të vendoset në përputhje me legjislacionin e asaj Pale Kontraktuese. Hapësira, kohëzgjatja dhe mënyra e dhënies së përfitimeve do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e vendit në territorin e të cilit përfituesi është rezident.

Neni 13

Përfitimet kryesore shëndetësore dhe përfitimet e para

1. Dhënia e përfitimeve mjekësore jetësore për ata që kanë fituar të drejtën e përfitimit mjekësor në përputhje me nenet 11,12/2-3 të kësaj Marrëveshjeje, do të kushtëzohet nga autorizimi i institucionit kompetent për këtë qëllim, me përjashtim të rasteve të një emergjence absolute.

2. Pagesa e përfitimeve në para (shpërblim ditor) do të bëhet në përputhje me legjislacionin e institucionit ku personi në fjalë është regjistruar.

Neni 14

Rimbursimi i kostos së përfitimeve shëndetësore

Shpenzimet për kujdes shëndetësor, të dhëna për rastet e parashikuara nga nenet 11,12,13,15,18,19 dhe 20 të kësaj Marrëveshjeje, do të rimbursohen nga institucioni ku personi në fjalë është regjistruar në institucionin kompetent, i cili do të japë përfitimet sipas procedurave që do të përcaktohen nga Marrëveshja Administrative.

Neni 15

Përfitimet për barrëlindje

Kur personi i siguruar ose një nga anëtarët e familjes së tij fiton të drejtën e përfitimit për barrëlindje sipas legjislacionit të një ose të dyja Palëve Kontraktuese, do të aplikohen vetem dispozitat e legjislacionit të vendit ku personi kalon periudhën e barrëlindjes, duke marrë parasysh, kur është e nevojshme, periudhat e sigurimit që do të bashkohen sipas nenit 10.

Përfitimet mjekësore për një person, që ka fituar të drejtën e përfitimit për barrëlindje, do të jepen sipas kërkesave në përputhje me nenet 11,12 dhe 13 të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI 3

SHPENZIME PËR FUNERALET

Neni 16

1. Kur një person i regjistruar si i siguruar në bazë të legjislacionit të njërës prej Palëve Kontraktuese vdes në territorin e palës tjetër, ai/ajo do të fitojë të drejtën e përfitimit të shpenzimeve funerale sikur ai/ajo të ketë vdekur në territorin e palës ku ai/ajo është siguruar.

2. Kur në aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, dispozita për shpenzimet për funerale sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese është e lejueshme, do të jepet sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ka ndodhur vdekja.

3. Kur vdekja ndodh jashtë territorit të të dyja Palëve Kontraktuese, grantet për shpenzimet funerale do të jepen sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese, në bazë të legjislacionit të së cilës i vdekuri është regjistruar si i siguruar së fundi.

4. Kur në kohën e vdekjes, periudha e sigurimit për të fituar të drejtën e marrjes së këtij përfitimi nuk është plotësuar, periudhat e sigurimit të plotësuara në të kaluarën në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të merren parasysh në mënyrë që të plotësojnë periudhat e plotësuara në territorin e palës së parë.

SEKSIONI 4
PËRFITIM INVALIDITETI, PENSION PLEQËRIE
DHE PAGESË NË RAST VDEKJEJE

Neni 17

Llogaritja e masës së përfitimit që duhet të jepet

1. Kur personi fiton të drejtën për pension sipas legjislacionit vetëm të njëjës Palë Kontraktuese, një pension i vetëm do të akordohet, pa marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuara në Palën tjetër Kontraktuese.

2. Kur dhënia e së drejtës për një pension të vetëm sipas legjislacionit vetëm të njëjës prej Palëve Kontraktuese nuk është e lejueshme, por një e drejtë për pension mund të jepet vetëm duke marrë parasysh periudhat e plotësuara sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e mëposhtme do të aplikohen:

2.1 Në llogaritjen e masës së pensionit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore i secilës Palë Kontraktuese do të marrë parasysh periudhat e mbedhura të sigurimit, sikur këto periudha të ishin plotësuar vetëm sipas legjislacionit të vet.

2.2 Institucioni kompetent, atëherë, përcakton masën e pensionit që duhet të jepet duke aplikuar raportin midis periudhave të sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese me masën e llogaritur teorikisht sipas nënparagrafit 2.1 të këtij neni.

3. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje duhet të merren parasysh dispozitat e legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese që përcaktojnë reduktimin, ndërprerjen ose heqjen e pensionit.

SEKSIONI 5
AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 18

Përfitimet në lidhje me aksidentet në punë

1. Rritjet dhe shtesat e granteve të dhëna për aksidente në punë, sipas legjislacionit të secilës prej Palëve Kontraktuese, do të vazhdojnë të paguhen pasi personat e interesuar transferohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Kur një person që ka pësuar aksident në punë ose vuan nga sëmundje profesionale në territorin e njëjës prej Palëve Kontraktuese, transferon rezidencën e tij/saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në vijim të marrjes së përfitimeve të dhëna gjatë periudhës së paaftësisë së përkohshme, ai/ajo do të vazhdojë t'i marrë këto përfitime me autorizim të institucionit kompetent para largimit.

Kur kushtet e personit që ka pësuar aksident në punë ose vuan nga sëmundje profesionale bëjnë të domosdoshme autorizimin në datën e skadencës, kjo zgjatet deri sa personi të shërohet, duke iu nënshtruar komisionit mjekësor dhe lejes së institucionit kompetent.

3. Kur gjendja e personit të aksidentuar në punë ose që vuan sëmundje profesionale, keqësohet në vijim të transferimit të rezidencës së tij/saj në territorin e Palës tjetër ai/ajo që fiton të drejtën për kujdes shëndetësor të dhënë në raste aksidentesh në punë, me kusht që personi të marrë autorizimin e institucionit në të cilin ai/ajo është regjistruar, në datën e ndodhjes së aksidentit ose të përcaktimit fillestar të diagnozës.

4. Kujdesi shëndetësor i përcaktuar në nënparagrafin 2 dhe 3 të këtij neni do të jepet nga institucioni i vendit ku personi ka pasur rezidencën e fundit dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm këtu në lidhje me hapësirën dhe mënyrën e dhënies së këtij kujdesi. Përsa i përket rasteve të treguara në nënparagrafin 2 të këtij neni, përfitimet në para (shpërblime ditore) jepen nga institucioni në të cilin personi është regjistruar dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për të.

5. Shpenzimet e përfitimeve të dhëna në rastet e parashikuara në nënparagrafët 2 dhe 3 të këtij neni do të mbulohen nga institucioni në të cilin punëtori është regjistruar. Mënyra e pagimit të shpenzimeve për kujdes shëndetësor nga institucioni në të cilin punëtori është regjistruar, institucionit në vendin e fundit të rezidencës, përcaktohet nga Marrëveshja Administrative.

6. Për situatat e përshkruara në nënparagrafët 2 dhe 3 të këtij neni, dhënia e pajisjeve të rëndësishme dhe përfitimeve mjekësore, siç tregohet në aneksin e Marrëveshjes Administrative, do të kushtëzohen nga autorizimi i institucionit kompetent për këtë qëllim, me përjashtim të rasteve të emergjencës.

7. Në përcaktimin e shkallës së invaliditetit, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale në përputhje me legjislacionin e një Pale Kontraktuese, do të merret parasysh çdo aksident ose sëmundje e mëparshme sipas legjislacionit të palës tjetër, sikur ato të kenë ndodhur dhe të jenë shfaqur sipas legjislacionit të palës së parë.

Neni 19

Përfitime në lidhje me sëmundjet profesionale

1. Kur personi me sëmundje profesionale ka punuar në territorin e të dyja palëve në punë që mund të shkaktojnë të tilla sëmundje, përfitimet që kërkohen nga i siguruari ose personat e varur prej tij/saj do të caktohen në përputhje me legjislacionin e palës, në territorin e së cilës aktiviteti në fjalë është kryer, me kusht që kërkesat e këtij legjislacioni të plotësohen.

2. Kur legjislacioni i një prej palëve kushtëzon të drejtën e përfitimeve për sëmundje profesionale me diagnozën e vet fillestare në territorin e vet, ky kusht do të plotësohet, nëse sëmundja diagnostikohet së pari në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Rregullat e mëposhtme do të aplikohen kur gjendja e personit që është trajtuar sipas legjislacionit të një pale për sëmundje profesionale keqësohet gjatë kohës kur ai/ajo është rezident në territorin e palës tjetër.

3.1 Kur personi nuk ka punuar në territorin në të cilin ai/ajo është aktualisht i angazhuar në një punë, që ka shkaktuar sëmundjen profesionale ose keqësimin e saj, institucioni i palës së parë në të cilën personi është regjistruar do të realizojë dhënien e përfitimeve sipas legjislacionit të vet, duke marrë parasysh shkallën e keqësimit.

3.2 Kur personi ka punuar në territorin në të cilin është aktualisht i angazhuar në një punë, që ka shkaktuar sëmundjen profesionale ose ka keqësimin e saj, institucioni i palës së parë në të cilën personi është regjistruar do të realizojë dhënien e përfitimeve sipas legjislacionit të vet, pa marrë parasysh shkallën e keqësimit. Institucioni i palës në rezidencën aktuale do të japë përfitim suplementar, masa e të cilit është e barabartë me diferencën midis masës që duhet të llogaritet sipas legjislacionit të vet, duke marrë parasysh shkallën e acarimit dhe shumën për t'u llogaritur sikur të ishte rasti që sëmundja profesionale të ketë ndodhur në territorin e vet para acarimit.

SEKSIONI VI

KONTROLI ADMINISTRATIV DHE MJEKËSOR

Neni 20

1. Kur personat të konsideruar nga legjislacioni i një pale si të papërshtatshëm për punë për shkak të invaliditetit, aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale janë rezident në territorin e palës tjetër, kontrollet administrative dhe mjekësore që zbulojnë shkallën e invaliditetit të tyre në mënyrë që të mundësohet vazhdimësia e së drejtës për sigurim shoqëror, do të kryhen nga institucioni kompetent i palës së fundit me kërkesë të institucionit të palës së parë.

Megjithatë institucioni kompetent i palës së parë do të rezervojë të drejtën e rikontrollimit të personit nga një specialist ose në vendin ku personi është rezident, ose në vendin e vet. Në rastin e fundit, shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit mbulohen nga institucioni që kërkoi riezaminimin.

2. Shpenzimet e riezaminimit paguhen nga institucioni që e kërkoi atë, në përputhje me metodën dhe parimet e përcaktuara në Marrëveshjen Administrative.

PJESA IV DISPOZITA ADMINISTRATIVE DHE TË PËRGJITHSHME

Neni 21 **Rregullimi administrativ**

Një Marrëveshje e Përgjithshme Administrative, që arrihet midis autoriteteve kompetente të palëve, do të përcaktojë parimet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, ato që kanë lidhje me dispozitat që përmbajnë referenca të qarta për Marrëveshjen Administrative. Institucionet kompetente ndërlidhëse të palëve do të përcaktohen nga kjo Marrëveshje Administrative.

Në zbatim të metodave dhe parimeve, format përkatëse, të cilat do të përcaktohen reciprokisht nga palët, do t'i aneksohen kësaj Marrëveshjeje të Përgjithshme Administrative ose ku është e nevojshme, një Marrëveshje Administrative shtesë.

Neni 22 **Shkëmbimi i informacionit dhe asistenca reciproke**

1. Autoritetet dhe institucionet kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

1.1 Do t'i komunikojnë njëra-tjetrës, për sa kohë e lejon legjislacioni i tyre, të gjithë informacionin për masat e marra prej tyre për aplikimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Do të asistojnë njëra-tjetrën në përcaktimin dhe dhënien e së drejtës që rrjedh nga aplikimi i kësaj Marrëveshjeje ose nga legjislacioni sipas të cilit kjo Marrëveshje aplikohet, sikur kjo të ishte një çështje e aplikimit të legjislacionit të tyre.

1.3 Do t'i komunikojnë njëra-tjetrës, në kohën më të afërt të përshtatshme, të gjithë informacionin për masat e marra prej tyre për aplikimin e Marrëveshjes ose për amendamentet në legjislacionin kombëtar për sa kohë që këto ndryshime kanë efekt në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Ndihma e dhënë sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 të këtij neni, do të jetë falas, nëse nuk përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen Administrative, së cilës i referohemi në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje për qëllim rimbursimi të kategorive të caktuara të shpenzimeve. Institucioni kompetent i një pale do të tregojë masën që duhet të paguhet me monedhën e palës së fundit, ndërsa i komunikon palës tjetër kërkesë për pagesë.

3. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e një pale, çdo informacion për një individ, i komunikuar në përputhje me dhe për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje për palën tjetër nga pala tjetër, do të jetë konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe legjislacionit sipas të cilit kjo Marrëveshje aplikohet.

Neni 23 **Përrjashtimi ose reduktimi nga taksat, tatimet dhe shpenzimet**

1. Reduktimi ose përrjashtimi nga taksat, tatimet, shpenzimet konsullore dhe kostot administrative, të përcaktuara nga legjislacioni i një pale, për nxjerrjen e një certifikate ose dokumenti, të kërkuar nga legjislacioni i asaj pale, do të aplikohet për certifikatat apo dokumentet e kërkuara nga legjislacioni i palës tjetër.

2. Të gjitha dokumentet formale të kërkuara për qëllim aplikimi të kësaj Marrëveshjeje do të përrjashtohen nga autenticiteti i autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

Neni 24

Gjuha që përdoret në komunikim

Për qëllimet e aplikimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet kompetente të palëve do të komunikojnë direkt në gjuhën zyrtare të secilës palë.

Neni 25

Dorëzimi i kërkesave, deklarimeve dhe apelet

1. Çdo deklaratë, kërkesë ose apelim, në lidhje me përcaktimin e një të drejte për përfitim, e cila për qëllimet e legjislacionit të një pale i është nënshtruar autoritetit ose institucionit kompetent të asaj pale, brenda limiteve ligjore kohore, do të konsiderohet sikur t'i ishte nënshtruar autoritetit ose institucionit kompetent të palës tjetër. I njëjti parim është i aplikueshëm edhe për peticionet, deklaratat, apelimet për çështje të ndryshme.

2. Nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo kërkesë për përfitim, sipas legjislacionit të një palë, do të konsiderohet si pretendim për përfitimin përkatës sipas legjislacionit të Palës tjetër, me kusht që aplikuesi:

2.1 të ketë treguar në peticionin e tij/saj që pretendimi i tij/saj është gjithashtu i përkueshëm sipas legjislacionit të palës tjetër ose

2.2 të ketë dhënë informacion dhe dokumente që tregojnë periudha të besueshme të sigurimit sipas legjislacionit të palës tjetër.

Dispozitat e mësipërme nuk do të aplikohen nëse aplikanti kërkon qartë në peticionin e tij/saj shtyrjen e vendimit në lidhje me dhënien e së drejtës.

3. Në rastet ku dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni aplikohen, autoriteti ose institucioni kompetent, që pranon pretendimin, deklarinim ose apelimin, ia kalon atë pa vonesë autoritetit ose institucionit kompetent të palës tjetër.

Neni 26

Pagimi i përfitimeve

Institucioni kompetent i një pale mund të zgjedhë të shkarkojë detyrimin e vet që rrjedh nga aplikimi i kësaj Marrëveshjeje, në monedhën e palës së dytë.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përpiqen të bien dakord për ndryshimet që rrjedhin nga interpretimi ose aplikimi i kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet negociatave.

2. Nëse ndonjë mosmarrëveshje nuk zgjidhet në këtë mënyrë brenda një periudhe gjashtëmujore, të dyja palët i drejtohen arbitrazhit, i cili do të ngrihet duke ndjekur hapat e mëposhtme:

2.1 Çdo Palë Kontraktuese delegon një person arbitër brenda një muaji nga marrja e njoftimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga arbitrazhi. Të dy personat e ngarkuar për arbitrazh delegojnë një arbitër të tretë që nuk duhet të jetë bashkëkombas i palëve, brenda dy muajve nga data kur pala që ka caktuar më vonë arbitrin e vet ka njoftuar palën tjetër për këtë takim.

2.2 Kur secila nga Palët Kontraktuese nuk arrin të caktojë arbitrin e vet brenda periudhës së përcaktuar, pala tjetër mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut të realizojë takimin e kërkuar. Një procedurë e njëjtë mund të ndiqet, nëse të dy arbitrat nuk bien dakord për caktimin e arbitrit të tretë.

2.3 Nëse Presidenti i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut është bashkëkombas i një Pale Kontraktuese, detyrat që i atribuohen atij/asaj sipas këtij neni i kalohen Zëvendës-presidentit të Gjykatës ose anëtarit më të lartë të kësaj gjykate, i cili nuk është bashkëkombas i asnjërës prej palëve.

3. Gjykata e arbitrazhit jep verdiktin e vet me shumicë votash. Vendimi i arbitrazhit është i detyrueshëm për të dyja Palët Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër shpenzimet për arbitrin që cakton. Pjesa tjetër e shpenzimeve do të përballohet në mënyrë të barabartë nga të dyja Palët Kontraktuese. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë rregullat e saj të procedurës.

PJESA V
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28
Dispozitat kalimtare

1. Çdo periudhë sigurimi e plotësuar në legjislacionin e secilës palë, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duhet të merret parasysh për qëllim të përcaktimit të të drejtave të dala nga kjo Marrëveshje.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të japë të drejta për ndonjë periudhë përpara hyrjes në fuqi.

3. Sipas dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, çdo përfitim, përveç pagesës së menjëhershme, në lidhje me raste të datuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet i pagueshëm, që nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 29
Hyrja në fuqi dhe shtrirja e kësaj Marrëveshjeje

1. Secila palë do të informojë palën tjetër, rreth veprimeve që ka marrë në lidhje me legjislacionin e saj me qëllim sjelljen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin janë shkëmbyer instrumentet e ratifikimit.

2. Kjo Marrëveshje do të denoncohet nga njoftimi i bërë prej secilës palë. Denoncimi do të jetë i vlefshëm në fund të gjashtë muajve nga data e njoftimit.

3. Nëse Marrëveshja prishet, çdo e drejtë për përfitim e fituar nga një person në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ruhet dhe bisedimet do të zhvillohen për caktimin e çdo të drejte, përveç atyre të fituara nga këto dispozita. Në rastin kur palët nuk arrijnë në Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në pajtim me nenin 27.

Kjo Marrëveshje është bërë në Tiranë, më 15 korrik 1998, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, turke dhe angleze. Në rast paqartësish në interpretim do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ass. Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI

MINISTËR I PUNËS DHE ÇËSHTJEVE
SOCIALE

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË
Prof. Dr. NAMI ÇAGAN

MINISTËR I PUNËS DHE I SIGURIMIT
SHOQËROR